

BIBLIOT. A

# Ismail Kadare



## DIALOG ME ALAIN BOSQUET

Onufri

891.933-94

## KODI MISTERIOZ I LETRAVE TË ISMAIL KADARESË

Ai nuk ka dalë asnjëherë nga kulla e tij letrare. Aty ai mbretëron krenar dhe i vettua. Kur u largua në mërgim në vitin 1990, ndërkoq që regjimi komunist po lëkundej, apo kur flet sot për situatën në Kosovë, duke kritikuar nacionalizmin dhe duke denoncuar kufijtë artificialë, qëndrimi i Ismail Kadaresë është cilësuar gjithmonë i paqartë. Një ndër romancierët më të njohur të Europës, emri i të cilit figuron që prej njëzet vjetësh në listën e kandidatëve për çmimin “Nobel”, vishet me një mister, si të jetë një personazh i arratisur prej romaneve të tij. Edhe në epokën e Luftës së Ftohtë, ai mbulohej nga një re mosbesimi në Tiranë dhe dyshimi në Paris. Sado groteske mund të duket, ai ishte nën shënjestrën e nomenklaturës shqiptare dhe të inteligjencies perëndimore...

## VEPRA

...Të parët, pas botimit të çdo romani (mc vçpra si “Prilli i thycr”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” osc “Pallati i Ëndrravc”), që vinin në lojë rregullat e realizmit socialist, kërkonin ndalimin e tij. Ismail Kadareja është në dijeni se midis mijëra faqeve të dosjes së tij personale, të ruajtur në arkivat sckrete shqiptare, gjenden mc dhjetëra letra të shkruara nga nxënësit e Shkollës së Partisë, raporte të policisë sekrete, denoncime të shkrimitarëve. “Nuk mund të mendoja se mund të nxitej një xhelazi i tillë kundër një shkrimitari. Por në një vend totalitarist, shteti është aleati më i mirë i xhelozisë së shkrimitarëve”.

Të dytët, në anën tjetër të Adriatikut, c qortonin për statusin e shkrimitarit zyrtar të paguar nga regjimi, për heshtjen e tij ndaj situatës në Shqipëri. Ata dëshironin ta bënin një hero, një Vaclav Havel apo një Solzhenicin; e nxisin të ngrihej kundër despotit shqiptar Enver Hoxha, të bëhej disident, pra, të arratisej apo të vetëvritej, sepse nuk kishin parë ndonjëherë një kundërshtar të regjimit të mbetej i gjallë në Shqipërinë staliniste.

Mos vallë arsyjeja e misterit që mbulon Ismail Kadarenë është vepra e tij, një kështjellë plot kurthe, kalime të nëndheshme dhe fantazma? Apo për shkak të pamjes së tij të pakuptueshme dhe të heshtur, të ballit të tij me rrudha të thella e vertikale dhe vetullave të errëta, të cilat i japid ftyrës së tij një pamje enigmatike dhe pak të shqetësuar? As njëra, as tjetra. Thjesht, si nga njëra anë, edhe nga tjetra ai qortohet se shkroi nën një regjim i cili kishte ndaluar librat e Sarrit dhe të shumë shkrimitarëve të tjerë, se shenjtëroi letërsinë në një vend ku jeta e popullit ishte zënë nën ingranazhin e radhëve të qumështit. Ismail Kadareja i është përkushtuar tërësisht letërsisë. Kjo është

## PARATHËNIE

edhe përgjigjja. Aty ai është sovran, krenar c i vëtmuar. Atdheu i tij është ai i shkrimtarëve të mëdhenj grekë, i tragjedisë dhe i Shekspirit. ‘Në përgjithësi, literatura e njohur tërhiqet nga krimi, sepse ai zurret në thellësinë e shpirtit. Nëse marrim veprën e Dantes, pjesa më e tmerrshme është pjesa më tërheqëse’.

Ai është mbyllur në këtë botë, ku ndihet era e rëndë e krimit, që prej fëmijërisë së tij, që në moshën njëmbëdhjetë-vjeçare, kur shflettoi “Makbethin”. “Nuk e kuptova gjithçka, por isha i tërhequr e i mrekulluar nga këto magjistare dhe shtriga”. Ashtu si edhe shqiptarët e Veriut, të cilët burgoscs hin përjetësisht, me dëshirë, në kullën e tyre, për t'i shpëtuar gjakmarres, ai nuk doli më kurrë nga kulla e tij letrarc. Në epokën e diktatorit stalinian Enver Hoxha, ai u fsheh për t'i shpëtuar çmendurisë dhe për t'iu larguar absurditeteve të tilla, të cilat u ndalonin vizitorëve të huaj mbajtjen e flokëve të gjatë dhe diplomatëve shqiptarë beqarinë. “Si kam mundur të jetoj në këtë vend idiot, ku vetë shkrimtarët duhet të çmendeshin? A ka ndonjë sekret? Po, një shkrimtar, i cili beson në pushtetin superior të botës së letërsisë, shpëton si një fetar që beson në Zot. Isha i ndërgjegjshëm që po krijoja diçka jashtëkohore, kisha një atdhe tjetër, atë të letërsisë dhe vendi im më dukej qesharak”.

Pak rëndësi ka për të nëse i është dashur të luajë me diktaturën shqiptare për të botuar veprat e tij. E vërteta nuk gjendet në veprimet, por në librat e tij. ‘Në gjithë veprat e mia merrem me krimin’, thotë ai.

“Meqenëse nuk mund ta kritikoja Shqipërinë, merresha me regjimet e tjera totalitare, si Bashkimi Sovjetik dhe Kina,

## VEPRA

ose si në ‘Pallatin c Ëndrrave...’, ngjarjet i kam vënë nën Perandorinë Otomane për t’u vctëmbrojtur.” Por ai dëshironte të linc një testament letrar, të shkruante atë çka mendonte për regjimin. “Vajza e Agamemnonit” është një nga tre librat-testament, i shkruar gjatë viteve ’80, i cili është nxjerrë në fshëhtësi nga Shqipëria, nga botuesi Claude Durand. “Kur e shkrova këtë libër, ndihcssha jashtë vendit, i lirë. Nuk bëja aspak kujdes.”


Ismail Kadarcja u përgjigjet të gjithë atyre që nuk do ta kuptojnë asnjëherë dhe do ta qortojnë përsëri se ka shërbyer, në mënyrë të pavullnetshme, si dorëzanë i një regjimi totalitar, se nuk ka asgjë për çka të qortojë veten. Ai nuk ka tradhtuar asnjëherë letërsinë. Vetëm ky krim do të ishte i pafalshëm.


VIEANNEY AUBERT \*

J

---

\* Vieanney Aubert është analist francez. Ky shkrim është botuar në *Le Figaro*, prill 2007.





8.0H-34  
K 14


Ismail Kadare

DIALOG  
ME  
ALAIN BOSQUET



54719

Onufri



### **ALEN BOSKE - Çdo dialog nuk është i plotë.**

*Çdo rrësim i një shkrimtari nuk do të kishte vlerë nëse nuk do të pyetjej imagjinata e tij, pra aftësia e tij për të fantazuar. Letërsia përbëhet prej hovesh, megjithëse të kontrolluar e të ruajtur por jo prej bravash apo çelësash. Libri juaj i parë, "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", shkruar më 1960 kur ju ishit 24 vjeç, u botua në frëngjisht më 1970. Ai tregon shumë më tepër se sa ajo që lexohet. U poq në mijëra ndërgjegje dhe është tërësia e vazhdimësive të tyre psiqike, estetike e ndoshta sociale. Në këtë bisedë nuk kemi ndërmend që të gjemë një të vërtetë të vetme, por të pohojmë se të vërtetat e tij janë të shumta, madje kontradiktore. Nuk besoj se biografja apo gjeografja do t'i mjaftonin atij për të dhënë një bazë spjeguese. Në çdo parabolë një vend të rëndësishëm zë ambiguiteti. Ç'do të ishte, në fund të fundit një libër pa ambiguitet? E hasim atë tek Hamleti, tek Berenice e Rasinit, tek Fausti i Gëtes e më vonë te Procesi i Kafkës apo në veprat e Bulgakovit...*

*Le të hidhemi, në se dëshironi, në morinë e pyetjeve që do të marrin përgjigje, gjithë duke pranuar njëkohësisht që përgjigje të tjera janë ose të dëshiruara*

*ose po aq mashtruese.*

Në një anketë, tradita kërkon t'i drejtohem i fëmijërisë së atij për të cilin bëhet fjalë. Është një metodë si të tjerat për të arritur një lloj objektivizmi. Lutemi na flisni për fëmijërinë tuaj në Gjirokastër, në qytetin ku keni lindur më 1936. Në atë kohë, në Perëndim, ky qytet i vogël quhej akoma Argyrokastro; ai ndodhet 20 km larg kufirit grek dhe 40 km larg brigjeve të Korfuzit. Zogu mbretëron e që prej 8 vjetësh dhe kufijtë e vendit ishin vendosur më 1913. Pushtimi italian nuk ishte i largët. Shqipëria numëronte rrëth një milion banorë. Cila ishte familja juaj? Ç'shkollë frekuentonit? Afërsia me Epirin a ju krijonte ndjesinë se jetonit në një tokë legjendash?

**ISMAIL KADARE** - Kam folur gjërësisht për fëmijërinë time në librin "Kronikë në gur". Megjithatë diçka mund të shtoj. Jam nga një familje e vjetër e Gjirokastrës, dhe një nga gjërat e para që më ka habitur në fëmini ishte kundërtia midis shtëpisë sonë të madhe trikatëshe dhe jetës tepër modeste që bënim. Im atë ishte një nëpunës fare i thjeshtë, postier gjyqi, (në vendin tonë kjo nuk kishte kuptimin e "kuissier"), megjithatë, duke qenë djalë i vetëm i një "dere të vjetër", (tek ne, si kudo, i jepnin rëndësi kësaj), ai u martua me një vajzë të pasur. Nëna ime ishte vajza e një gjykatësi, që ishte njëkohësisht pronar tokash dhe i disa dyqaneve në qytet. Megjithatë, edhe pas martesës im atë mbeti postjer, madje me kalimin e viteve, jeta jonë keqësohej vazhdimesht.

Në këtë kohë të turbullt, (fillimi i viteve '40), kur në Shqipëri fyrnin erëra fashiste e

komuniste, ku ndihej se lufta civile do bënte kërdinë dhe ku ndihej fillimi i epokës komuniste, fjalët "i pasur" e "i varfër" merrnin një ngarkesë të rëndë, që shpesh përcaktonin në mënyrë fatale fatin e njeriut, skajimin e tij në jetë dhe pa dyshim, karakterin e tij.

Unë u rrita në një familje ku ishin thyer -  $\zeta^m$  të gjitha klishetë e njoitura. Kjo vinte sepse im atë, ndonëse i varfër, nuk e donte komunizmin, kurse familja e nënës, ndonëse e pasur, ishte e lidhur me të. Kjo gjendje e përbysur e gjëra, krijoi tepër herët tek unë pavarësinë e të menduarit. Isha mësuar të dëgjoja në shtëpi talljet e hidhura të tim eti për dy ungjët e mi komunistë, ndërkaq, ndonëse e nderoja mendimin e tim eti, ungjët më tërhiqnin sepse ishin të dy studentë dhe në shtëpinë e tyre kishte libra. Por kjo klishe e përbysur më ndihmoi sidomos gjatë viteve të para të shkollës, atëhere kur diktatura komuniste e thyente karakterin e mijëra fëmijëve. Fëmijët e komunistëve të zellshëm ndiqnin shpesh herë shembullin e prindërve, duke u bërë militantë të zjarrtë, kurse fëmijët e klasave të përbysura vuasin nga kompleksi i frikës e i servilizmit. Gjendja ime "neutrale" më jepte atë liri për të mos qenë as në grumbullin entuziast të të parëve, as në kopenë e bindur të të dytëve.

Fëmijëria ime kaloi kështu në një gjendje të dyzuar. Në lagjen tonë, Palorto, unë, isha biri i një postjeri të thjeshtë. Por mjaftonte të shkoja për të bujtur disa ditë te gjyshi nga nëna, për ta ndjerë veten si nip i një pronari. Kjo ndodhë sepse jo vetëm shtëpia e vetmuar e gjyshit me

oborret dhe me kopështin e madh rrethues, vendosur midis një gremine dhe kështjellës mesjetare të qytetit, por krejt mënyra e jetesës ngjante me jetën e pronarëve, ashtu siç e tregonin filmat, ose siç do ta lexoja më pas në librat rusë. Një familje jevgjish, që jetonte në "odajashtën", domethënë në shtëpinë e jashtme, përveç detyrës së mirëmbajtjes së kopshtit, të gjithfarëlloj ndihme në punët e shtëpisë, të mbrojtjes në rast rreziku etj., në mbrëmjet e verës i duhej t'i binte violinës me orë të tëra në oborrin e shtëpisë, ndërsa ne rrinim të gjithë të heshtur rrotull shezlongut të gjyshit.

Te im gjysh fantazia ime u pasurua qysh herët me përmasa të tjera: pejsazhi i gjerë, gremina dhe kështjella vigane, një nga më të mëdhatë e më të lartat e Ballkanit, netët e verës me yjet që binin, nën tingujt e muzikës së jevgjëve, të gjitha këto as që mund të përfytyrohen në lagjen Palorto, ku shtëpitë ishin të shtrënguara njëra pas tjetrës dhe ashtu si shtëpitë, gjithçka tjetër ishte e ashpër dhe e zymtë.

Ndonjë ngjarje e prishte herë pas here njëtrajtshmërinë e ditëve. Një pasdite, më kujtohet, emtat e mia dhe dy-tre nga jevgjit, duke klithur mbanin për duarsh ungjin tim, i cili, si i ndërkryer përpiquej t'u shpëtonte. Dëgjoheshin vetëm fjalët "ka bombë!". Kur gjithçka u qetësua mora vesh se im ungj se ku kishte gjetur një bombë dhe ishte nisur t'ia hidhte dyqanin në erë këpuçarit, që ia kishte vonuar këpuçët e porositura!

Që nga shezlongu ku lexonte, gjyshi gati mospërfillës ndiqte skenën. Kështu me shpërfillje

kishte marrë vesh se djemtë i qenë bërë komunistë, që një ditë shteti komunist ia kishte shtetëzuar pronat dhe dyqanet, thua se të gjitha këto ishin gjëra që s'kishin të bënин me të.

Im atë mbeti gjer në fund një kundërshtar i heshtur i komunizmit. Sa për të dy ungjët, rrugët e tyre u ndanë më pas. I madhi, ai i bombës, u shkëput nga radhët e komunistëve, "për arsyе që nuk dëgjonte mirë". Në të vërtetë ishte gjysmë i shurdhët, dhe një ditë më shpjegonte se një njeri, po nuk dëgjoi mirë nga veshët, nuk mund të jetë komunist. "Në mbledhje mund t'i marrësh udhëzimet tjetër për tjetër, më thoshte, dhe kritikat mund të mos i dëgjosh". Pavarësisht nga kjo, ishte ndoshta njeriu i parë që, në mënyrë të thjeshtë më shpjegoi se më shumë nga gjithë organet e njeriut, diktatura ka nevoja për veshët e tij. Nëpërmjet veshëve propaganda e saj e trullos gjersa e mposht njeriun.

Sa për ungjin tjetër, me kalimin e viteve, atij iu rralluan flokët, por meqenëse rrallimi i tyre s'lozte, me sa dukej, ndonjë rol në marrëdhëni me doktrinën, ai vazhdoi të mbetej komunist.

Ç'të shtoj më tepër? Ndërtesa më e lartë në qytetin tonë ishte burgu. Ishte ndërtuar mbi kështjellë dhe dukej nga gjithkah. Në dimër dhe në vjeshtë, në ditët e ngrysura ai dukej shpesh sikur qëndronte mbi re. Një antiparthenon ose antiolymp i vërtetë.

Ju me siguri ju shkon mendja se një burg i tillë ndikonte për keq në psiqikën e qytetarëve. E pra, po ua them se ishte e kundërtë: një burg kaq i dukshëm, ndonse kishte tre shekuj që punonte, s'krijonte kurrfarë ankthi. Madje njerëzit nuk e

quanin burg, por "shtatë dritaret" për shkak të numrit të dritareve të katit më të lartë të tij.

Komunistët, si mjeshtra të terrorit, e kuptuan të parët se një burg që dukej nuk mund ta jepte kurrë tmerrin e burgut të padukshëm. Ata e kthyen kështu në depo djathi. S'duhej të kalonte mjaft kohë që njerëzit ta kuptionin se burgjet që s'i dinte kush se ku ndodheshin, e sidomos kampet me ato emërtime të pafajshme (kampi Nr.303 etj.), ishin dhjetë herë më tmerrues. Dhe vetvetiu e shihnin me nostalgji burgun, në dukje madhështor e kërcënues, që gjatë treqind vjetëve kishte prodhuar më pak ankth se ndërtesa petashuhe e Degës së Punëve të Brendshme gjatë tre vjetëve.

*A.B. - A ruani kujtime domethënëse nga lufta? Ç'përfaqëson për ju pushtimi italian, i cili, në vendet fqinje si p.sh. në Malin e Zi, mundi të zbusë, në mënyrë paradoksale, urrejtjet ndërmjet popullsive me etni të ndryshme? Italia për ju, shkollarin e vogël, ishte një barbari moderne apo një trashëgimtare e Romës? Në librin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" nuk duket se keni antipati për këtë vend. Ju ishit 8 vjeç kur Enver Hoxha mori pushtetin. Për çfarë duhet të studionit? Më duket sikur u mësuat të jetonit pranë Greqisë, ku lufta civile mundësoi alternimin e regjimeve ekstremiste. A mund të flitet, në rastin tuaj, për një ndërgjegjësim apo, më tej, për një zgjedhje të paramenduar? Cila është gjuha juaj e dytë?*

*I.K. - Ndonëse isha fëmijë në një qytet të*

humbur të Ballkanit, pata rastin që luftën ta shoh si një shfaqje theatrale, të plotë dhe gati të vënë në skenë nga një dorë mjeshtri. Një pjesë e lëvizjeve të ushtrive ndodhnin në rrugën automobilistike, që vinte nga veriu dhe shkonte drejt Jugut, domethënë drejt Greqisë. Përtej rrugës ishte aeroporti ushtarak, ku gjithashtu zhvillohej një pjesë e luftës, madje për mua pjesa më magjepsëse e saj. Nga shtëpia jonë dukeshin fare mirë rruga dhe aeroporti dhe pas tyre mali, prej nga, në epilogun e dramës do të zbrisnin komunistët për të marrë pushtetin.

Tre ushtri të ndryshme, përpëra se të hynin në qytetin tonë, kaluan nëpër këtë rrugë. Së pari ushtria italiane, që marshonte drejt Greqisë, një vargan i pafund mushkash, topash, autoblindash të shoqëruara nga një prapavijë e gjëzueshme, që e mbyllnin një kuvend murgeshash dhe një shtëpi publike për ushtarët. Kjo e fundit, e vendosur në qytetin tonë të vjetër puritan, lojti një rol të pazakonshëm në shpërthimin e fantazisë së qytetarëve, e sidomos të fëmijëve. E dyta ishte ushtria greke, e cila duke kundërsulmuar e shtyu prapë në veri ushtrinë italiane, me gjithë mushkat, kuzhinat, topat dhe së fundi, murgeshat dhe shtëpinë publike të saj. E treta ishte ushtria gjermane, që hyri në skenë pas kapitullimit të Italisë dhe shpartallimit të Greqisë.

Dy ushtritë e para pata rastin t'i shoh si në ditë të tyre të mira, domethënë plot me flamuj, borije e shkëlqim, si në ditë të këqija, të thyer e gjithë lecka. Po kështu aeroportin ushtarak herë e shihja të tmerrshëm e kërcënues, duke dërguar

avionët për të bombarduar Greqinë, e herë në mjerim, duke u bombarduar ai vetë prej englezëve. Këto përmbytje të fatit diçka më mësuan për përkohshmërinë e gjérave dhe pa dyshim, për fatalitetin.

Ju më pyetët pak më parë se a lojti ndonjë rol afërsia me Greqinë, që unë të kisha ndjesinë se jetoja në tokën e miteve antike. Mund të them, aspak. Në kohën që e dëgjova për herë të parë emrin e Greqisë dhe pashë ushtrinë e saj, unë as që e dija se ekzistonte letërsia greke, madje s'dija se ç'qe letërsia në përgjithësi. Në fëmijërinë time Greqia u shfaq në tri pamje: në fillim si një ushtri e rreptë, që shkaktonte ankth, për shkak të kujtimeve të këqija të luftës së parë botërore. Më pas, si një mizëri e pafund njerëzish të rreckosur: ushtarë, oficerë, civilë, që pas shpartallimit prej gjermanëve, lypnin bukë dhe strehim në Shqipëri. Pamja e tretë ishte e têrthortë, si e ridhënë nga një pasqyrë, fill pas luftës: prapë një mizëri refugjatësh, por këtë herë jo grekë por shqiptarë të Greqisë, që quhen çamë dhe që shteti i posamëkëmbur grek, pasi i kishte masakruar, po i dëbonte drejt Shqipërisë, me fajsimin si aleatë të gjermanëve.

Suç e shihni, Greqia, e njohur prej meje në fëmijëri s'kishte kurrrfarë lidhje me atë që do ta përmendja më pas në librat e mi.

Suç thashë pak më parë, pas largimit të motoçiklistëve të fundit gjermanë drejt veriut, (e vetmja ushtri që nuk u shpartallua në sytë tanë), nga malet përballë zbritën komunistët.

Dita e parë e çlirimt, (ajo që në libra dhe

filma do të përkujtohej si një festë mallëngjyese) ishte në të vërtetë një ditë pushkatimesh. Isha tetë vjeç, nuk kisha asnë kuptim politik të gjërave. Dija vetëm se ungjët e mi kishin fituar, kurse im atë mund të quhej i mundur. Dija gjithashtu se ata që po kërcoheshin me ngut për t'u pushkatuar ishin "tradhtarë".

Më pyetët për gjuhën time të dytë. Është rusishtja. Pas vendosjes së pushtetit komunist, në shkolla, gjuhët latine dhe frëngjishte u zevendësuan me rusishten. Të gjithëve iu dukej një gjuhë e rëndë, e mërzitshme dhe e pamësueshme për shkak të shkronjave cirilike. Ai alfabet ngjante tani si alfabeti i robërisë së re sllave. Dalëngadalë ai do të bëhej i urryer për një pjesë të njerëzve. Unë e mësova rusishten për hir të letërsisë. Dashuria për të më ndihmoi ta kapërcej nervozizmin e përgjithshëm.

*A.B. - Ju shkuat në Moskë për të vazhduar studimet e larta. Më kujtohet, gjatë takimeve tonë të para, nga mesi i viteve 70, kur hezitonit akoma te flisnit frëngjisht, ne bisedonim në rusisht. Përnjëherësh u detyruat ti nënshtroheni një edukimi marksist sistematik. A ju dukej i natyrshëm në atë kohë orientimi drejt një shkalle vlerash të sakta që ju imponohej? A ishte kjo për ju një nënshtrim me pasoja, apo thjesht një nënshtrim duke e ditur ndoshta se do të ruanit të paprekur vizionin tuaj për njerëzit e për shekullin? Ju a bëj këtë pyetje pasi gjatë kohës që ju ishit në Institutin Gorki, ndodhën shumë ngjarje të*

*rëndësishme: në fillim prishja e Titos me Stalinin e progresivisht ajo e Maos me regjimin komunist alla rus. Në këtë moment mund të zgjidhje komunizmin leninist ortodoks, titizmin apo maoizmin, duke supozuar se nuk ekzistonte një varietet shqiptar i socializmit. Insistoj ketu sepse shkrimet fuaja të para, që nga mesi i viteve 50, duhet të bazoheshin në këto zgjedhje: realizëm socialist, p.sh. sipas mënyrës së Mikhail Shollohov, ose refuzimi i çdo ortodoksie, sipas mënyrës së Pasternakut, pa ndonjë opozitë të dukshme. Besoj se e kuptioni ku dua të dal: para se të shkruanit librin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" u gjendët përpara një doktrine, një koncepti të vetëm, një tabuje? Më lind një pyetje pasuese: ç'është censura e brendshme e pranuar lehtësisht thjesht sepse shkrimtari i ri e di se duhet t'ia përshtasë vizionin e tij individual një discipline kolektive?*

**I.K.** - Kur dëgjoj fjalët "edukim marksist" më vjen për të qeshur. S'kam marrë kurrë kurrfarë edukimi marksist. Qysh se u njoha me letërsinë e madhe botërore, (isha rrëth 11 vjeç kur e lexova "Makbethin" dhe u magjepsa kaq shumë pas tij sa e kopjova me dorë. Kështu që mund të thuhet se ky është libri i parë që kam shkruar). Pra qysh nga ajo kohë, asgjë s'kishte fuqi të depërtonte vërtet në trurin tim. Ajo që ndodhë te kështjella Elsinor e Hamletit ose te muret e Trojës, vazhdonte të më tërhiqte e të më shqetësonte shumë herë më fort se gjithçka e përditshme. E ndjeja veten banor të një bote tjetër dhe njihja vetëm ligjet, pushtetin dhe frikërat e saj. Kjo vazhdoi një kohë

shumë të gjatë, në lice, pa dyshim, që e kreva në qytetin e lindjes, por edhe më pas në fakultetin e letërsisë në Tiranë. Asgjë që nuk kishte hijen e misterit s'më terhiqte. Më kujtohet e qara e mësueses së rusishtes, një grua nga Moska, ditën e vdekjes së Stalinit. Ishte hera e parë që shikoja një të qarë, si të thuash, "shtetërore", "socialiste". Unë që isha mësuar të shihja e të dëgjoja të qarat rituale të grave ballkanase në ceremonitë mortore, të cilat veç një modifikim të vogël kërkonin për t'u kthyer në shfaqje të vërteta dramatike, e qara e ruses m'u duk e shplarë, për të mos thënë e shëmtuar. Kështu, një filtri i vendosur diku, brenda meje, i ndante gjërat aty për aty në të tilla që më joshnin e në ato që s'i përfillja.

Kur mbërrita në Moskë, në institutin "Gorki", unë e kisha atë filtri shpëtimtar. Ky ishte një institut që duhej të fabrikonte turmën e shkrimtarëve skllevër të komunizmit. Për fat të mirë, ndonëse e ndjeva veten të dehur nga liria që më jepte qyteti i madh metropolitan, (çdo djalë njëzetedyvjeçar ballkanas, pavarësisht nga ç'vend vinte, do ta ndiente këtë dehje), unë isha i mbrojtur nga e keqja e fshehtë e tij. Në atë kohë Moska jetonte periudhën më të mirë të liberalizimit. Më pëlqeu shumë qysh në fillimjeta prej studenti, mbrëmjet e vallzimit dhe netët e pa gjuma dhe pa dyshim, vajzat ruse, të cilat një ballkanasi i duken dyfish më të ëmbla dhe lehtësisht të arritshme në krahasim me vajzat kokëforta e trillane të gadishullit. Por duhej veç pak kohë për të pikasur pas kësaj jete të këndshme çmersin (çimenton) e robërisë. Atje, për herë të parë, e kuptova se ç'ndryshim të thellë kishte

midis një diktature dymbëdhjetë vjeçare, që ishte ajo e vendit tim, me diktaturën dyzetë vjeçare të atjeshme. Shumë gjëra dukej se kishin vdekur përgjithmonë, të tjerat bënин të ngjalleshin e nuk ngjalleshin dot. Në Shqipëri sundimi ishte më shponjës e më bezdisës, por jo i thellë e i shurdhër si këtu. Përshebull, nuk e përdorja dot fjalën "shok", që ketu ishte bërë zotëruese. Tek ne përdorej në mënyrë të natyrshme, vetëm kur iu drejtoheshe zyrtarëve komunistë. Ndryshtë, në jetën e përditshme, merrej ose si tallje, ose si sharje. Fjalët "zotni" dhe "zonjë" vazhdonin, ndonëse të drojtura, të përdoreshin në Shqipëri. Kurse këtu as që mund të mendoheshin. Por gjëja më e tmerrshme ishte ajo që më ndodhi me letërsinë dhe shkrimtarët. Ajo që përmua kishte qenë kuptimi i vetëm i jetës sime, gjëja më e shtrenjtë dhe e pazëvendësueshme nga asgjë, befas m'u ftoh. M'u neverit gjer në atë shkallë sa që vendosa ta braktis. Kisha turp prej letërsisë dhe emrit shkrimtar, sa që fillova ta fsheh që jam i tillë.

Kjo krizë që më vazhdoi më shumë se një vit, varrosi përfundimisht tek unë çdo ndikim të mundshëm të të famshmit realizëm socialist sovjetik. Kisha një zvjerdhje të plotë për të. Madje vetë pamja e shkrimtarëve sovjetikë më dukej gjysmë qesharake. Me përjashtime të rralla, si p.sh. Paustovski, Jevtushenko, Çukovski e ndonjë tjetër, ata që unë njihja dhe që vërtiteshin në rrugën Hercen ku ishte Bashkimi i Shkrimtarëve dhe në Institutin tonë, ngjanin si sekretarë partish ose udhëheqës. Nuk i duroja dot veshjet e tyre të çelëta optimiste, buzëqeshjen e vetëkënaqur një

gjoja çiltëri e mungesë dekadentizmi në fytyrat e njallura. Edhe një poet që e çmoja, Aleksandër Tvardovski, për shkak të poemës që sapo qarkullonte dorë më dorë "Vasil Tjorkini në botën tjetër", nga pamja dhe mënyra e të folurit më shëmbellente si anëtarët e K.Q. (Ngjante çuditërisht me Jelcinin e sotëm).

Është e mundur që unë bëj pjesë në këtë aradhe të pështirë? thoshja me vete, sa herë që më dilnin përpara. Dhe betohesha të mos e merrja më penën në dorë.

Kështu që përpara meje s'kishte kurrfarë doktrine, kurrfarë hezitimi, mëdyshje apo zgjedhje. Ishte thjesht letërsia e madhe, ajo e hijeve të Shekspirit dhe letërsia bezhë socialiste(kështu shtresohej në ndërgjegjen time për shkak të palltove bezhë "optimiste", që mbanin shumica e shkrimtarëve), që skajoheshin përballë njëra tjetrës.

Më kujtohet, kur në seminarin e poezisë më erdhi radha mua të paraqes një cikël vjershash, ato u priten shumë keq. Seminarin e drejtonte një poet me emrin Smeljakov, (në rusisht Buzëqeshësi!). Fytyra e tij zakonisht e çelur sovjetike u egërsua, me atë egërsimin e keq të fytyrave të ngjallme. Ai i quajti vjershat me fryshtë dekadente, të sëmura dhe të papranueshme "për ne". Sidomos ishte tërbuar nga vargu: "Pa formë është qielli si tru idioti". My nje prinjimajem takuju poezijù, i nje hatjim prinjimat" (Ne nuk e pranojmë një poezi të tillë, dhe nuk duam ta pranojmë").

Pa e tepruar mund të them se ndërsa ai fliste, unë ndjeja një lloj gëzimi të mbrapshtë. Kritika e parë kundër meje ishte formuluar kështu

nga një shkrimtar zyrtar sovjetik.

Një çast ai ngriti sytë nga dorëshkrimi dhe pyeti me zë të hidhur:

-Këto vjersha a janë botuar në vendin tuaj dhe si janë pritur?

-Janë botuar, -iu përgjigja, -dhe janë pëlqyer. Ai tundi kryet kërcënueshëm.


-Këtu është ndryshe, -tha.

"Këtu" ishte qendra e botës komuniste dhe unë e kuptova se në qendër isha i papranueshëm. Por, për çudi, gëzimi i egër, i mbrapshtë nuk më braktiste.

**A.B.** "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" është një ushtarë i rangut të lartë, i dalë nga borgjezia kapitaliste e konservatore italiane: ai është krenar për të kaluarën e tij, për shoqërinë së cilës i shërben, për të mirën që mendon se i bën rrethit të tij duke kërkuar tek armiku, në pejsazhin e ashpër shqiptar, heronj të rënë për atdheun. Që duhet t'i gjesh ato. Autoritetet shqiptare, megjithë ngurimin e përqimin, marrin urdhër për bashkëpunim. Komunizmi di t'i flasë përparrë kapitalizmit: kjo ish parashikuar që me NEP-in e Leninit. Gjenerali vërtet nuk është antipatik, por edhe fshatarët shqiptarë nuk janë më simpatikë se të tjerët. E nesërmja nuk i buzëqesh askujt. Çdokush ruan mendimet, idealet dhe shtrembërimet e veta. Armiqësia nuk duhet të përjashtojë një pëlqim reciprok. Meqë misioni i gjeneralit është një disfatë e pjesshme ju devijoni papritur në

*zona më të rrezikshme ose, si të thuash, më të nxehta. Edhe gjermanët bëjnë të njëjtat kërkime. Iracionalja imponohet papritur: një skelet gjerman do të zëvendësojë një skelet italian dhe familjet do të lumtërohen nga gjetja e të dashurve të tyre të humbur. Një shpërthim të qeshurash, ku të gjithë janë bashkëfajtorë, përfshirë edhe patriotët shqiptarë. Farsa kthehet në moral e burleskja nuk mund të evitohet. A i kishit bërë ndryshime ju vetë më parë variantit që doli në shtyp tek ju? A pësoi ndryshime ai në një kohë të dytë, pas ndërhyrjes së autoriteteve?*

**I.K.** - Kur e shkrova këtë roman më 1962, pas kthimit nga Moska e ndjeja veten ende të lirë. Skllavëria është si e ftohta, ajo të pushton shkallë-shkallë. Robëria komuniste kishte prekur disa pjesë të qënies sime por ato ishin ende në rrëthinat e saj. Ajo s'kishte depërtuar ende brenda tempullit, domethënë në krijimtarinë time. Romani im i parë në të vërtetë nuk është ky. Është një tjetër roman i shkurtër me titullin "Qyteti pa reklama". E kisha shkruar, ose më saktë, gjysmë shkruar, gjysmë regjistruar në manjetofon, një pjesë në Moskë, një pjesë në Tiranë. Ishte një roman krejt i lirë, ku tregohej aventura e dy studentëve parazitë, që donin të falsifikonin dorëshkrimin e një vepre të humbur të letërsisë shqipe, duke kthyer kështu kokëposhtë krejt historinë e saj. Një miku im më tha se duhej ta zhdukja veprën sepse ishte tejet e rrezikshme. Unë ndoqa një rrugë të mesme, veprën s'e çova për botim, por nxora një të katërtën e saj, rreth 25 faqe, që



arrita ta botoj si tregim në gazetën "Zëri i Rinisë", në dy numra, me titullin "Ditë kafenesh". Tregimi u ndalua menjëherë. Shefit të rinisë shqiptare, Todi Lubonja, me ndërhyrjen e të cilit u botua fragmenti, iu hoq vërejtje e rëndë. Më vonë ai do të futej në burg si liberal për 15 vite rrreshth.

Kjo goditje e parë s'më bëri përshtypje kushedi çfarë. Sapo kisha dalë nga kriza, isha ripajtuar me letërsinë dhe padyshim, isha ende nën narkozën e saj. Pas ndarjes së përkohshme dashuria për letërsinë më ishte dyfishuar. Subjektin e "Gjeneralit" e punova disa herë. Kur e paraqita më në fund në formën e romanit, redaktori më bëri një vërejtje themelore: ishte i vetmi roman me temë nga lufta antifashiste ku mungonte, jo vetëm roli i partisë komuniste, por nuk përmendej as emri i saj. S'po merrem me të tjerat, tha, por mungesën e partisë nuk ta fal dot.

E mora dorëshkrimin dhe pasi e shfletova shpejt e shpejt e kuptova se ishte një kërkesë vrasëse për veprën. Megjithatë m'u deshën vetëm tre-katër minuta, për të bërë retushin e nevojshëm. Në kreun e pestë, në mesin e tij shtova vetëm një frazë anodine, frazë që mund ta shkruante çdo shkrimtar në botë, qoftë perëndimor, fetar, fashist, komunist, apo dekadent. "Gjenerali" pinte kafe dhe vështronte parrullat në mure. Kuptoheshin vetëm fjalët "revizionizëm" dhe plenum dhe emri i Enver Hoxhës nën një citim të shkurtër.

U ktheva pas ca ditësh në shtëpinë botuese me dorëshkrimin në duar dhe me pamje triumfatori. I thashë redaktorit se në vend të emrit të partisë, kisha shkuar më larg, kisha vënë emrin e shefit

kisha shkuar më larg, kisha vënë emrin e shefit të saj, dhe ai tha "aq më mirë". Ç'është e vërteta, kur pa frazën, mblodhi buzët, por s'kishte ç'thoshte. Emri i diktatorit ishte shtypës. Me zemër të thyer pranoi që vepra të shkonte në shtyp.

Dalja e romanit shkaktoi një tronditje në letërsinë shqipe. Vala e ngazëllimit midis lexuesve ishte e madhe, por kritika zyrtare u tregua e rreptë. Ajo e fajësoi romanin për dy gjëra: e para, për klimën e zymtë, që vinte në kundërshtim të plotë me atmosferën festive të letërsisë të realizmit socialist, dhe e dyta, dhe kjo ishte edhe më e rëndë, për mungesë urrejtjeje ndaj armikut. Kjo akuzë në terminologjinë komuniste formulohej si "dobësim i luftës së klasave". (Të mos kishe urrejtje ndaj një gjenerali perëndimor, pra një gjenerali të NATO-s, në një vend si Shqipëria, quhej vërtet një mëkatë e madhe). Sa për vërejtjen tjetër, atë më thelbësoren, atë që digje si zjarri, mungesen e partisë komuniste, atë nuk e përmendi kush. Ishte një nga zakonet e brendshme të komunizmit që shpesh të mos përmendej faji kryesor, ai që të conte në burg ose në pushkatim, për arsyen se quhej i rrezikshëm dhe nxitës për rebelim, qoftë edhe vetëm me përmendjen e tij. Kjo ndodhе p.sh. në gjyqet, ku ishte e ndaluar p.sh. të përmendeshin sharje kundër diktatorit, por në akuzë ato zëvëndësoheshin me fajsime të tjera. Në të vërtetë ishte ajo që nuk thuhej, që të conte në greminë.

Kështu "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" hyri në letërsinë shqipe, gjysmë i lejuar, gjysmë i ndaluar. Pas dy-tre vitesh ai pothuajse nuk përmendej

më, thua se nuk ekzistonte, zakon tjetër ky i kësaj bote, që, kur nuk i pëlqente një vepër, hiqej se vepra kishte vdekur, gjersa libri u botua në Francë më 1970, çka e prishi heshtjen për të.

**A.B. - Për një perëndimor si unë, interes i pakrahasueshëm i "Gjeneralit të ushtrisë së vdekur" nuk qëndron tek lidhja, në fund të fundit realiste, ndërmjet një fakti të çfarëdoshëm menjëherë pas lufte dhe rrethanave me të cilat u zhvillua kjo luftë, as në dekorin shqiptar që ju keni zgjedhur. Ai qëndron tek rasti shembullor. Kur shkrimtarë të tjerë të respektuar kanë shkruar romane mbi këtë periudhë të historisë, janë kënaqur me një reportazh që synonte të jepte të vërtetën njerëzore, pa shkuar më tej. Për këtë mund të japim shumë shembuj: përveç Donit të qetë të *Mikhail Cholokhov* që shërben si model i kësaj gjinie, mund të përmendja dy romane amerikane mjaft të fuqishëm si: "Për sa kohë aty do të ketë njerëz" i *James Jones* dhe "Lakuriqet e të vdekurit" i *Norman Mailer*. Në Itali kemi, megjithë ekseset e tij "Kaput" i *Curzio Malaparte*. Në Francë mund të përmendim "Heshtja e detit" e *Vercors* që paraqet bashkëmarrë-dheniet e një humorit të zakonshëm, sipas mënyrës post simboliste, e afërt me atë të *Maurice Maeterlinck*, 70 vjet më parë, dhe "Fund jave në Zuydcoote" i *Robert Merle*, një përbledhje shumë pak letrare mbi betejën e Dubkerkut. Tek ju vërejmë diçka krejt tjetër. Ju hyni në legjendë dhe drama e dubluar me një farsë nuk është për ju qëllimi kryesor. Këtu mund të flitet për dimensione ëndërrimtare**

*ky libër? Për më tepër ju nuk akuzoni askendose të gjithë- ju nuk i ndani njerëzit në luftë në të "mirë" e në të "këqinj". Çfarë vështirësish keni përballuar për të bindur autoritetet se - një shkrimtari të panjohur - mund t'i lejohet një paanësi mitike? Në atë kohë, të gjithë librat btoheshin me aprovin e pushtetit dhe të Partisë.*

I.K. - Siç ju thashë pak më parë, kur e shkrova këtë roman una kisha një liri të brendshme të plotë. Njihja, si të thuash, vetëm një hyjni, letërsinë, dhe i bindesha vetëm asaj. "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" ka atë përmasë ëndrrë, ose atë përmasë mitike, siç thoni ju, sepse vepra lindi natyrshëm, jashtë çdo trysnie doktrinore, ose ideje për t'i shërbyer diçkaje. Mendoj se mbrapështija kryesore e çdo libri të realizmit socialist nis që në fillesën e saj, domethënë me llogaritjen për t'i shërbyer një teze, një kohe apo dreqi e di çfarë. Është ky mëkat fillestar gjenetik që përcakton humbjen e veprës. Unë e kam vështirë ende sot të shpjegoj qartë ku e kanë fillimin shumica e veprave të mia. Kjo më duket po aq e pamundur sa të shpjegoj fillimet e një ankthi, burimet e të cilit shtrihen në një tjetër ankth, e ky tjetri, në një tjetër, e kështu me radhë.

Tregimi për gjeneralin që kërkon të çvarrosë një ushtri, e ka zanafillën e vet në një natë të ftohtë moskovite, kur në trurin tim, si kundërveprim ndoshta i optimizmit sovjetik në letërsi, i ngjyrimit rozë, që niste që nga moti i kthjellët, (me veten time e quaja meteoskematizmi), e që vazhdonte

me moralin, idetë dhe një lloj mirësie të neveritshme, një kinse mirësi, që në të vërtetë s'ishte veçse pudra që mbulonte shkretëtirën e që mbaronte me një ide, që s'ishte veçse një nga ligjet e doktrinës marksiste. Zanafilla e "Gjeneralit" pra, mund të them, se ishte një prostitutë e vrarë gjatë luftës, një prostitutë e shtëpisë publike italiane, që na trazoi aq shumë fantazinë të gjithëve në atë kohë të fëmijërisë sime, ose më saktë, jo vetë prostituta, as kufoma e saj, por eshtrat e saj, pas njëzetë vjetësh, shtrirë në tokë, midis eshtrave të qindra ushtarëve, ndërsa lart, në sipërfaqe, dëgjohen kazmat e një gjenerali, që ka ardhur ta çvarrosë këtë ushtri.

Ja kështu, pak a shumë u sajua fetusi (embrioni) i këtij romani, i huaj krejtësisht, në laboratorin, ku Instituti "Gorki" përgatiste modelet e veta. Në të vërtetë veprën e shkrova pasi u ktheva në Shqipëri.

Unë u ktheva në Shqipëri nga fundi i vitit 1960, kur marrëdhëni me Bashkimin Sovjetik po ftosheshin dita ditës. Koha ishte relativisht liberale. Pas shkëputjes së plotë nga kampi socialist më 1961, diktatori ynë, Enver Hoxha, po ndërmerrte ca veprime tepër dinake për t'i pëlqyer Perëndimit. Bënte sikur po lidhej me Kinën, për t'u përligjur përpara komunistëve veteranë për braktisjen e kampit komunist, por në të vërtetë hezitonte. Mendjen e kishte te Perëndimi dhe dërgonte herë pas here shenja atrimi, shenja të cilat ky i fundit nuk i vinte re, ose bënte sikur s'i vinte re. Një nga këto shenja ishte zbutja e politikës në kulturë, sidomos në letërsi.

Për fat të keq, shumica e shkrimtarëve shqiptarë nuk ditën ose nuk deshën të përfitonin nga kjo klimë. Shkrimtarët stalinistë u bënë bllok kundër ne, të rinjve (përveç meje ishin poetët D. Agolli dhe F. Arapi), duke na bërë fajësimet më të rënda: antikombëtarë, dekadentë, kozmopolitë etj. Në një mbledhje dramatike në korrik 1961, diktatori, që ishte me siguri në dijeni të grindjes, erdhi befas të merrte pjesë dhe, për habinë e të gjithëve, mbajti anën e "të rinjve" kundër të "vjetërve". Ishte hera e parë që në Shqipëri ndodhët një gjë e tillë. Por, duhet të më kuptoni se kjo ishte një zbutje relative, madje tepër relative. Një "zbutje" në Shqipëri shkonte p.sh. gjer atje që pas kritikave që iu bënë "Gjeneralit", nuk u dënuia autori me bujë, por vetëm iu bë një paralajmërim.

Ndërkaq, ne "të rinjtë" duke e marrë seriozisht zbutjen, me një arrogancë të pashembullt i vumë përpara ca kohë shkrimtarët stalinistë, i tallëm e i fyem pa mëshirë. Ndërkaq, më i pabindur se kurrë ndaj doktrinës së realizmit socialist, unë shkrova veprën e dytë, romanin e shkurtër "Përbindëshi", të cilin e botova më 1965, në revistën letrare. Kjo ishte një vepër që jo vetëm i thyente të gjitha ligjet e teknikat letrare të socializmit, por përshkohej nga lejtmotivi i ankthit dhe terrorit politik.

Shteti diktatorial u përmend menjëherë nga kinse përgjumja e tij. "Përbindëshi" u ndalua menjëherë, madje në atë mënyrë, që as titulli nuk do t'i zihej më ngoje askund, madje as në numrin 12 të revistës ku, sipas traditës, shënohej

krejt lënda e botuar gjatë vitit.

Ishte ndeshja ime e parë e drejtpërdrejtë me diktaturën. "Përbindëshi" tërroqi në humnerë edhe "Gjeneralin". Po afronte viti 1966, kur tirani, pas mospërfilljes së Perëndimit i la mëdyshjet dhe vendosi të lidhej fort me Kinën. Isha tridhjetë vjeç dhe shumicën e veprës e kisha të ndaluar. Kjo ishte pak a shumë klima e kohës.

*A.B. - "Dimri i madh" me 600 faqet e tij krijon për ju dhe për mundësitë tuaja një imazh të ri. Në vend që të kërkonit mitin, legjendën apo ekstrapolimin, ju zhyteni në kushtet politike. Vërehet një këmbëngulje e veçantë, një refuzim konstant për të romanizuar të vërtetën, një angazhim me të gjitha forcat për të thënë se shekulli është i pamëshirshëm e temat kombëtare nga më të rrezikshmet. Ju mund të kishit shkruar po me atë energji mbi marrjen e Bastijes, kthimin e Napoleonit nga Elba apo pasojat e atentatit të Sarajevës më 1914. Atë për të cilën ju shkruani e keni jetuar nga afër. Më 1961, Shqipëria e Hoxhës ndërpërt marrëdhëni me Bashkimin Sovjetik të Hrushovit. Ky vend i vogël merr iniciativën për t'u shkëputur nga një Perandori, që deri atëherë, e quante veten mbrojtëse të saj. Në Moskë, vihen përballe njëri-tjetrit dy vizione të komunizmit në fuqi. Hrushovi detyrohet të bjerë në ujdi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës; ai nuk është fanatik dhe është i pari që guxon të denoncojë abuzimet e stalinizmit. Për Perëndimin, Hrushovi shënon një hapje dhe të parin ngadalësim, pas episodit të raketave në*

Kubë, të garës së armatimeve bërthamore. Kjo hapje është e dyshimtë për autoritetet shqiptare dhe ndërprerja e marrëdhënieve i dedikohet Hoxhës. Për të, Rusia është fajtore pasi ka tradhtuar idealin. Ortodokzia kërkon të mos përzihesh me vaktësira dhe të mos lëshosh përpëra kërkësave urdhëruese materiale. Hoxha në këtë rast është purist: ai do me çdo kusht t'i lërë këtë imazh intransigjent popullit të tij. Ai nuk mund të pajtohet me tradhëtinë. Divorci tashmë është arritur. Menjëherë lindin dy pyetje: a do të ishte qëndrim heroik verbëria para një ideali tashmë të paarritshëm? Supozojmë se po, ç'pasoja do të kishte kjo mbi popullin? Deri këtu, libri është një kronikë e ngjarjeve ashtu siç ka ndodhur e siç keni qenë dhe ju dëshmitar. Aspekti i dytë është me tronditës: a ka akoma të drejtë, madje edhe nga pikëpamja marksiste ortodokzia, e marrë nëpër këmbë nga Tito dhe e korrigjuar nga Mao? Largimi i përshtypjetuar nga Moska pasohet me raprezalje të menjëherësme. Lidhjet tregtare ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë ndërpritën plotësisht. Duke mos pasur më mbrojtje- apo mos duhet thënë tutelë?-, vendi juaj rrezikon të asfiksohet. Një diktator duhet të bëjë ç'është e mundur që populli ta ndjekë cilatdo qofshin rrëthanat. Kështu, libri merr hov në gjysmën e dytë të tij. Para se të rifitonë besimin tek diktatori, populli duhet t'i nënshtrohej një lloj "larjeje truri" sistematike. Përfaqësuesit e tij do të votojnë besimin për Hoxhën ende pa u informuar mirë për zhvillimin e përfundimin e bisedimeve. Votohet së pari çështja e mirëbesimit dhe më pas mësohet për çfarë bëhet

*fjalë. Plebishiti do të pranohej veçse të nesërmend e votimit. Në se do të flisnim me paanësi, kjo është një akuzë e tmerrshme: edhe një herë tjetër populli vihet në lojë.*

*Ne thelb, në librin tuaj ka dy të akuzuar: komunizmi hrushovian, pasi ai nuk është më një komunizëm i pastër dhe i fortë dhe komunizmi alla Hoxha, që është një diktaturë proletariati që nuk i njeh faktet dhe detyrohet të shprehet në injorancë. Çfarë komentesh ka ngjallur tek ju libri juaj? A u shtiren sikur se kuptuan vizionin tuaj, i cili duke mos qenë në pamje të parë dhe sipërfaqshëm kritik, është i tillë, bile mjaft i egër, po të thellohesh mirë?*

**I.K.** - Pjetja juaj është me të vërtetë e vështirë, për të mos thënë e pamundshme për t'i dhënë një përgjigje. Siç ua thashë pak më parë asnijëherë shkrimtari s'mund të dijë ku e ka nismëtimin vepra e vet. Në librin tim "Ftesë në studio" jam përpjekur të shpjegoj diçka, por e di se kam shpjeguar shumë pak ose shumë keq.

Ju tregova për eshtrat e një prostitute, që përbënин tharmin e romanit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", por tani që po e rimendoj më duket se jam përafërsisht i saktë, por kurrsesi plotësisht. Eshtrat e një prostitute kanë qenë vërtet në themel të këtij libri, por ato s'ishin veçse një fazë e mëvonshme, një sendërtim i mëtejshëm i një turbullire të vjetër, kurse zanafilla e vërtetë duhet të ketë qenë më thellë. Një rrashth kali ndoshta një rrashth kurrizor kali i zbardhur, me një mbeturinë palce përbri djerrinës së fushës së aeroportit, që

e kisha parë gjatë një pikniku në fëmini dhe që më mbeti në mëndje për një kohë të gjatë, aq sa, sa herë që shikoja kuajt, nuk e largoja dot nga truri im e që mund të ishte më pranë zanafillës jo vetëm për "Gjeneralin" por edhe për "Doruntinën". Ky rrasht ishte vetëm pjesa lëndore, por i vetëm, i pashoqëruar nga diçka tjetër, diçka e gjallë, e mjegullt-frika nga vdekja, ëndërrim për sprapsjen e saj, brengë e së paarritshmes-, s'mund të shërbente si farë për ngjizjen e diçkaje.

Ndoshta kjo që them është e paqartë. Një herë kam parë në ëndërr një grua që isha i sigurtë që kisha një mijë vite që e njihja dhe lumturia që ndjeja ishte aq e dendur saqë s'mund të krahasohej me asnjë gëzim të kësaj bote. Më ka mahnitur përherë dëndësija e ndjesive në ëndrra. Që janë projektime të dërguara nga sfera të tjera, që kryqëzohen rastësisht me ne, kjo është e kuptueshme. Por ne, në shumicën e rasteve, s'jemi në gjendje të kuptojmë shenjat e tyre. Në ndërgjegjen e shkrimtarit, kështu rrjinë, si të mytura thellë "ato" që s'kanë as emër, sepse është vërtet qesharake t'i quash motive ose subjekte, ose, ruajna Zot, ide, ato tmerre.

Ti s'bën gjë tjetër veçse përpinqesh t'i ngresh në sipërfaqe. Por edhe në rastin më fatlum, kur ngrihen, pikërisht gjatë ngritjes ato nisin e firojnë mu në sytë e tu, treten, zbehen, zhvishen nga misteri, gjersa kur dalin lart, në shumicën e rasteve, s'janë veçse kufoma. Me sa duket, drita e botës sonë, klima, saktësia i vret aty dhe ty s'të mbetet veç t'i lëshosh përsëri.

Por edhe kur njëra prej "tyre" arrin e gjallë,

atë e pret një provë e tmerrshme. Ka përherë një kundërthënie dramatike në procesin e krijimit. Brishtësia e tharmit të veprës së ardhshme, misteri, mjegulla, shumëkuptueshmëria e tij gjenden përballë tiranisë, disiplinës së artit. Ajo që është fryma më e lirë në botë, e merr këtë liri përmes një pengese, një kufizimi, shkurt përmes makinës së teknikës të së shkruarit. Shkrimtari s'është gjë tjetër veçse mjeshtri i kësaj makine të torturës.

Arti, siç e thotë fjala, është një gjë artificiale. Kjo fjalë që duket si përcmuese, s'ka të bëjë fare me përcmimin në këtë rast. Përkundrazi, sublimitetin e vet arti e merr vetëm pas kësaj prove. Nëpërmjet torturimit, vrasjes, me fjalë të tjera, nëpërmjet vdekjes, arti merr jetë.

Për shkrimtarin, zbulimi i teknikave të reja të të shkruarit është një nga mundimet që mund të krahasohet me ato të Tantalit. Në pamjen e parë të duket se s'është aq e vështirë të zbulosh teknika të reja. Mirëpo pikërisht këtu nis një diçka e habitshme, një forcë mizore, ndaluese, e ngjashme me tërheqjen e tokës që nuk të lë të shkosh më lart. Kjo, më shumë se me ty, ka lidhje me tërë botën, me mekanizmin e shijes së krijuar prej shekujve, falë të cilit njerëzimi arrin ta marrë kumtimin tënd. Në qoftë se ka shkëputje gjithçka merr fund.

Për ta shpjeguar këtë gjë tepër të lodhshme do të bëja një krahasim me gjëra që i njohim mirë p.sh. me dashurinë. Të gjithë ne kemi dëshirë për risi në dashuri, për surpriza, zbulime të reja etj., por të gjitha këto s'mund t'i përftojmë dot jashtë një kufizimi. Ky kufizim është vetë trupi

i femrës, ose më saktë, seks i saj. Ne nuk do të na shijonte kurrsesi një seks tjetër, ta zemë në formë ylli deti, apo embleme, apo kurorë mbretërore etj. Fola për një gjë të prekshme siç është seks i femrës. Por mendoni diçka më të ndërlikuar: mekanizmin e pendimit, ose të mëshirës...

Ravgimi midis tundimit për të krijuar teknika të reja të shkruari dhe frikës së shkëputjes nga trungu kërvizak mijëvjeçar, është një nga torturat e shkrimtarit. E pas saj vijnë të tjera, p.sh. ndeshja me gjuhën. Kjo është vërtet një ndeshje tragjike. Gjuha është një tirane e vërtetë. Ajo kërkon që njerëzit të flasin sipas ligjeve të saj, mundësish njëlloj. Shkrimtari kërkon të kundërtën, të flasë sipas mënyrës së vet. Përfytja e tyre është titanike, dhe shkrimtari që mbërthen shkronjat dhe fjalët e gjuhës në faqet e veprës së vet duhet të jetë, veç të tjerash, si karakter, i pamëshirshëm.

Nëpër një mundim të tillë kalon shkrimtari (ju lutem, të më kuptoni, e kam fjalën për krijuesit e vërtetë) përpara se të mbërrijë përpara murit të fundit: shtetit diktatorial. Në qoftë se atë nuk e kanë thyer dot prangat e gjertanishme, diktatura e ka vështirë ta thyejë. Shumë shumë ajo mund ta gjymtojë, ti këputë ndonjë copë, por nuk mund ta shfytyrojë dot. Kurse në qoftë se ai është thyer qyshkur dhe kur mbërrin përpara murit është i vdekur ndërkaq, s'i mbetet veç të thërrasë: mua më shkatërrroi diktatura! Për shumë njerëz kjo mund të jetë e besueshme, por atyre që e dijnë ç'është krijimi i vërtetë letrar, s'u mbetet veç të buzëqeshin.

Çështjet e komunizmit, si çështje të brendshme

doktrinare, s'më kanë interesuar asnjëherë seriozisht. Ose, më saktë, më kanë interesuar vetëm kur kishin lidhje me fatin e popullit tim. Komunizmi ishte vërtet i tepërt për këtë vend e për këtë komb që, pas dy mijë e ca vitesh të egzistencës së vështirë, i lodhur sa më s'bëhet nga historia iu desh të përbollonte edhe këtë flamë.

Te "Pesa e kryqit" kam përshkruar hollësisht rrëthanat se si dhe pse u shkrua "Dimri i madh" ose "Dimri i vetmisë së madhe", siç ka qenë titulli i botimit të parë.

Në vitet 1967-1969, pas lirisë relative të viteve 60, unë u gjenda në mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të regjimit, ose më saktë të vetë diktatorit. Ndonëse kisha vetëm tre libra vjershësh të botuara, si dhe tre romane: një të pabotuar "Qyteti pa reklama", një të kritikuar rëndë "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" të tretin të ndaluar "Përbindëshi", isha pa dyshim shkrimtari më i njobur i vendit. Shumë shpejt e kuptova se kjo ishte një fatkeqësi e vërtetë. Syrit të tiranit, që për fatin e zi të shkrimtarëve ishte gjithashtu një gjysmë shkrimtari, nuk i shpëtoje dot. Përpara meje kishte tri rrugë: e para, të konformohesha, duke shkruar si shumica e shkrimtarëve shqiptarë, e dyta, të braktisja më në fund letërsinë, e treta, të mos konformohesha, por për këtë të paguaja një taksë.

Rrezikun e konformizmit e kuptova kur shkrova e botova romanin "Dasma" më 1967-1968. Ndonëse vepra u botua më pas në disa vende, ndonëse BBC e Londrës i bëri një radiodramatizim ("Dasma dhe fantazma"), unë aty për aty e kuptova se kjo ishte fillimi i vdekjes sime si shkrimtar,

ndaj vendosa të mos bëja kurrë asnjë lëshim në letërsi.

Zgjidhja e dytë: braktisja e letërsisë, më dukej gjithashtu vdekje, ndonëse e një lloji tjetër. Kisha në trurin tim një univers të tërë, që priste të dilte. Shqipëria kishte nevojë për atë ciklon. Ishte mëkatë ta lija të vdiste aty ku kishte lindur... Poeti tragjik i viteve 30-të, Migjeni, kishte thënë për veprën e vet: "Unë djepi i juaj e ndoshta varri i juaj". Unë s'doja të bëhesha varr i veprës sime.

Mbetej zgjidhja e tretë: taksa. Taksa paguhej nga të gjithë. Në çdo libër ishte e detyrueshme përmendja e partisë komuniste. Por për një liri të madhe edhe taksa duhej të ishte e pazakonshme. Dhe unë kisha nevojë jo për një liri gjysmake. Kisha çaste që e kuptoja se ky s'ishte veçse një iluzion. Se në regjime të tilla lirinë s'mund ta fitoja as me kurrrfarë takse. Por vinin çaste të tjera kur i besoja mrekullisë. E dija se isha i sëmurë nga letërsia. Besoja në fuqinë çudibërëse të saj. Dhe vendosa të provoj fatin. Do të bëja atë që pak a shumë bëri Molieri në shekullin XVII me mbretin. Taksën nuk do t'ia paguaja regjimit, por drejtpërdrejt diktatorit. Diçka e kisha kuptuar, por më shumë e kisha ndier me intuitë se ky diktator shqiptar ishte krejt i paparimtë. Dhe diktatorët e tillë mund të gabohen më lehtë.

Shkëputja dhe dalja e Shqipërisë nga kampi socialist më ishte dukur jo vetëm një mrekulli, por ngjarja kryesore, e denjë për t'u trajtuar në letërsinë e kësaj epoke. Kisha kohë që doja të shkruaja për të, por ajo hynte ndër tabutë e kohës.

Regjimi nuk donte të shkruhej për të, e quante të rrezikshme sepse i kujtonte shpresën që ajo shkëputje ngjalli kudo në Shqipëri në fillim të viteve 60. Dalja e Shqipërisë nga kampi ishte një mrekulli, por një mrekulli që dështoi. Një ëndërr e bukur që u kthyte në makth. Historia shqiptare ende nuk e ka shkoqitur atë që ndodhi.

Kur unë vendosa të provoj fatin me këtë ngjarje, duke vënë në vepër portretin e diktatorit, (pra duke paguar taksën time), kisha pak a shumë atë mendim që kam edhe sot për ngjarjen dhe për tiranin shqiptar. Ky tiran, pas asaj që bëri, d.m.th. pas nxjerrjes së Shqipërisë nga kampi socialist, priti në mos të shpalljes si hero prej Perëndimit, të pranohej prej tij ashtu si Titua me 1948. Priti sidomos nga Franca, emrin e së cilës dhe nostal gjitë për Parisin i përmendte andej këndejej. Mirëpo Perëndimi aq i vemendshëm ndaj çdo kopse që ndërronte Titua në xhaketë, nuk e përfillte këtë ish dendi shumë më perëndimor në sjellje e më elegant se ish provinciali Tito. Titos i faleshin krimet. E.Hoxhës jo. Tito pritej kudo si simbol i liberalizmit, ndonëse burgjet i kishte plot. E.Hoxhës s'i përmendej as emri. Xhelozia për Titon ka qenë për vite me radhë tortura e tij. I dukej se bota tregohej e padrejtë me të. E nxorri Shqipërinë nga kampi socialist dhe s'dëgjoi asnje fjalië miradashëse. Për një pianist ose futbollist të Lindjes bëhej më shumë zhurmë kur dilte nga kampi sesa për një shtet të tërë. E hoqi bazën ushtarake sovjetike nga Vlora, të vetmen bazë në Mesdhe, kërcënim të tmerrshëm për Perëndimin dhe asnje falenderim. Mendimi im ka qenë dhe

mbeti se për hir të shpëtimit të popullit shqiptar, Perëndimi mundte dhe duhej ta gabonte diktatorin e paprincipitë shqiptar, siç kishte gabuar Titon. Kjo nuk u bë.

Kam menduar shpesh se ç'fshihet prapa kësaj enigme. Një marrëveshje e fshehtë midis Bashkimit Sovjetik dhe Perëndimit për ta braktisur Shqipërinë (as ne, as ju)? Respektimi i Jaltës, atyre pusullave kriminale, që u këmbyen midis Stalinit dhe Çërçillit dhe që brenda dy-tri minutash e dënuan me vdekje Shqipërinë? Këmbëngulja e jugosllavëve, që ishin të interesuar për shkak të Kosovës që Shqipëria të mos futej në familjen e popujve të tjera?

Sa herë që ua kam bërë këto pyetje, këtu në Perëndim, zyrtarëve, specialistëve, ose gazetarëve, kam hasur në një mosdije, ose në moskuptim ose në shtirje. Vetëm një herë, në një takim me zyrtarë të rëndësishëm francezë, të tillë që dinin të fshehtat dhe kahjen e brendshme, të padukshme të historisë, kur ua bëra këtë pyetje dhe kërkova prej tyre një përgjigje, njëri prej tyre, më i vjetri, dhe ndoshta më kryesor më dha këtë përgjigje: "Kur Bashkimi Sovjetike la Shqipërinë të dilte nga kampi, ne nuk u përpoqëm ta tërhoqnim Shqipërinë, për të mos e trëmbur Bashkimin Sovjetik, me shpresë se ai mund të lëshonte kështu edhe vende të tjera".

Përgjigja ndonëse disi naive, dëshmon vërtetimin e dyshimeve të mia për një marrëveshje të fshehtë. Pra Shqipëria u la të vdiste për të mos u prishur idili i mundshëm Lindje-Perëndim.

Ç'do të ndodhë sikur Perëndimi ta gabonte,

(domethënë ta "titëzonte" Hoxhën?). Natyrisht Shqipëria s'do të bëhej perëndimore, por regjimi do të zbutej ndjeshëm. Sepse diktatori e kuptonte se mund të rrinte në pushtet, mjaftonte që të hijqte dorë nga shumë zakone komuniste. Si i paparimtë që ish, ai do t'i bindej diktatit qortues perëndimor. Ishte një diktator i tillë që për hir të pushtetit mund të pranonte rrobën e tiranit apo të liberalit, të sheikut apo të peshkopit.

Por le të kthehem i romani "Dimri i vëtmisë së madhe".

Kishin kaluar dhjetë vite që nga ngjarja e madhe. Një shpresë megjithatë nisi të notonte përsëri në erë. Ftohjet e herë pas hershme me Kinën në fillim të viteve 70, bënин që të ringjallej iluzioni i shkeputjes përfundimtare nga komunizmi. Ishte koha për të stimuluar këtë dhe mua, krejt si Don Kishotit, m'u ringjall besimi se letërsia mund të bënte të pamundurën. Të bëja pra, atë që s'kishte bërë Perëndimi. T'i jepja kumtin: ti mund të jesh i pranueshëm në qoftë se zbutesh. T'i vija pra, maskën korrektuese, me shpresë se do t'i përshtatej asaj. (Në janar të vitit 1985, kur ai ishte ende gjallë, në trajtesën për Eskilin e kam shpjeguar se ç'është maska korregjuese mbi fytyrën e një tirani, dhe ç'rol mund të luajë ajo).

Sic e shihni, unë përdora disa herë fjalën "gabonte". Perëndimi, (shkrimitari) mund ta gabonte tiranin... Mund të dalë tani pyetja: a është e moralshme kjo? Mendoj se mëdyshja në këtë rast do të ishte e ngjashme në qoftë se pyetja do të shtrohej: a është e moralshme ta gabosh një gjarpër

apo një përbindësh kur të del përpara?

Lidhur me tezën e përpjekjeve që janë bërë për zbutjen e regjimit, tani në vëndet e ish Lindjes, ka gjithfarë mendimesh. Para disa ditësh në gazeten "Le Monde" lexova një shkrim të shkëlqyer të disidentit të madh çek Jiri Pelikan për këtë çështje. Është përhapur, ka do kohë një mendim i shëmtuar se komunistët më të rrezikshëm kanë qenë jo ata që ishin shtylla e regjimit, por ata që luftuan për zbutjen e tij. Me fjalë të tjera, jo Stalini, Hoxha, Ulbrihti etj. Por Hrushovi, Gorbaçovi, pranveristët e Pragës, Lubonja, Kundera etj., sepse këta, duke dashur ta zbutin, paskan dashur në të vërtetë ta ruajnë regjimin më mirë se të parët. Ky mendim, jo vetëm që është cinik, por është bolshevik kryekrejet. Është mendim çnjerëzor bolshevik, sepse fatin e gjysmë miliardë njerëzve të ish kampit e sheh vetë ilustrues për të mirë apo për të keq të doktrinës komuniste. Sipas këtyre cinikëve, më mirë do të ishte që gjithçka në këtë univers të shkonte zi e më zi, që të mos krijohej asgjë me vlerë, (sidomos ata i shqetësojnë vlerat shpirtërore- letërsia, artet e tjera), sepse kështu do të kishin të drejtë të thoshnin me plot gojën se komunizmi ishte "i keq". Që kjo zi e kjo shkreti do të shkaktonin vuajtje të reja dhe degjenerim shpirtëror të qindra milionë njerëzve, kjo për këta cinikë as që llogaritet.

Mendoj se të tilla gjykime duan të përligjin frikën e atyre, që gjatë diktaturës e ulën kokën si pula të lagura. Me pasivitetin dhe "heshtjen" e tyre, për të cilën mburren aq shumë sot, diktatura komuniste do të vazhdonte një mijë vjet.

Koha tregoi se apo një diktaturë pranon zbutjen e parë, ajo aty për aty dekreton rrokullisjen e saj.

Në librin tim "Dimri i vetmisë së madhe" unë dhashë portretin e diktatorit shqiptar, jo duke bërë lajka e lavdërimë, por kryesisht duke riprodhuar besnikërisht proces-verbalet e takimeve Hoxha-Hrushov në Moskë si dhe mbledhjen e madhe të konsilit botëror komunist. Sado paradoksale të duket, edhe sot, po të lexosh ato proces verbale, tirani shqiptar, i pasinqerti Hoxha, duket megjithatë simpatik dhe duket se ka të drejtën historike përballë të sinqertit Hrushov, që ndonëse e di shkakun e vërtetë të veprimeve të tjegrit, s'ka ndonjë argument për të kundërshtuar daljen e Shqipërisë nga kampi komunist, veç "besnikërinë ndaj partisë mëmë bolshevikë", që Shqipëria po e tradhtonte.

Pra, më shumë se një portret, ishte zgjedhja e një episodi të favorshëm, si të thuash "heroik", e shefit të Shqipërisë, në çastin kur ai po e nxirrte Shqipërinë nga universi i urryer. Në romanin tim unë theksoja se kjo ndarje, kjo "vetmi", e nderonte atë, rrjedhimisht, në qoftë se ai donte të ishte i pranueshëm për të ardhmen, (për Perëndimin, merreni si ta doni) ai duhej të pranonte maskën që i kisha propozuar.

Por maska ia vrau fytyrën tiranit apo e vuri. Reagimi kundër romanit tim ishte i tmerrshëm. Diktatura e kuatoi menjëherë rrezikun e kësaj vepre. Gjithë mekanizmat e saj u ngritën në këmbë: policia e fshehtë e para (në roman unë-e nxirrja midis të tjerash E. Hoxhën sikur nuk e donte këtë polici), Komiteti Qendror, komitetet e partisë.

Kudo bëheshin mbledhje, protesta, kërkohej arrestimi i autorit. Ishte e hera e parë që kuptova se një diktaturë mund të jetë më e fortë se vetë diktatori.

Tirani ishte në mëdyshje. Të më dënonte mua do të thoshte të griste me duart e veta portretin e vet. (Me autorin bashkë dënohej dhe ndalohej vepra). Atëhere ai zgjodhi një rrugë kompromisi. Për të qetësuar diktaturën e lejoi kritikën kundër veprës, madje pranoi që vepra të konsiderohej gjysmë e ndaluar, por vetëm nuk e zhduku. Ndërkaj priste rastin të më dënonte për ndonjë shkak tjetër. Rasti erdhi shumë shpejt. Në vjeshtë të vitit 1975, për një vjershë "Pashallarët e kuq", për të cilën u fajësova se "bëja thirje për kryengritje të armatosur", ndonëse kjo s'ishte e vërtetë, më larguan ca kohë nga kryeqyteti dhe më ndaluan botimin.

Kështu mori fund historia e "maskës". Ajo nuk lojti asnjë rol për zbutjen e tiranit, por ndërkaj më mbrojti prej tij. Ndërkaj, krahasimi midis dy fytyrave të tij, asaj së vërtetës dhe maskës së modeluar prej meje, lozte një rol të ndjeshëm për turbullimin e njerëzve, për të ngjallur dyshime dhe pyetje të rrezikshme. Mjaftonte p.sh. qëndrimi ndaj policisë së tmerrshme të fshehtë, Sigurimit, për të shkaktuar tronditje. Sipas librit tim dilte që diktatori nuk e donte këtë polici. Ndonëse kjo s'ishte e vërtetë, kjo kinse mosdashje i çlironte shumë njerëz nga tmerri i Sigurimit, iu jepte kurajë, madje i revoltonte kur dhunoheshin prej saj. Ose mjaftonin diskutimet e shumta të personazheve për mbarimin e komunizmit, për mundësinë e kthimit të Shqipërisë drejt Perëndimit, (ka personazhe madje dhe nga ata që quhen pozitivë,

që kërkojnë p.sh. kthimin e Shqipërisë në një vend neutral si Zvicra), që të hapnin horizonte të befasishme në mendjet e njerëzve. Në një vend të myllur stalinist si Shqipëria, këto polemika, hamendje dhe shpresa ishin befasuese dhe të linin pa gjumë.

*A.B. - Kemi reagime nga rrethi juaj. Është ndjenja juaj individuale e cila nuk është aspak evidente. A ishit ju i ndërgjegjshëm që dënonit, pa u shprehur haptazi, dy forma të komunizmit? Por, do të më thoshit ju, ndoshta ishte e nevojshme të viheshin në një situatë romaneske, apo tragjike ngjarje që zhvilloheshin fare pranë jush. Një shkrimtar i vërtetë asnjëherë nuk mban anë, ndryshe nuk do ishte një krijues. Ekuivoku është fusha e tij, atëhere përse të dalë jashtë saj kur ajo është aq pjellore? Tashmë është koha t'ju pyes lidhur me marrëdhëniet tuaja me pushtetin. Jua drejtoj pyetjen në këtë formë në mënyrë që të mos ta ndjeni veten ngushtë: në Perëndim pati mungesë të tmerrshme takti kur bëhej fjalë për të klasifikuar shkrimtarët sipas marrëdhënieve të tyre me autoritetet e vendit. Deshën të krijonin përshtypjen se modeli perëndimor ishte më afër atij ideal, çka ishte e vërtetë deri në një farë mase në shekullin e XIX në Angli, Francë e Gjermani, pa shkuar deri tek Regjimi i Vjetër - Rene Descartes largohet nga Luigji i XIII, Volteri nga Luigji i XV-, është për të ardhur keq për shembull që Amerika përcmon jo vetëm Edgar Poe dhe Melville sa ishin gjallë, por edhe Ezra*

*Pound dhe "brezin e humbur" që nga Lufta e Parë Botërore. Sot çensura tregtare e Amerikës është e njëjtë me rreptësinë e çensurës morale ose politike. Në Rusi, në asnjë moment të historisë së saj, shkrimtari nuk ka qenë plotësisht i lirë: telashet e Pushkinit e Dostoevskit me policinë e Carit mbeten legjendare. Stalini nuk i persekutonte Anna Akhmatovën, apo Pasternakun, por nuk i lejonte ata të botonin. Në Perëndim, shumë shpejt u thjeshtësuan qëndrimet ndaj shkrimtarëve deri në karikaturizim: jo çdokush mund të jetë disident, shpesh janë shkrimtarë jo shumë të mirë që duke mos pasur botë të brendshme, i kthehen luftës me të shkruar. Kemi dy shembuj të famshëm të cilët ndoshta, me të drejtë, mund t'i krahasojmë me situatën tuaj në atë kohë. Në një ditë të viti 1930 Bulgakov, duke mos arritur të verë në skenë pjesët e tij, i drejtohet Stalinit duke i pohuar se shkrimet e tij nuk i shërbën Partisë Komuniste: ai i kërkoi ose mërgimin jashtë atdheut, ose një punë që ta lejonte të jetonte dhe njëkohësisht të shkruante pa shpresuar për botim. Stalini u bind: i caktoi një punë pak a shumë të nderuar dhe Bulgakov, në javët e fundit të jetës së tij pati përshtypjen se ia njihnin meritat.*

*Në një fushë tjeter artistike mund të citojmë rastin e Dimitri Chostakovitch. Gjatë një vizite zyrtare në SH.B.A., para një kuvendi intelektualësh në nivelet më të ulta të liberalizmit, të thirrur për të thënë "po" ose "jo", ai aprovon politikën sociale të vendit të tij dhe bëhet mbrojtës i qeverisë së tij. Ishte e vetmja mundësi që të jetonte në një apartament të përshtatshëm e të kish një piano*

*pa të cilën do të ish i humbur. A mundem unë të imagjinoj raportet tuaja me Hoxhën, ministrat apo zelltarët e tij?*

*I parë nga larg, problemi paraqitet i thjeshtë, megjithatë: tashmë reputacioni ju mbron ju nga keqtrajtimi apo masat ekstreme. A mund ta kursente Shqipëria e vogël një shkrimtar të madh që nuk e kish pasur kurrë? A ishit ju i aneksueshëm, i paprekshëm apo i painfluencueshëm. Për ç'lloj kompromisi ishit i gatshëm? A mund të shpëtohet, të modifikohet, të rimarrë veten komunizmi? Po gjatë këtij konflikti ndoshta imagjinari, ç'bënin shokët tuaj të afërt mbas jo të gjithë të paprekur nga xhelozia? Dua ta përfundoj këtë vështrim mbi "Dimrin e Madh", me një formulë të përcaktuar: Me "Gjeneralin e ushtrisë së vdekur" ju dhatë shembullin e një shkrimtari që qëndron mbi konfliktin: me "Dimrin e madh" ju hyni plotësisht në përlleshje. A janë këto të pajtueshme apo brenda masës së shumfaqshmërisë suaj?*

**I.K.** - Ky vit si edhe dy të tjerët pas tij ishin vërtet vite të tmerrshëm. Enver Hoxha e hoqi çdo shpresë se Perëndimi do t'ia falte dhe do ta pranonte, siç kishte bërë me Titon. Atëhere ai vendosi lidhjen me Kinën. Dhe meqenëse çdo gjë që bënte e bënte në mënyrë pasionale, edhe këtë miqësi po e lidhët me shumë ngut e pasion. Për t'u bërë qejfin kinezëve bëri shumë marrëzira, ndër të cilat ishte ndalimi me dekret i fesë. Ishte e kuptueshme që letërsia dhe artet nuk do të mbeteshin jashtë kësaj batërdije. Me një vendim të rrufeshëm shumica e shkrimtarëve dhe e artistëve

u dëbuani nga Tirana dhe nga qytetet kryesore për "të shkuar midis popullit". Ishte një internim masiv i paparë ndonjë herë në historinë e kulturës europiane. E kam thënë edhe herë të tjera se brenga më e madhe e shkrimtarëve shqiptarë në atë kohë ishte se askush në botë nuk ngriti zërin, madje nuk tha një gjysmë fjalë për këtë persekutim masiv. Kjo iu shkaktoi një thyerje shpirtërore më shumë se burgjet.

Mua më çuan në një qytet në Jug, në Berat. Isha në dëshpërim të plotë, dhe mendimi i parë që më vinte çdo mëngjëz ishte ta braktisja këtë shtrigë të mallkuar që quhej "letërsi", prej së cilës s'vinin veç të këqija. Por e dija se braktisja s'varej tani vetëm nga unë. Shteti shqiptar, nën shembullin e kinezëve i përgjonte tani haptaz shkrimtarët. Trysnia ishte e padurueshme. Në çdo mbledhje dëgjoheshin thirrjet: shkruani për popullin, hiqeni mendjen nga dekadentizmi perëndimor! Kjo, e kthyer në gjuhën e përditshme do të thoshte: bëhuni mediokër, budallallepsuni, mundësisht idjotizohuni. Kështu, budallenj partia do t'jua falë gabimet, dhe do t'ju pranojë...

Për të na thyer përfundimisht, sajuan dytri delegacione për t'i çuar në Kinë, që të shikonin revolucionin kulturor. Bëra pjesë në njërin prej tyre, që kryesohej nga një oficer. Në Kinë tmerri kishte kaluar çdo kufi. Me mijëra shkrimtarë ishin dërguar e kishin humbur ndërkaq nëpër orizore, të tjerë ishin rrahur, gjyntuar, ishin tërhequr zvarrë nëpër baltë, ose ishin çmendur.

E dinim se pak a shumë ky fat na priste. Sidomos ne që kishim "bërë gabime". Për fatin

tim të keq, në Kinë, shkrimtarët e goditur nga revolucioni kulturor thirreshin "përbindsha", gjë që burokratëve shqiptarë ua sillte ndër mend titullin e romanit tim të ndaluar "Përbindëshi".

Si rrjedhojë e gjithë kësaj trysnie shumë shkrimtarë u thyen pérjetë. As vetë s'e kuptionin si binin çdo ditë poshtë e më poshtë. Shkruanin vepra pérherë e më konformiste e më servile ndaj regjimit. Letërsia shqipe, e cila sidoqoftë ishte përpjekur të ruante diçka nga dinjiteti i dikurshëm, po zvetënohej me shpejtësi.

Në atë kohë, dhe shumë vite më pas, askush nuk mendonte se komunizmi do të binte aq papritmas. Ne ishim të bindur se do të vdisnim nën këtë regjim. Më 1984-1986, shkrova romanin "Hija". Si e mbarova, e quajta gjënë më të natyrshme ta depozitoja në Francë, "Banque de la Cité" 12, Avenue Matignon. Çelësin e kasafortës ia besova Claude Durand, bashkë me autorizimin që ta hapte kur të donte. Ndërkaq kontrata me Durand ishte e qartë: romani do të botohej vetëm pas vdekjes sime.

Në atë kohë pra, përpjekja jonë kryesore ishte që të mbrohej sa të ishte e mundur letërsia, dhe përgjithësisht kultura nga tjetërsimi i plotë. Ankthi komunist, propaganda, plenumet, klishetë e realizmit socialist dhe padyshim, terrori, e kishin rrrethuar këtë letërsi dhe stinë pas stine përparonin siç përparon shkretëtira, për ta tkurrur, për ta tharë, për t'ia marrë fryshtë përfundimisht. Ne duhej të ndalonim përparimin e shkretëtirës. Ky ishte thelbi i çështjes.

**A.B.** - "*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*" ju radhit ju me shkrimtarët, mjaft të rrallë, që janë të aftë të kthejnë një realitet historik të afërt njëherazi në mit e në simbol. Nga ana tjetër, "*Dimri i madh*" ju bën një dëshmitar që nuk ja lejon vetes të fantazojë mbi një realitet të dhimbshëm që e jeton një popull i tërë i cili nuk ju pengon për t'i dhënë dramës tone disi pasionante e të apasionuara. Të flasësh për ju duke përmendur këto dy pole mjaft të kundërtat do të ishte megjithatë e pamjaftueshme. Me disa muaj diferenca, në fillim të viteve 80, kur situata në Evropën Lindore stabilizohet, imobilizohet dhe fillon të njohë kalbëzimin e ngadalshëm të kauzave tashmë joefikase, ju botoni, në frëngjisht, dy libra po aq kontradiktore sa këta që sapo përmenda. Nën dritën e ngjarjeve -të romanizuara ose jo, pak rëndësi ka- të "*Dimrit të madh*", kuptohet se ju keni dashur të përshkruani vitet e studimeve tuaja në Moskë në kohën kur marrëdhëni etnike ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik po degradonin. Është kronika e një admirimi të zhgënjer, dhe ç'është më e keqja, e një detyre që papritur bëhet e rëndë dhe e gënjeshtërt. "*Muzgu i perëndive të stepës*" nuk e fsheh një shqetësim gjithnjë e në rritje. Studentët që evoluojnë gjatë këtij tregimi, të cilin mund ta quajmë realist, flasin për dy dekadencat: të Stalinit dhe të Hrushovit. I pari, pasi qe "*babai i popujve*" u kthye në një përbindësh të urryer. Po a është kaq e thjeshtë? A nuk realizoi ai një èndërr të mbarë njerëzimit? Në se po, a nuk ishte e kotë të derdhej gjak? Si mund t'i kundërvesh, gjithë duke e respektuar, kësaj figure shumë të dashur e pastaj shumë të

*urryer, figurën e Hrushovit? Një xhambaz nuk  
është veçse një tregtar i dorës së tretë. Komunizmi  
i ri a mund ta rivendosë pastërtinë, apo të ruajë  
një ideal tashmë të marrë nëpër këmbë? Të gjitha  
bisedat e përditshme rrotullohen rrëth kësaj  
pakënaqësie të madhe. Në asnjë moment shembulli  
demokratik i Perëndimit nuk duket një zgjidhje e  
vlefshme. Nga ky libër nxjerrim si mësim që shtetasit  
e komunizmit në falimentim nuk mund të çliron  
nga ai : madje as që e mendojnë këtë. Një diktaturë  
futet në llum dhe askush nuk mburr me të vërtetë  
lirinë dhe as një reformë serioze. Nuk bëhet me  
fjalë për qenie njerëzore që bisedojnë, por për  
fantazma që kalojnë. Kjo nuk e pengon as dashurinë,  
as shoqërinë, as diskutimin. Popujt e nënshtuar  
që nuk revoltohen mbeten popuj që nuk e zotërojnë  
veten. Mos vallë kështu i keni imagjinuar ju reagimet  
e një lexuesi perëndimor ndaj situatës së përshkruar  
në libër? Jam i bindur që nuk është kështu... Në  
të njëjtën kohë "Ura me tri harqe", duke u larguar  
nga shekulli i XX ju çon në një të kaluar të  
largët, në fundin e shekullit të XIV. Mesjeta në  
Shqipëri nuk është më e gjëmshme se në Perëndim.  
Feudaliteti është një çarje shumë e madhe. Gjithçka  
që njohim nga kjo periudhë bazohet në dokumente  
apo gjurmë të rastit. Tradita gojore është e pasaktë  
dhe kapriçioze. Ashtu si pjesa tjetër e Evropës,  
Shqipëria është një fushë beteje ku trevat nuk  
respektojnë asnjë marrëveshje. Ndërmjet budallallëkut  
dhe egërsisë së vërtetë, si mund të shpleksësh  
të vërtetën e legjendës apo më mirë të supersticionit?  
Edhe vetë kronistët janë të dyshimtë. Franca e  
Joinville dhe Commines nuk është më shumë e*

*stabilizuar. Ju largoheni me vetëdije nga shekulli ynë për tu zhtytur në errësirat e një epoke nga e cila nuk na vjen asgjë e sigurtë apo e lavdishme. Ashtu si tek ne, çdo gjë atëhere ishte magji apo sy i keq. Frika pushtoi gjithë kontinentin. Historia e ndërtimit të kësaj ure të mallkuar mund të vendosej në Auvergne, në Irlandë apo në thellësitë e Gjermanisë. Megjithatë, kësaj rrëmuje nuk i mungon ndjenja, terrori, e sidomos imaginata. Ju jeni për atë që quhet, kryesisht në letërsinë angleze, ndjeshmëri gotike. Në lidhje me këtë mund t'ju bënim shumë pyetje. Pasi u përleshët trup me trup me këtë shekull, a e ndjetë nevojën fizike e shpirtërore për të krijuar një atmosferë më ideale, më poetike, më turbulluese në një histori ku nuk ka vend realizmi? Duke kompozuar një tregim plot ëndrra, makthe e ekstrapolime të pavërtetueshëm, mos keni dashur të krijoni një model që t'i kundërvihet çdo konsiderate realiste? A keni ndjerë dëshirën e një atmosfere faustiane ku njeriu nuk është lodër e shoqërisë por i vetë halucionacioneve të tij intime? A mos vallë përveç Shqipërisë aktuale, ju nuk patët me këtë libër ambicien për tu hedhur në të kaluarën e errët e të pazbërthyeshme. Pas kësaj periudhe të gjatë pa qytetërim do të shfaqej një tjetër tirani: ajo e pushtimit turk. Por mos vallë një diktaturë e huaj e administruar mjaft mirë do të ish më e pranueshme se një çrregullsi e vazhdueshme që, duke lënë mënjanë imaginatën, në atë kohë ish njëherazi një vetëvrasje dhe dekadencë?*

*Kjo hedhje spekulative në të kaluarën mos është ndërkokë një pohim se tashmë toka amtare*

*ju intereson në tërësinë e saj jashtë kohore; të merresh papritur me të kaluarën e saj të largët, mos do të thotë se një ditë do të merreni edhe me të ardhmen e saj? se e tashmja, me parrullat e saj politike apo morale mund të duket qesharake?*

**I.K.** - Në fillim do t'ju jap mendimin tim për gjëra që janë jashtë letërsisë dhe që, duam apo s'duam ne, e ulin nivelin e kësaj bisede. Në librin tim "Muzgu i perëndive të stepës" aktorët e dramës janë tre diktatorët komunistë Stalini, Hrushovi, Hoxha, një shkrimtar me fat tragjik, Pasternaku, vetja ime, pastaj një vajzë ruse, dhe së fundi një turmë shkrimtarësh mediokër sovjetikë. Se si mund të strehohen në një libër që ngjan si roman dashurije këta personazhë që janë kaq të largët nga njëri tjetri, kjo mund të duket pakëz e çuditshme, por në letërsi çdo gjë ndodh.

Lidhur me tre tiranët komunistë, e kuptoj habinë tuaj se si Hrushovi mund të renditet me dy të tjerët. Unë do t'ju përgjigjем saktë për këtë. Së pari dua t'ju them se Stalini është armiku më i madh i kombit shqiptar. Ai nguli këmbë në Jaltë që Shqipëria të trajtohej si shtojcë e Jugosllavisë, ai donte që Shqipëria më vonë të gëlltitej, (janë fjalë të sakta, të cilat më vonë ia ka thënë Milovan Gjillasit, të shoqëruara me gjestin e gëlltitjes), prej Serbisë. Në librin tim unë s'mund ta sulmoj Stalinin, pra hesht për të. Tirani i dytë, Hoxha, është gjithashtu shkatërruesi i Shqipërisë, por që këtë unë s'mund ta shkruaj dot dhe hesht. I treti, Hrushovi, është armik i dy të parëve. Ai është figurë kolosale, me meritën e madhe që

rrëzoi Stalinin. Por unë kam dy arsyet, që duke e adhuruar, të mos e lëvdoj. E para sepse s'mund ta lëvdoj atë që është shpallur armiku numër një i vendit tim diktatorial, shtetas i të cilit unë jam. E dyta, sepse edhe po ta kisha këtë liri, (këtë liri që e kam tanë që ndodhem në Francë) zemra nuk do të më bënte ta lëvdoja, sepse ndaj vendit tim ai ka mbajtur një qëndrim të keq dhe dëmprurës. Unë jam shkrimtar dhe çdokujt mund t'ia fal gjithçka, por askujt nuk mund t'i fal një gjë: kur ngre dorën kundër kombit tim. Unë nuk kam frikë se do të më quajnë nationalist. Unë s'jam i tillë. Por unë nuk duroj dot askend, qoftë edhe Zotin, po ta bënte këtë. Sepse ky është një popull që është grirë shumë herë padrejtësish gjatë historisë së tij dymjëvjeçare, (një nga dëmtuesit e tij ka qenë përherë Rusia) e tanë nuk duhet të grihet më, (sidomos prej Rúsise).

Hrushovi ka merita të mëdha ndaj popullit të vet. Ai ka merita përballë një pjese të njerëzimit. Por ai u kthye në një mallkim për vendin tim. Ndaj unë, duke mos e dashur, s'kam megjithatë kurrfarë urrejtjeje për të. Ju s'do të gjeni asnje gjurmë urrejtjeje për të në librin tim "Dimri i vëtmisë së madhe" ku ai është një ndër personazhet kryesorë. Dhe kjo s'ka qenë e lehtë për shkrimtarin shqiptar, që e shkruan veprën më 1971, nën kontrollin e diktaturës staliniste.

Hrushovi për Shqipërinë ishte vazhdimi i Stalinit, ashtu siç ishte ky vazhdim i anës më agresive të carit rus. Shkurt, qëllonte që udhëheqësit rusë edhe kur ishin liberalë për vendin e tyre, për të tjerët ktheheshin në përbindësha.(Mbytja

me gjak e Hungarisë më 1956 pikërisht prej Hrushovit  
është një nga shembujt).

Shikoni dy fajësimet kryesore të Hrushovit për diktatorin shqiptar Hoxha: E para: ai iu shit Perëndimit për 30 aspra. E dyta: ai tradhtoi partinë mëmë sovjetike, Fajësimet tipike bolshevike, fusomadhe, që mund t'i bëhen vetëm një vasali, vetëm guvernatorit të një province të Rusisë. Shikoni mbledhjen e 81 partive në Moskë, gjithë ato personazhe, një pjesë e të cilëve ishin legjendarë, një pjesë me aureolën e martirit liberal, Dolores Ibaruri, Torezi i juaj, Gomulka polonez etj. etj. iu doli kallaji përpara diktatorit shqiptar. Ata ngrihen kundër tij, njëri më i egër se tjetri, sipas zakonit të lakejve. Një nga ata që ulurin më fort është gjermani Ulbricht. Ai, si shumica prej tyre, i ka duart të lyera me gjak, por do t'i lyejë edhe më fort te Muri i Berlinit. Tirani shqiptar e dikte gjë, dhe kjo duhet t'i shkaktojë trishtim e revoltë njëkohësisht. Ai me siguri mendon: ne të gjithë jemi autorë të një klani vrasësish, kush më shumë e kush më pak. Atëhere ç'keni që më gërmusheni kaq keq? Por ata janë tashmë në delir dhe vazhdojnë të ngrihen. Ata ulërijnë kundër tij, por ç'farë i thonë? Renegat, tradhtar, bukëshkalë i partisë mëmë! Ai gjithashtu ulerin, por fajësimet e tij tingëllojnë më të besueshme. Ai iu thotë: I vetmi krim i im është se unë nuk i bindem verbërisht diktimit tuaj.

Ata ngrihen rresht, njëri pas tjetrit si shërbëtorë të bindur të Rusisë, dhe si gjithë shërbëtorët bëhen qesharakë përpara një diktatori aktor, përpara një vrasësi. Ky është thelbi i mbledhjes

së Moskës së vitit 1960, që unë e kam përshkruar te "Dimri i vëtmisë së madhe" dhe ky është shpjegimi përsë Hoxha duket simpatik përballë klanit komunist. Ju mund të më pyesni: prej këtij konsili komunist a mund t'i bëhej diktatorit shqiptar një kritikë më e vërtetë, më e arsyeshme, rrjedhimisht më e dobishme për kombin shqiptar? Pa dyshim që po. Thelbi i kritikës që duhej bërë do të ishte ky: diktatura shqiptare duhet të emancipohet, të zbutet, të qytetërohet. Mirëpo ata s'mund ta bënin këtë kritikë sepse ata vetë ishin të paqytetëruar.

Romani "Dimri i vëtmisë së madhe" është portreti global i krerëve komunistë. Krahasimet e hapëta me klimën e tragjedive të Shekspirit ia bën fare të qartë lexuesit se ai ndodhet ndërkaq në universin e krimtit, me kështjellën e tij në Moskë, ku klani është mbledhur për të shqyer njërin nga anëtarët e vet. Që një mohim i tillë i komunizmit real të bëhej në Shqipërinë e vogël staliniste, kjo ishte vërtet një surprizë.

Dhe tani të kthehem i libri "Muzgu i perëndive të stepës". Kur e shkrova kreun e parë të romanit më 1962, unë për fat të mirë as që e kisha mendjen te të gjitha këto. Unë e kisha mendjen te postjeri, që nuk po më sillte më letra nga Moska. Unë prisja letra nga një vajzë ruse, letërkëmbimi me të cilën ishte ndërprerë befas. E mora vesh se shteti shqiptar, ndoshta edhe ai sovjetik, kishin ndërprerë bashkë me marrëdhëni diplomatike edhe këmbimin e letrave. Kështu pra, malli për një vajzë ruse, letrat e së cilës nuk do t'i lexoja më, është zanafilla e romanit. Dhe, padyshim, një ëndërr që e shihja shpesh dhe që

e kam përshkruar në "Ftesë në studio".

Sa për personazhin e Pasternakut, ky është një nga paradokset e këtij libri. Thelbin e paradoksit e përbën vetë fakti që në vendin më stalinist të Lindjes, shkrimitari i famshëm liberal, i mallkuar në vendin e vet, merret në mbrojtje. Në romanin tim Pasternaku është krejt i vetëm përballë përbindëshit të llahtarshëm, shtetit sovjetik. Dhe natyrisht si çdo i vemuar përballë një bishe ai është simpatik.

Ju mund të habiteni përsëri për këtë paradoks. Por ai dëshmon se sa sinqerisht besoja unë në atë kohë në mundësinë e zbutjes së diktaturës në Shqipëri. Kisha hyrë ndërkaq në një rregull të ri loje: Shqipëria dhe BRSS ishin shtete armiq. Pra, mua si shkrimitar, mendoja se më lejohej të sulmoja shtetin armik. Ndërkaq ky shtet armik ishte kështjella e komunizmit dhe, duke e sulmuar atë egërsisht, s'bëja gjë tjetër veçse sulmoja kështjellën amë. Mendoja se pavarësisht nga motivet personale e meskine, që e shtynë diktatorin shqiptar të rebelohej kundër kampit socialist, kjo grindje me kampin do të ishte shpëtimtare dhe shëruese për Shqipërinë. Personazhi simpatik i Pasternakut ishte një dallëndyshe, që duhej të paralajmëronte, në mos pranverën, një shenjëz të saj.

Kjo histori bëhej edhe më kurreشتare ngaqë në kohën që po shkruaja vazhdimin e romanit, për herë të parë shtypi perëndimor më shpalli mua si një kandidat të mundshëm për çmimin Nobël. Duke përshkruar një fushatë të egër kundër një fituesi të çmimit Nobël në një vend komunist, unë përshkruaja në të vërtetë atë që do të ndodhë

me mua në rast të nobelizimit. Pra, kjo ishte njëkohësht historia ime e mundshme e projektuar si në pasqyrë. Aq më tepër që mjediset, klima e zyrtë e romanit e sidomos turma e shkrimtarëve mediokër, që iu sulën shkrimtarit të madh rus, ishin aq shumë të ngjashëm me ato të vendit tim.

Shteti shqiptar dhe pa dyshim shkrimtarët mediokër, besnikë të regjimit, e kapën menjëherë këtë ngjashmëri. Ata u bënë gati për ta varrosur romanin sipas ritualit të njohur. Me sa duket fushata kundër tij u ndalua nga diktatori. Njëlloj si në rastin e "Dimrit të vetmisë së madhe". U fol se ai kishte bërë të njëjtin arsyetim në një mbledhje: nëqoftëse në Shqipëri dënohet një vepër që kritikon ashpërsisht Bashkimin Sovjetik, rusët do të kujtojnë se forcat proruse janë ende aq të forta sa që bëjnë ligjin në këtë vend. Mirëpo i ndjeshëm siç ishte kur ishte fjala për rrezikimin e sundimit të tij, ai s'mund të bënte prova me rrezikun. Ndaj, prapë njëlloj si me "Dimrin" u gjet një zgjidhje kompromisi: romani hyri në mbretërinë e heshtjes. Askush nuk e përmendte asgjëkund. Kështu u shtua edhe një fantazmë në krijimtarinë time.

Ja ç'mund të shkaktojë një letër, që postjeri s'e sjell që s'e sjell në një ditë dimri!

Sa për librin tjetër që ju përmendët, "Ura me tre harqe", ky bën pjesë në atë cikël veprash, me anë të të cilët unë u përpoqa të rikrijoja një tjetër Shqipëri, të përjetshme, tërheqëse, përballë Shqipërisë sterile, shkretëtiore komuniste. Në librin tim "Pesha e kryqit" kam folur për këtë

fazë, që e kam pagëzuar "restaurimi i ikonës". Megjithatë edhe kjo Shqipëri s'mund të ishte pa lidhje me atë të sotmen, tragjiken, në të cilën unë jetoja. Kështu gurët, me të cilët ndërtohet kjo urë mesjetare, janë të asaj kohe (ashtu siç janë të kohës faraonike vetëm gurët e pyramidës), kurse frika dhe terrori janë të kohës komuniste.

Në këtë roman jam marrë kryesisht me motivin e moçëm të flijimit. Ky ka qenë një nga kryemotivet e propagandës komuniste: flijimi në emër të së ardhmes! Me këtë përligjej gjithçka: varfëria, mërzia dhe sidomos shtypja. Mirëpo në këtë roman unë përshkruaja një flijim i cili në të vërtetë nuk është veçse një vrasje e përllogaritur, pra një krim.

Sa për ndryshimin midis një epoke të paqytetëruar, shqiptare e ballkanike, dhe shtetit të organizuar osman, mendoj se në atë kohë Shqipëria ndodhej pak a shumë në atë gjendje që ishte shumica e Evropës. Historiani kroato-gjerman Milan Shuflai në librat e tij ka përshkruar një Shqipëri mesjetare të ngashme me principatat evropiane. Prej këtij shkrimtari kam përfituar shumë për "restaurimin e ikonës shqiptare".

Është e vërtetë se stërshteti osman ishte tepër i organizuar, sidomos ushtarakisht, por kjo sipëranë e tij sfidonte jo vetëm vendet ballkanike, por krejt Evropën. Më 1389, në betejën e Kosovës ndodhi ndeshja fatale midis princave ballkanas të bashkuar dhe ushtrisë perandorake osmane. Luftuan dhe u thyen në këtë luftë jo vetëm serbët, siç e kanë falsifikuar historinë ata vetë, por krejt ballkanasit: shqiptarët, kroatët, boşnjakët, vllahët,

etj. Dy prej pesë kryekomandantëve të ushtrisë, princ Balsha dhe konti Jonima, ishin shqiptarë. Në të vërtetë në fushë të Kosovës u përleshën jo vetëm dy ushtri, por dy botë, dy koncepte ushtarake. Për herë të parë aty u ndesh ushtria e bujshme ballkanase e udhëhequr nga prijësa trima por tepër kokëshkretë e legjendarë, për të cilët kërkimi i lavdisë ishte ndoshta më joshës se kërkimi i fitores me ushtrinë osmane, që i bindej një shtabi qëndror, dhe që përbëhej nga ushtarë anonimë, shumica e të cilëve s'kishin as mbiemra, por vetëm emra. Shkurt, aty u ndesh një ushtri e vërtetë totalitare, e zymtë dhe e njëtrajtshme si çdo ushtri moderne, me një panaïr plot kolorit, një festival flamurësh, titujsh të fisnikërisë, trillesh e fanfarash, që u thye brenda dhjetë orësh nga animati aziatik. Aty, në fushë të Kosovës, osmanët e kuptuan se ku ishte dobësia e Evropës së krishterë dhe ku ishte forca e tyre. Pak a shumë si Hitleri pesë shekuj e ca më pas, ata e kuptuan se këtë Evropë "të qytetëruar" ata mund ta shpartallonin lehtësisht. Dhe do ta bënin me siguri sikur në shpinë të mos u hidhej si tigër tartaro-mongoli Timur Leng.

*A.B. - Le të ndalemi për një çast, duke rrezikuar uljen e nivelit të bisedës, siç thoni ju, mbi problemin pjesërisht politik, te raporti ndërmjet shkrimitarit dhe pushtetit, në këtë rast diktaturës shqiptare. Për disa, rasti juaj mbetet një enigmë e vërtetë...*

**I.K.** - Është bërë zakon nga disa që, kur shkruajnë për marrëdhëniet e mira me shtetin shqiptar të përdorin fjalën "enigmë". Kurrrfarë enigme s'ka patur. Dhe për atë që diçka di apo ka mësuar për natyrën e gjithësisë komuniste, këto marrëdhënie duken fare të qarta.

Gjer në vitin 1965, kur u ndalua "Përbindëshi", unë isha pak a shumë jashtë vemendjes, ose më saktë vemendjes se keqe të diktaturës. Vitet 1965-1968 ishin për mua të rënda si për shumicën e shkrimitarëve shqiptarë. Pikërisht në këtë kohë, nga që u bëra mjaft i njojur, (librat e ndaluar bashkë me kokëçarjet të jepnin një aureolë dhe njojje shpesh herë më të madhe se të lejuarat), sidomos pas botimit të "Gjeneralit" në Bullgari (1967) dhe Jugosllavi (1968), dy vende armiq, sidomos ky i fundit, projektorët e regjimit, ose më saktë të vetë diktatorit, ranë mbi mua. Për herë të parë e kuptova qartë se ç'tmerr është të jesh i njojur në një vend stalinist, që drejtohet nga një tiran sa i egër aq dhe dinak, dhe që përfat të keq e mbante veten për shkrimitar. Xhelozia e tij ishte proverbiale dhe dihet se ç'gjëma mund të ndodhin në raste të tilla.

Me përjashtim të viteve 1969-1972, kohë në të cilën më lanë të qetë, ngaqë merresha me "Dimrin e vetmisë së madhe" (nën hijen e tij mbrojtëse shkrova dhe botova dy romanet e tjera "Kështjella" dhe "Kronikë në gur"), gjithë vitet e tjera gjer në vdekjen e tiranit më 1985, ishin plot shqetësim dhe të papritura.

Në vitin 1970, e pasqë veten në listën e deputetëve. Në vitin 1972, hyra në partinë komuniste.

Më vjen për të qeshur kur këtu, në Perëndim këto gjëra merren seriozisht. Të qenit deputet në Shqipëri, ishte një gjë kaq formale, saqë pas ceremonisë së parë, ti vetë e harroje që ishe deputet, dhe të tjerët gjithashtu. Unë do t'ua vërtetoj këtë. Më 1975, kur pas vjershës "Pashallarët e kuq", më larguan nga Tirana dhe më hoqën të drejtën e botimit, unë isha pikërisht deputet i Tiranës. Mund ta përfytyroni ju një deputet që s'ka të drejtë as të banojë në qytetin ku "e kanë zgjedhur" dhe që s'ka të drejtë të botojë... romane?

Asgjë s'fitoje duke qenë deputet. Po të refuzoje (historia e Shqipërisë komuniste nuk ka njojur asnjë refuzim) mund të humbje gjithçka, madje dhe jetën. Unë s'isha aq i çmendur sa për idiotësitë e komunizmit të rrezikoja jetën time.

E njëta gjë ishte anëtarësia në parti. Sekretari i partisë, një dramaturg i quajtur Ibrahim Uruçi, njeri i mirë, por komunist idealist dhe naiv, më thirri për të më thënë se duhej të hyja në parti. E njihja prej vitesh, ishte i vetmi mik i im që nuk pranonte as kritikë, madje as shpoti me regjin. Kishte qëlluar që bashkë me Dhimitër Xhuvanin e kishim ngacmuar, na kishte kapur për gryke, duke na ulëritur: mbylleni gojën, do t'ju denoncoj! Por nga kërcënimet e tij vetëm, qeshnim sepse e dinim që s'të denonconte kurrë.

Biseda jonë ishte nga më surealistet:

Ai: Dëgjo, ti duhet të hysh në parti.

Unë: Unë në parti?! Po ti më ke thënë vetë se unë jam dekadent, antiparti.

Ai: Lëri shakatë. Puna është serioze.

Unë: Le të jetë serioze. Ti e di se unë

s'kam dëshirë.

Ai: E di, e di. Të jetë për mua, megjithëse të kam mik, s'të qas as te dera e partisë. As ti, as atë horrin tjetër, Dhimitër Xhuvanin. Po ç'ti bësh...

Unë: Të kanë thënë që duhet të hyj?

Ai: Mos më çaj kokën me pyetje. Bëj lutjen dhe pikë.

Unë: Dhe unë po të them: s'e bëj dhe pikë.

Ai: (i lodhur) Dëgjo, skizofren. (Kjo ishte fjala e tij e parapëlqyer për gjithë miqtë). Po të them një të fshehtë, se të kam mik. Urdhëri është nga lart.

Unë: E çë pastaj?

Ai: Është nga lart fare, o skizofren!

Unë: Ah, pa shiko.

Ai: Është nga i madhi fare, nga shefi personalisht, kupton?

S'kishte më vend as për humor, as për shpoti. Duke më futur në parti, tirani mendonte se do të më kontrollonte më mirë.

(Fati i I.Uruçit, siç ndodh shpesh me naivët e sinqertë, ishte tragjik. U përjashtua nga partia më 1974 gjatë një fushate spastrimesh, si rrjedhojë e një goditjeje të verbër, kur diktatori dënonte besnikët e vet për të tmerruar edhe më fort të tjerët, pastaj u internua dhe vdiq në internim, i braktisur edhe nga familja e vet).

Thashë se marrëdhëniet e mia me regjimin shqiptar ishin fare të qarta dhe duhej të ishe i verbër që të mos e shikoje këtë.

Unë isha shkrimitari më i njojur brenda dhe jashtë vendit.

Megjithatë të gjithë e dinin në Shqipëri se përveç vjershave e tregimeve, kisha katër vepra të ndaluara "Përbindëshi", "Pallati i ëndrrave", "Nata me hënë" dhe "Koncerti". Me përjashtim të këtij të fundit, që i qenë botuar vetëm disa kapituj, veprat e ndaluara ishin në duart e lexuesit. Veç kësaj vepra të tjera si "Dimri i vetmisë së madhe", "Prilli i thyer", "Kush e solli Doruntinën", "Dosja H", etj. ishin gjysmë të ndaluara. Asnjë lexues me mendje normale nuk mund të mos i bënte pyetjen vetes se përse shumica e veprës së këtij shkrimtari është e padashur nga ky regjim, për të përdorur fjalën më të butë.

Më 1975, për shkak të poemës "Pashallarët e kuq" gjithë Shqipëria, e përsëris, gjithë Shqipëria, madje edhe ata, që nuk lexonin letërsi, e mori vesh se, shkrimtari i parë i vendit kishte shkruar një poemë armiqësore në të cilën "bënte thirje për kryengritje te armatosur".

Më 1981 u zhvillua një plenum i Lidhjes së Shkrimtarëve, ku u dënuai publikisht një pjesë e veprës sime ("Doruntina", "Prilli i thyer"), dhe ku "Pallati i ëndrrave" u shpall vepër që kishte aluzione kundër regjimit. Kritika u botua në shtyp, dhe për herë të parë shtypi botëror, pothuajse pa përjashtim, e mori vesh të vërtetën.

Pra, publiku shqiptar e mori vesh qartë se midis shkrimtarit të parë të vendit dhe shtetit komunist ka një konflikt serioz. Mjaftonte kjo që gjithçka të bëhej e qartë dhe cilido që donte vërtet përmbysjen e diktaturës të merrte guxim, në mos për të bërë diçka, së paku për të menduar kundër saj. Pas fajësimit në shtyp si vepër kundër

regjimit, edhe lexuesi më i fjetur, i ndihmuar tashmë prej shtetit vetë do të lexonte veprën me një optikë të re, kështu ajo bëhej dyfish, trifish subversive. Tani dalin shumë trima të vonuar që betohen se do të kishin bërë hatanë, veç të kishin një sinjal! Në të vërtetë të gjitha sinjalet i kishin, veç s'donin t'i vinin re.

Poeti Visar Zhiti, i cili në kohën kur u botua "Pallati i ëndrrave" ishte në burg, duke treguar në një shkrim të tij se sa mirë u kuptua vepra dhe ç'trazim shkaktoi midis të burgosurve politikë, ka sjellë fjalët e njërit prej tyre: "Pas këtij libri, ose së shpejti do ta kemi autorin midis nesh, ose regjimi është dobësuar e s'ka më forcë të kafshojë".

Më duket se pikërisht mosburgimi im, i cili, me sa duket, këtu në Perëndim ka qenë pritur njëlloj si në Shqipëri, ka shkaktuar bashkë me një farë zhgënjimi shpikjen e "enigmës".

Po vijoj tek pyetja e juaj: ç'farë rrezikoja?

Qysh më 1988, kur Shqipëria ishte ende staliniste, në shkrimin e gjatë për Migjenin, e kam shpjeguar këtë gjë. Kanë kaluar aq vite dhe kam po atë mendim të asaj kohe: unë, për shkak të njohjes isha i paburgosshëm. Por kjo nuk ishte ndonjë shans. Përkundrazi, në regjime të tillë të egër, ku vrasja prapa krahëve ishte e zakonshme, burgimi do të ishte vërtet një shpëtim. Unë e kisha humbur pra, këtë shans; Për mua mbetej vetëm një ndëshkim: vrasja pas krahëve.

E kisha dëgjuar këtë më parë, por s'e kisha menduar se do të më ndodhët mua. Njihja së paku një njeri, një hero të luftës, që pasi nisi të

fliste kundër regjimit, në pamundësi për ta dënuar haptaz, për shkak të famës, e vranë me anë të aksidentit automobilistik.

Vitet 1981-1984 ishin për mua si dhe për shumicën e intelektualëve vitet më të zëza. Terrori ishte i ngjashëm si dy pikë uji me atë të Moskës në vitin 1937. Siç thashë, libri "Dimri i vetmisë së madhe" ma kishte mbyllur portën e burgut. Po kishte lënë hapur një portë tjetër...

Në librin "Vjeshta e ankthit", botuar në francë më 1993, Bashkim Shehu, shkrirtar i ri i dalë nga burgu dhe njëkohësisht djali i kryeministrat shqiptar Mehmet Shehut, i vetëvrarë, (siç u tha zyrtarisht) ose i vrarë, siç besohet, prej Enver Hoxhës, ka treguar midis të tjerash bisedën e tij me të jatin lidhur me mua, pikërisht në nëntor të vitit 1981, domethënë në prag të rrëzimit të kryeministrat. (Vetëvrasja ose vrasja ndodhi në natën e 17 dhjetorit 1981).

I tronditur prej tyre, duke e tradhtuar të jatin, ai m'i tregoi qysh në atë kohë ato biseda. Thelbi ishte ky: udhëheqja e partisë, duke përfshirë natyrisht Enver Hoxhën dhe babanë e tij, ishin të bindur se unë isha agjent i Perëndimit.

E dija këtë fajësim prej vitesh. Isha mësuar me të. Por ai vinte këtë herë drejt e nga maja e piramidës, ose më saktë, nga dhoma mortore e saj. Pyetjes sime nëse vërtet e besojnë këtë, ai m'u përgjegj: me sa duket.

Ishte e qartë se si gjithë paranojakët, përparrë një krimi të ri, Enver Hoxha po sugjestiononte veten. (Priftërinjtë astekë përparrë flujimit, kisha dëgjuar se bënин pak a shumë të njëjtën gjë).

Ajo që ishte e habitshme në këtë rast ishte se viktima e ardhshme ishte vetë kryeministri dhe qysh nga tatori i vitit 1981, gjithë Shqipëria e dinte se njeriu i dytë i Shqipërisë nuk i kishte punët mirë dhe pritej rrëzimi i tij.

Kur Bashkim Shehu më tregoi bisedat me babanë, që kishin vazhduar disa ditë, pyetja e parë që na lindi të dyve ishte: përse pikërisht tani kjo bisedë për shkrimtarin I.K.? Përse pikërisht në prag të rrëzimit të njërit prej bashkëbiseduesve? E aq më tepër kur kryeministri vetë dhe gjithë familja jetonin në ankth?

Mendja s'kish si të mos më shkonte te metoda e vjetër e Enver Hoxhës, që i detyronte viktimat e ardhshme t'i kryenin ndonjë shërbim të fundit, përpresa se të iknin nga kjo botë.

Zakonisht ky shërbim ishte një vrasje. Viktima, e terrorizuar siç qe nga ankthi, me shpresë se ky shërbim do ta shpëtonte, e kryente atë verbtazi.

E pyeta disa herë Bashkim Shehun se a besonte vërtet i ati i tij në isha agjent dhe ai m'u përgjegj se me sa dukej e besonte. Pra viktima kishte rënë ndërkaq në hipnozë.

Për ata që nuk e njohin, ose e njohin përciptazi botën komuniste, kjo mund të duket një fantazi makabre. Për ne jo.

Ajo që nuk ndodhi me mua, ndodhi tetë muaj më pas me një tjetër njeri. Ishte ish-ministri i Brendshëm, Kadri Hazbiu, të cilin iu kërkua një shërbim (krim) i fundit përpresa se të rrëzohej. Ai ishte caktuar ndërkaq të zhdukej, (dinte shumë tmerre e të fshehta dhe diktatori në prag të pleqërisë së thellë po pastronte arshivat), dhe pikërisht përpresa

rënies iu caktua zhdukja e kryeministrat.

Romani "Dimri i vëtmisë së madhe", që më kishte mbrojtur nga dënim, po kthehej tani në një mallkim përmua. Duke më mbyllur portën e burgut, ai më rrezikonte jetën. Diktatori donte të ndante fatin tim nga ai i romanit. Mirëpo ata ishin të lidhur dhe mund t'i ndante vetëm vdekja. Prandaj, që të jetonte i qetë romani, duhej që unë të mënjanohesh ka jeta.

Kështu krijoheshin në regjimet komuniste një fatale, të ngjashme me ato të antikitetit.

Në një film ku tregohet mbërritja e Shostakoviçit në SHBA ishte midis të tjera shqetësues e një gazetari: përsë mbete gjallë?

Kjo shqetësje cinike e thënë me gojë ose me sy, ka qenë tepër e njobur për disa nga shkrimtarët e Lindjes. Ne ishim në rolin e fantazmave, që e kishim vendin gjetkë, dhe që sa më parë duhej të shkonim "atje", në mosqenie. Shumë herë janë bërë shqetësje të tillë dhe janë dhënë gjykime, nga njerëz që s'kanë kurrfarë të drejte të jepin mësimë morali. Të rrish në një lozhë, të bësh sehir se si në arenë ca njerëz përleshen me bishat e egra dhe të bësh vërejtje: në këtë çast ky njeri nuk u tregua sa duhet kurajoz përballet tigrat, ky tjetri madje i bishtnoi, madje i bëri një shëmangje jo fort korrekte! Kjo është thjesht çnjerëzore, për të thënë fjalën më të butë.

S'ka kurrfarë teprimi po të thuhet se ne ishim atje pikërisht ashtu, të vëtmuar, në arenën plot gjurma gjaku, ku s'dihet nga ç'portë e hekurt do të të sulet bisha dhe ku shumica e spektatorëve, kur vinte ora e rrëzimit, nën shembullin e tiranit,

me gishtin poshtë, kërkonin vdekjen tënde.

**A.B. - Gjatë viteve 1981-1982 në krijimtarinë tuaj nuk shohim asnjë gjurmë të kësaj tiranie. Si mund të shkruanit ju "normalisht" në këtë atmosferë terrori? A mund të na flisni pak për ditën tuaj të punës?**

**I. K.** - Në librin "Ftesë në studio" kam folur për kalendarin e dytë të shkrimtarit. Kyçi i enigmës së qëndresës së një shkrimtari përmblidhet në një shpjegim që duket i thjeshtë: sa mundi ai, në stinën e egër të strehohet në këtë kalendar tjetër, si të thuash në shtëpinë e tij të dytë?

Kjo shtëpi eterne është emërtuar gjithfarësoj: banesë qiellore, kullë/e fildishtë, parnas, mërgim i brendshëm etj.etj. Unë do ta quaja thjesht kohë e dytë e shkrimtarit dhe është diçka më e thellë se ato që përmenda më lart. Ndoshta ajo lind me shkrimtarin dhe përbën thelbin e asaj që quhet dhundi. Ajo është quajtur dhundi hyjnore nga që nuk i bindet ligjeve që ka krijuar njeriu mbi tokë, këta pesë mijë vjetët e fundit.

Për t'iu shmangur filozofimeve, po i përgjigjëm sa më thjesht pyetjes suaj, duke përshkruar ditën time të punës. Ajo është "ditë" e kalendarit tjetër, pra e pandryshueshme, e njëllojtë siç ka qenë dje nën diktaturën komuniste, sot në liri, në Tiranë, në Paris ose në një fshat hollandez. Ndaj po përdor kohën e tashme, ashtu si kursantet kur iu kërkohet nga profesori të përshkruajnë të dielën e tyre të fundit.

Çohem zakonisht, aty rreth orës 9. Pas ngrënies së mëngjezit shkoj në studion time. Në qoftë se është dimër ndez zjarrin në vatër. Ime shoqe më sjell një kafe përpara se të iki në punë. Unë mbetem vetëm dhe më duhen rreth dhjetë ose pesëmbëdhjetë minuta të futem në kalendarin tim të dytë. Shkruaj ose mendoj atë që duhet që do të shkruaj, skicoj plane, përpinqem të rrok një ndjesi të turbullt, përmua është njëlloj. Kjo është bota ime që duket se nuk ka lidhje me atë që ndodh përjashta, me stinën, klimën politike, terrorin, festat. Përpara meje është një kohë tjetër, e thërmuar si një miell kristali, kohë pa kahje, si të thuash paraprometheiane, e cila pret që kahjen t'ia jap unë. Edhe hapësira është tjetër, plot "përbindësha gjeografikë", siç i quajnë studiuesit befasitë e baladave mesjetare kur, ngjitur me Bjeshkët e Namuna të Shqipërisë, shfaqet Deti i Zi, ndonëse ai është mijëra kilometra larg. Dua apo s'dua, ditë të tëra më mundojnë me të fshehtat e tyre, rrrekem t'i kap, por pikërisht kur duket se iu afrohem, ato më shpëtojnë. Mendoj p.sh. kohën brenda vdekjes. Njëmendësinë e saj, (ka apo s'ka kohë brenda vdekjes), ritmin, masën e matjes. Mendoj si do të ishte arti në qoftë sejeta mesatare e njeriut nuk do të ishte rreth 75 vjet por 20, si e kafshëve shtëpijake, ose 300 si e disa shpendëve. Më mirë apo më keq?

Ndërkaq në mënyrë të vetvetishme kontrolloj mjetet, filtrat, veglat e mia, ato që i quaj kështu ngaqë s'kanë emër në kurrfarë gjuhe. Veç kësaj, më duhet të jem përherë syçelët përmjet gjendjen e gjuhës: a është mjaftueshëm e shkrifët, e ngrohtë,

e trajtueshme, e bindur ndaj meje, (në çastet e krijimit gjuha i ngjan gruas që pa kushte mallëngjyeshëm të jepet ty), apo mos diçka ka humbur nga të gjitha këto dhe e ngrirë shpaloset para teje, duke pritur një elektroshok për ta ringjallur. Kjo vetëtimë mund të niset prej trurit tënd, po aq sa nga truri i një gjeniu që prej shekujsh s'jeton më, por që ta huan ty për një grimë atë trandje hyjnore.

Brumi i vdekjes është gjithmonë aty pranë, por marrëdhëniet e saj me jetën më duken tejet të vështira. Pakti që është bërë dikur midis tyre më ngjan i padrejtë. Qenkish bërë, siç duket, në një çast ligështimi të jetës. Kështu vdekja ka diktuar fjalën e fundit. Më vjen të shpresoj në një rishikim, në një qortim të tij. Nganjëherë më duket se kam pikasur ca shenja, por i kam humbur përsëri. Nganjëherë më duket se mund të kuptoj diçka nga kodi i fshehtë i gjithësisë, nga kujtesa e stinëve, nga vendimi i përbashkët i sektit të gjetheve, për t'u rrëzuar bashkarisht në muajin nëntor, nga tmerri i gropave thellë në oqeane, që s'janë parë prej asnje syri të gjallë, nga qendra e diellit dhe padyshim nga emigrimi i shpirtrave.

Kudo janë tabutë dhe ndëshkimet për shkeljet e tyre, dhe afatet që më janë dhënë në letrat e mia, dhe kufijtë, dhe pengesat, dhe vulat, që s'më lënë të shkoj më tej. Mbretëritë plot të fshehta janë përbri. Vetëm njëra prej tyre, ajo e brerjes së ndërgjegjes ka aq shumë porta, por askush s'të lë të afrohesh. E mallkoj kufizimin tim si njeri që s'më lë të kapërcej më tutje. Tërheqja e

tokës është aq mizore saqë më vjen habi që pikërisht tokën e kemi lavdëruar aq shumë në poemat tonë.

Këto e të tjera si këto vërtiten pambarimisht në trurin tim. Kam kujtar se i kam dhënë lirinë fjalëve të gjuhës, se gjuha është aty përpara meje si një shtet i përmbysur, që pret që unë ta rindërtoj nga e para. Mirëpo kur shikoj se ç'ka kaluar në libër nga gjithë ky rrëmet, kur shikoj rreshtat që kam shkruar, ato rreshta të tkurrura, të thara si fosile, e kuptoj se ky është një ndër kufizimet më tragjike dhe dua s'dua pajtohem me fatin, domethënë me mendimin se ndonëse shumica e asaj që fryn në trurin e shkrimtarit është e dënuar të shkojë dëm, prapë se prapë ajo që mbetet hyn në stolitë e botës.

Ora po i afrohet mesditës dhe miqtë e mi e dinë se mund të telefonojnë për të pirë bashkë një kafe. Me kryet ende në re nisem për një kafe. Janë dy kafe ku mblidhemi zakonisht, njëra dyzetë hapa larg shtëpisë sime, në Hotel Tirana, tjetra, pak më larg, në Hotel Dajti. Të dyja janë të krimbura me mikrofonë përgjimi, por ne prej kohësh jemi stërvitur të flasim nën to.

Sapo mbërrij marr vesh të rejat e fundit. Do të ketë ndoshta zbutje në marrëdhëni me Francën... Përkundrazi pritet acarim kundër shkrimtarëve. Me sa duket jam hequr nga lista e deputetëve dhe jam zëvendësuar me një aktor. (Pothuajse pa përjashtim gazetarët e huaj e kanë përmendur caktimin tim si deputet, por asnjëri s'do të përmendi heqjen nga parlamenti). Këtë herë acarimi mund të jetë më i fortë se ai i qershorit të vitit të shkuar...

I dëgjoj të gjitha dhe përpinqem të jem i vemannshëm, megjithatë nuk përqëndrohem dot. Mëngjesi im i dytë ende më mbron. Miqtë e mi e dinë këtë, më ngacmojnë lehtazi, por unë e ndiej se edhe ata diçka marrin nga ajo vlagë. E ftohta e diktaturës sillet rrrotull meje, por ajo nuk më krijon veçse një cipëz akulli...

Ata përmendën emrat e dy anëtarëve të Byrosë Politike që pritet të rrëzohen e unë ndonëse i dëgjoj, vazhdoj të vras mendjen se si ka qëlluar që dy personazhet më të njojur të letërsisë Prometheu dhe Don Kishoti, pas retushimit që u ka bërë njerëzimi mbarë gjatë shekujve, i pari, Prometheu, ka përfituar, duke u bërë më heroik, kurse i dyti, Don Kishoti, i keqpërdorur sidomos në luftërat politike (komunistët i kanë quajtur gjithë kundërshtarët e tyre Don Kishotë, e antikomunistët kanë bërë të njejtën gjë) ka humbur fisnikërinë e vet...

Mbasditja është padyshim më e rrezikshme. Sidomos ka një orë të keqë, në prag të muzgut. Sikur ta dijë këtë, djali i kryeministrit, shkrimtari Bashkim Shehu, vjen pasdite vonë. Ai më thotë se drejtuesit e Shqipërisë, Enver Hoxha dhe babai i tij, mendojnë që unë jam agjent i Perëndimit. Lajmi është pa dyshim i tmerrshëm dhe unë sapo e kam shpenzuar mbrojtjen e mëngjezit. Mbasdite, e sidomos në prag të muzgut, gjithçka duket sterrë. Në një vend ku njerëzit janë gati të bëjnë çmos për të ditur ç'mendon udhëheqja për ta, ose vuajnë nga dyshimi më i vogël se mos udhëheqja mendon keq, të marrësh vesh se ty të gjykojnë si agjent, është vërtet e fundbotshme.

Përpinqem të mos mendoj asgjë. Gjithë puna është sa të bjerë nata dhe të më zërë gjumi në qoftë se do më zërë. Gjithë puna është sa të vijë mëngjezi. Pas darke bëj një shëtitje nëpër bulevardin e madh me time shoqe. Është gati mesnatë dhe pa dyshim, ne flasim për këtë, por jo në mënyrë të vijueshme. Herë-herë, si zakonisht, unë i tregoj asaj diçka nga ajo që do të shkruaj nesër. Si zakonisht... E ndjej se ajo me veten e saj më bën pyetjen: vërtet do të shkruash nesër si çdo ditë? Nga mënyra si unë flas ajo e kupton se kjo është e vërtetë. Qetësia që unë me forcë ia ngjit vetes kalon tek ajo. Hapat i gjallërohen dhe flokët e verdhë duket se i gufmojnë.

Dy-tri herë natën më del gjumi, megjithatë arrij të flej. Mëngjezi më në fund po afron. Mëngjezi im mbretëror. Atje, pranë dorëshkrimeve të mijë unë mun ta përballoj diktaturën. Tmerret që kam në kokë janë më të fortë se tmerret e saj. Vdekja e saj është e zbehtë, e zvetnuar në krahasim me atë brumë kolosal vdekjeje, që unë e komandoj më mirë se ajo. Unë jam ndërkaq në përmasën time të dytë ku ajo, edhe po të më arrijë nuk më shkatërron dot.

Përpara se të niset në punë ime shoqe vjen të më përhëndessë. Mendoj se në të vërtetë vjen të më shikojë në se është i vërtetë premtimi im i mbrëmshëm se do të punoj. Me bisht të syrit ajo sheh rreshtat e para dhe ndriçohet krejt. Megjithatë nuk e bën veten, si njeriu që ka drojë mos e marrë më sysh një mrekulli. Ajo më thotë "mirupafshim" dhe disa çaste unë e përfytyroj si ecën në rrugë e çliruar dhe e bukur.

Ndërkaq kam arritur të futem në monarkinë time. Fjalët "agjent i perëndimit" më vetojnë herë pas here nëpër tru, por të thara, si vetëtima të vizatuara. Unë banoj në një trevë të botës që i thonë Lindje, mendoj ngathtësisht, pa dashur, midis dy frazave. Më tutje nis një trevë që i thonë Perëndim, ndonëse toka, bashkë me bimët dhe retë sipër, dhe të vdekurit poshtë saj, është po ajo. Unë fajësohem se pëlqej më fort atë anë andej dhe, ta marrësh seriozisht këtë është njëlloj si të marrësh me gjithë mend, mosmarrëveshjet e njerëzve primitivë për një pupël, që po ta venë nga ana e majtë ose e djathtë e kokës përbën tabú dhe po të bëjnë të kundërtën përbën totëm...

Të gjitha këto i mendoj herë pas here gjatë ditës, por nuk kam mundësi ta pyes Bashkim Shehun. Ta pyes për kurreshти B.Sh. në qoftë se jam vërtet i qetë apo kështu më duket ngaqë kështu më pëlqen të jem. Nuk kam mundësi ta pyes sepse pas tri javësh babaj i tij vret veten ose vritet tragjikisht dhe Bashkim Shehu, si krejt familja, futet në burg.

Vijnë javë të tjera të rënda ku çdo natë unë e përfytyroj në qeli, të lidhur me vargonj duke e torturuar dhe duke e pyetur ç'ka folur me mua. Kemi folur në të vërtetë kundër regjimit dhe të gjitha gjasat janë se në torturë, si shumica e njerëzve ai do të tregojë. Bindja për këtë më shtohet kur në një sallë të madhe të Ministrisë së brendshme thirren intelektualët më të shquar të Tiranës për të dëgjuar pjesë të incizuara nga hetimet. Unë jam pa dyshim, midis të ftuarve.

Dhe ja zëri i njohur i Bashkim Shehut. Këjt si në proceset e Moskës 1937, si në hipnozë ai fajëson babanë, vetveten.

Më duhet të pres dhjetë vjet për të marrë vesh ç'ka ndodhur në të vërtetë. Si e kanë pyetur për mua netë të tëra në qeli, si është përgjigjur. Për kurreshtinë e vogël gjithashtu më duhet të pres librin e tij "vjeshta e ankthit" që e shkroi dhe e batoi pas daljes nga burgu më 1992. Atje ka përshkruar me saktësi ditën kur erdhi të më thoshte se unë quhesha agjent dhe mënyrën se si e prita këtë sezoni.

Herë pas here shfletoj veprat që kam shkruar në atë kohë për të parë se ç'ndikim ka patur terrori në to. "Krushqit janë të ngrirë", "Dosja H.", "Qorrfermani" pjesë të "Koncertit" dhe sidomos "Hija". Sa më shumë diktatura egërsohej, aq më fort ato egërsosreshin gjithashtu. Duken sipër tyre gërvishjet e kthetrave të përbindëshit. Por ato janë sipër zhguallit të hekurt. Ja p.sh. "Hija". Si një mbrojtje të parë, në rast bastisjeje të befasishme nga Sigurimi, në faqen e parë është shkruar: Siegfried Lenz, "Hija", përkthyer nga Ismail Kadare.

Ishte një mbrojtje e dobët, tejet e brishtë, e llogaritur për kontrollin në aeroport, gjatë nxjerrjes së dorëshkrimit jashtë shtetit. Siç ju kam thënë më parë, nxjerra e dorëshkrimeve jashtë ishte rreptësisht e ndaluar. Në rast kontrolli të çantës së dorës do të thoshja se nuk ishte veç një përkthim. Dhe në qoftë se kontrolluesit do ta shfletonin dorëshkrimin, përvëç emrit të autorit gjerman, do të ndeshnin në mjediset dhe emrat e personazheve, të gjitha të kthyera në gjermanë. Natyrisht që

me një lexim të kujdeshëm do të kuptohej se kjo s'ishte veçse një maskim naiv dhe se libri ishte i imi dhe fliste për Shqipërinë, por ndërkaq avioni do të ishte nisur dhe unë s'do të kthehesha më.

Kështu pra ishte llogaritur kjo mbrojtje për 20-30 minutat e pritjes së avionit. Dhe ashtu ndodhi pak a shumë vërtet më 1987, kur me dorëshkrimin në çantë kapërceva doganën. E besuan që ishte një përkthim i Lenzit dhe nuk ma mbajtën!

Më 1982, në Oslo të Norvegjisë, gjatë një darke të gëzueshme shkrimtarësh, qëllova në një tryezë me Siegfried Lenzin. Ia tregova ç'kishë bërë dhe pasi qeshëm një copë herë, ai më tha t'ia tregoj përsëri, dhe në fytyrën e tij fisnikë dukej kënaqësia e thellë, kënaqësia e pafund e kolegut, që në një çast të vështirë të jetës sime, në atë skëterrë ku isha, si një shpirt i ardhur nga larg, që të jep një mjet magjik mbrojtjeje, më kishte huajtur emrin e vet gjerman.

*A.B. - Vepra juaj ndjek një ritëm marramendës. Që prej 1980-ës, pothuaj çdo vit, ka të korrat e veta, të cilat ndryshojnë nga ato të një viti më parë dhe nuk lajmërojnë asgjë për vitin e ardhshëm. Preokupacione e mendime që plotësojnë njëri-tjetrin duke kaluar nga një temë në tjetrën. Njeriu nuk do të dijë më në se te ju ndodh të hasni vështirësi. Ju gëzoni një pandëshkue-shmëri të jashtëzakonshme: të paktën kështu ju imagjinojnë në Perëndim. Krijuesi, sidoqoftë duket se gëzon një pavarësi të plotë. Ju botoni romanin*

*"Kështjella" që mund të ishte titulluar Shtetrrethim ose edhe Elozh shtetrrethimit. Ju përshkruani me hollësi një betejë të paharruar ku flitet për Gjergj Kastriotin, i cili me emrin Skënderbeg, do të bëhet heroi kombëtar i vendit tuaj si dhe mishërimi i kurajos së paepur përballë Turqve. Kjo dëshmi e lartë e vitit 1443, është për shqiptarët sikundër beteja e Bouvines apo e Crécy-së për francezët. Pak rëndësi ka ç'ndodhi në realitet atje. Populli e shfrytëzoi ngjarjen për ta kthyer në një shembull, sado konfuz që mund të ketë qenë zhvillimi i fakteve historike.*

*Ndërkohë të vijnë në mendje shumë pyetje. Le të shohim në fillim një aspekt praktik: a dispononi ju material arkivor apo dëshmi të mjaftueshme? A duheshin plotësuar me deduksion të dhëna jo shumë të qarta apo kontradiktore? Ju s'jeni as arshivist as historian në kuptimin teknik të fjalës. Le të imagjinojmë, në shekullin e kaluar, një historian si Jules Michelet të trajtojë një ngjarje të kësaj natyre. Duhet pranuar se Michelet do ta restauronte sipas mënyrës së tij të vërtetën historike: do ta rikrijonte atë sipas nevojës. Ai është përgjegjës - nuk po përdor fjalën fajtor - për përshkrimin e një portreti pak a shumë të zbukuruar, fantazist të Jeanne d'Arc. Përderisa ju e quani librin tuaj roman, mendoj se nuk duhet t'ju vinte keq ta përshkruanit betejën në fjalë sipas mënyrës së një shkrimtari të shekullit XIX. Sjell ndër mend këtu Prosper Mérimée me "Kronikën e mbretërimit të Karlit të IX", e cila është një pjesë antologjie, apo prozat e bukura të librit "Tregime nga koha e merovingasve" i Augustin Thierry. Sipas mendimit*

*tuaj, lënda historike që ju na ofroni, a mund të trajtohej, objektivisht, nga një fushë tjeter. Sigurisht, kjo vepër, në një farë mënyre, i thur lavdi patriotizmit. Por, për mendimin tim, ka një element shumë më tepër të ndjerë universalisht, në se guxoj të shprehem kështu. Ju kufizoheni në një vend pa na dhënë një panoramë të tij. Edhe në se e vendosni ngjarjen diku, ju e zhvishni atë pothuaj fare me qëllim që lufta të çlirohet nga gjëra të dorës së dytë. Qëllimijuaj është vetë luftimi dhe jo rrethanat që e krijuan; edhe përfundimi, nuk ju intereson. Do të doja, po qe se do të ma lejonit, ta krahasoja këtë libër me një roman që ka lënë gjurmë të thella për jehonën e tij intelektuale: "Shkretëtira e tartarëve" e Dino Buzzati. Përveç anekdotës aty shohim një lloj etike: duhet të ekzistojë frika e pushtimit që një popull i tërë të ndërgjegjësohet për vlerën e tij. Një ndjenjë të tillë provoj, duke lexuar librin "Kështjella". Njeriu gjen vlerat e tij të vërteta kur merr pjesë në një rrithim: pak rëndësi ka në se është rrethues, apo i rrethuar. Këtë çmim ka mohimi i vvetes. Ky është një moral për epokën tonë. Fakti që ju flisni për Shqipërinë në të kaluarën qëndron në plan të dytë. Rëndësi ka që jeni post-Kafkajan.*

*Pa dyshim ju keni shfrytëzuar të kaluarën por nga ajo ju nxirri shumë mësime që mund të duken kontradiktore. Nën një diktaturë, e kaluara nuk pajtohet me idealin e kësaj diktature. Ndjenja kombëtare - pa folur për një nacionalizëm të ngushtë -është e pavarur nga rrethanat e pranishme. Që të përcaktosh mentalitetin e një populli me të gjitha aspektet e tij pasionale, duhet të dish ta*

*madhështosh atë me anë të imagjinatës. Së fundi, krasa punës së historianit, pothuaj paralel me të qëndron puna më pak e dukshme e romancierit pasi nuk është fjala që nga faktet e kaluara të japësh një përfytyrim të saktë, por ti thurësh atyre lavde. Fakti që shkrimet e Homerit, apo të Nikos Kazantzakis apo Yachar Kemal, janë ngulitur në mendjen e popujve të tyre nuk tregon se këta autorë janë mbështetur në dokumenta.*

**I.K. - Në fillim** dua të them diçka për atë që ju e quajtët "përmasë perandorake" në librat e mij, e që lidhet në radhë të parë me perandorinë otomane, e pastaj me perandoritë e tjera: egjiptiane, romake, bizantine, sovjetike dhe së fundi kinezë.

Ndryshe nga fryma e Greqisë antike, që depërtoi tek unë nëpërmjet leximit dhe aspak nëpërmjet afërsisë fizike të Greqisë (duhet të përsërit se Greqia veriore fqinjë ishte kaq larg antikitetit grek, saqë ngjante më fort me Shqipërinë sesa me landin grek), "Frymën perandorake", sado paradoksale të duket, unë e gjeta së pari në qytetin tim të lindjes.

Ndonëse i vogël, me rreth 20.000 banorë, ky ishte një qytet i shquar për kuadrot e larta, që i kishte dhënë shtetit të madh osman. Këto kuadro, kur dilnin në pension, (nëqoftëse nuk iu pritej koka gjatë udhës së vështirë të karierës), ktheheteshin për të ngrysur pleqërinë në qytetin e lindjes.

Në fëmininë time, në fillim të viteve '40, **kishte ende dinosaurë** të tillë, që jetonin me kujtimet e perandorisë së përbysur ndërkaq. Më tërhiqnin

shumë këta Don Kishotë, me fytyra dhe veshje të çuditishme, që rrinin me orë të tëra në dritaret e shtëpive të tyre të mëdha e tepër të larta, duke vështruar me tejqyrë larg. Një Zot e di se ç'vështronin, ose ndoshta sytë e tyre nuk shquanin tanis gjë, veç përfytyronin pamje e kujtime të vjetra. Veçse lëvizjet i kishin po aq madhështore si dikur dhe tejqyrat i mbanin me po atë mënyrë siç i kishin mbajtur kur kishin hulumtuar që larg muret e qytetit që do të pushtonin, ose ushtrinë, që kishin në komandë. Unë isha i bindur se ishin të çmendur dhe kjo bindje më forcohej kur nganjëherë u flisnin kalimtarëve që nga dritarja. Gjuha e tyre ishte e pazakontë, plot fjalë të huaja, që i kishin sjellë nga larg, ashtu siç duhej të kishin sjellë të fshehtat shtetërore, intriga të kryeqytetit, ku kishin marrë pjesë edhe vetë, ose histori dashurie me zonja të mëdha.

Këta personazhe zunë një vend të veçantë qysh herët në fantazinë time. Dhe bashkë me ta, natyrisht, përndritja e fundit, e përzishme e një perandorije tetëqind vjeçare, në muzgun dhe përblysjen e së cilës, njëzetë vite më parë, ata kishin qenë të pranishëm.

E kam thënë shumë herë se kjo perandori është një minierë floriri për shkrimtarët. Në të gjen të gjitha racat njerëzore, të gjitha fetë, klimat, peisazhet, të gjitha dramat e popujve e, sidomos të gjitha mekanizmat e shtypjes totalitare, që nga perandoria e Romës, te Bizanti e mongolët, gjer te Rajhu i tretë e perandoria sovjetike.

Shkrimtarët ballkanas, pothuajse pa përjashtim, e kanë mihur këtë minë. Dy prej tyre

sidomos: greku Niko Kazanzaqis dhe boshnjaku Ivo Andriç kanë shkruar faqe madhështore përtë. Për çudi, shkrimtarët turq vetë, e kanë shfrytëzuar shumë pak, ose aspak. Kur e kam pyetur përkëtë shkrimtarin më të madh të Turqisë Jashar Kemalin, më është përgjigjur se ndoshta kjo ka ardhur se ata ishin shumë pranë ekranit, dhe kur je tepër pranë nuk i dallon mirë gjërat. (Në bisedën me ju ai përshkruan një kohë kur jetonte në Anadoll dhe nuk e dinte se jetonte në Anadoll). Mendoj se ka një pjesë të së vërtetës në këtë shpjegim.

S'ka dyshim se largësia e ka bërë më të kthjellët e më zotëruese optikën ballkanase, por përsa i përket kësaj zbrazëtie në letërsinë e sotme turke, mendoj se ka lojtur rol ndikimi i letërsisë sovjetike. Fryma e saj tepër realiste-marksiste, tepër fshatarako-romantike e shoqërore, (kujtoni Mizërinë e romaneve në titujt e të cilëve do të gjeje ose fjalën "tokë" ose "agim"), e përjashtonte venën dramatike. Ajo përjashtonte sidomos zbërthimin e makinës shtypëse totalitare e atës fatalitet e mister të brendshëm pa të cilat nuk mund të kapen "përmasat perandorake". Duke përqmuar me të drejtë veprat rozë ekzotike përharem dhe magjinë e Orientit, shumë shkrimtarë turq ranë, përfat të keq, nga shiu në breshër.

Po kthehem te romani im "Kasnecët e shiut", i cili hap serinë "perandorake", në se mund ta përdor një epitet të tillë, pa u rrezikuar të merem si vetëmburrës. Ky roman mund të ketë tri lloj leximesh. Leximi i parë, i drejtpërdrejti, është ai i një romani ku përshkruhet një ngjarje mesjetare e Shqipërisë: rrëthimi i një kështjelle të saj. Është

afërsisht mesi i shekullit XV. Perandoria otomane, pasi e ka marrë veten nga goditja e tmerrshme e Timur Lengut, i sulet përsëri Gadishullit ballkanik për të kryer pushtimin e lënë përgjysmë. Pra jemi afërsisht 60 vite pas betejës së Kosovës që ndodhi më 1389 dhe që serbët në mënyrë naive, për të përdorur një fjalë që iu shkon fare pak, e paraqesin si fillimin dhe fundin e qëndresës ballkanase. Në të vërtetë, qëndresa e vërtetë ndodhi më pas dhe vazhdoi rrëth 30 vjet, duke pasur për skenë kryesore tokën e shqiptarëve. Kështjella e fundit shqiptare, ajo e Shkodrës, ra në vitin 1478, pas rrëthimit që i bëri Sulltan Mehmeti II, pushtuesi i famshëm i Konstantinopolit. Me rënien e saj, u mbyll një epokë. Ndoshta ngaqë ishte kështjella e fundit, për ndonjë premtim mistik ose për arsyet jetër ndodhi diçka e rrallë për kohën. Sulltan Mehmeti II e mbajti fjalën, që iu kishte dhënë mbrojtësve shqiptarë, se në rast dorëzimi do t'u falte jetën dhe do t'i lejonte të largoheshin ku të donin. Kështu, garnizoni heroik, i përgjysmuar, i gjyntuar, u largua drejt Venedikut. Midis këtyre fantazmave të pluhurosura, që Evropa i priste si heronj të kohës, ishte edhe prifti Marin Barleti, biografi i parë i Gjergj Kastriot Skënderbeut. Më 1942 ai botoi në Venedik librin e parë të famshëm të tij "Rrethimi i Shkodrës". Libri, i shkruar në latinisht dhe i botuar në shumë kryqytete të Evropës, është një nga dëshmitë më tronditëse të kohës. Ndonëse në romanin "Kasnecët e shiut" flitet për fillimin e luftrave që vazhduan rrëth 35 vjet, libri i Barletit, kjo këngë e fundit e mjellmës, më shërbue si bazë për të. Ai më dha

njëren optikë të dramës, atë të mbrojtësve. Optikën e jashtme, atë të rrëthuesve, e gjeta në kronikat e kronistëve turq, që shoqëronin ushtrinë gjatë fushatës. Pra, ky është leximi i parë i romanit, si një vepër që rikujton qëndresën shqiptare në shekullin XV.

Tani, pas rënies së komunizmit në Shqipëri dhe në botë, unë nuk do të guxoja të mëtoja (pretendoja) një lexim tjetër, më të ndërlikuar të veprës, që mund të dukej si kurajo e vonuar nëqoftëse ky lexim i dytë nuk do të ishte shpallur qysh në atë kohë, pra në vitin 1970, kur romani u botua në Shqipëri, dhe një vit më pas, në Francë. Në parathënie të botimit, qysh në atë kohë, u tha se kemi të bëjmë jo vetëm me një ngjarje mesjetare, por edhe me ngjarjen që porsa kishte ndodhur: daljen e Shqipërisë nga kampi socialist dhe traktati i Varshavës dhe bllokada, (rrethimi) i saj prej vendeve të Lindjes. (Kaq qartë qe thënë kjo saqë përmendet dhe pushtimi i Çekosllavakisë prej sovjetikëve më 1968, fat që nuk e pësoi Shqipëria).

Pra, sipas këtij leximi tjetër, rrithimi i otomanëve ngjan si dy pikë uji me një rrithim tjetër: atë të vendeve komuniste. Në çdo kapitull ka detaje që të kujtojnë kohën tonë dhe për lexuesin është fare e lehtë që, pas mizërisë së rrëthuesve otomanë të shikojë herë sovjetikët, herë kinezët, herë përgjithësisht lindorët. Komunizmi, Azia, Lindja, përzihen dhe bëhen dalëngadalë njësh.

Natyrisht që këtu keni një paradoks gati të padurueshëm dhe ju mund të pyesni: Ç'është ky rrithim i një vendi komunist(madje stërkomunist)

si Shqipëria, nga vendet e tjera komuniste? A ka kuptim kjo kundërvenie, a ka qenë e njëmendtë, apo s'ishte veçse përshkrimi i një shajnie (halucinacioni)?

Ju keni të drejtë të habiteni, madje të dyshoni, madje dhe të zemëroheni. Por historia e komunizmit ka mjaft paradokse, një ndër të cilat e përbën marrëdhëni e Shqipërisë me perandorinë e kuqe. Nga këto paradokse, ashtu si të mbledhja e krerëve të komunizmit në Moskë më 1960, ashtu si në ngjarje të tjera, unë kam nxjerrë subjekte, që s'mund të ishin veçse paradokse.

Rrethimi i Shqipërisë prej kampit komunist ka qenë dhe s'ka qenë i vërtetë. Ai ka qenë diçka midisëndrrës dhe zhgjëndrrës, kështu që ju edhe keni edhe s'keni të drejtë ta quani haluçinacion. Ju s'keni të drejtë ta quani kështu sepse ky rrethin ka qenë vërtet dhe ne shqiptarët e kemi parë me sy sesi u prenë njëra pas tjetrës gjithë marrëdhëni me botën komuniste, si u paralizua një farë kohe prej embargos gjithëjeta e vendit, dhe së fundi, si pritej me ankth ndonjë zbarkim i sovjetikëve (ai që i ndodhi më 1968 Çekosllavakisë). Mirëpo ju gjithashtu keni të drejtë të thoni se në gjithë këtë histori ka diçka që nuk shkon, se ka diçka të mbapshtë dhe kundër logjikës, kjo gjithashtu është e vërtetë. Ngjarja do të ishte e kuptueshme e logjike sikur vendet komuniste vëllezër, të rrethonin e të mbysnin një vëlla rebel liberal, (siç e bënë me Hungarinë më 1956, ose me Çekinë më 1968). Mirëpo këtu kemi të bëjmë me një vëlla që jo vetëm s'është liberal, por është e kundërta. Ndërkaj ne e dimë se përvëllezër të tillë, sado të bezdiss'hëm

të jenë, nuk vjen puna asnijëherë sa të rrighthohen e të mbyten pa mëshirë. (Ul brihti ishte përkëdhelur vazhdimisht dhe Jacques Duclos, dhe së fundi Çaushesku, për të përmendur vetëm disa prej komunistëve gjakatarë).

Ashtu si në mbledhjen e Moskës më 1960, ashtu edhe në letimin (exkomunikimin) e Shqipërisë prej kampit, ka përherë një mospërputhje midis thelbit të ngjarjes dhe zhguallit (lëvozhgës) së saj. Pyetja mund të shtrohet fare shkoqur: kemi përpara nesh një rrithim, veç nuk e dimë se kush në të vërtetë ka rrrethuar tjetrin.

Që këndej, kërkesa për një lexim të tretë të romanit, e ngritur prej një kritikut të ri shqiptar Adrian Vehbiut tani që komunismi është shembur, më 1993, më duket se është më e logjikshmja. Sipas tij, përpara se të kemi rrithimin e Shqipërisë prej perandorisë otomane dhe prej kampit socialist, ne kemi një tjetër rrithim: rrithimin e pjesës më të mira, më fisnike të Shqipërisë, prej pjesës më barbare të saj. Këtu logjika vihet në vend: Shqipëria stërkomuniste ka rrrethuar dhe kërkon t'i marrë shpirtin pjesës më liberale të saj. Pra, e rrrethuara dhe rrethuesja është ajo vetë.

Ky zërthim i ri i veprës do të ndihej fare qartë në qoftëse unë do të mund të botoja në atë kohë disa detaje, me të cilat është i mbushur libri i Barletit, si lutjet në kishën brënda kështjellës e sidomos ikonat që mbrojtësit shqiptarë i nxjerrin shpesh në ledhet e kështjellës për të marrë zemër. Tabloja do të ishte tepër e qartë: një botë e ashpër që sulet të mbysë një grusht të rrrethuarish, që mbajnë në duar veç shpatave ca ikona. Mirëpo

ishte viti 1969, kur e shkrova këtë roman. Feja apo ishte ndaluar me dekret në Shqipëri. Kishat dhe xhamijat ishin rrënuar, me mijëra ikona ishin djegur dhe vetë përmendja e fesë ishte e pamundur. Megjithatë, ndonëse ikonat nuk duken ata ndihen. Të gjitha hyrjet përpara kapitujve janë shkruar me një stil të veçantë, që të kujton stilin kishtar. Më kujtohet se ju, në artikullin tuaj për këtë roman më 1971 e kapët këtë hollësi dhe shkruat shprehimi i se këto hyrje tingëllojnë si psalme.

Romani, siç është thënë disa herë e kapërcen Shqipërinë dhe merr tingëllim gjithësor(universal) pikërisht pas këtij leximi të ri. Ky vetërrethim, kjo ngrënje e vetvetes është një dukuri, që ka ndodhur po aq në Rusi ose Poloni sa edhe në Hungari, Çekosllavaki apo Kinë. Ajo është një nga faqet më tragjike të historisë.

*A.B. - Pas katër a pesë romanesh konstatojmë se keni ndërmarrë, me forma të ndryshme, të na jepni një përcaktim të Shqipërisë së vjetër apo moderne, pavarësisht nga regjimi politik nën të cilin e ka hedhur fati. Unë pyes vetveten nëse kjo ndërmarrje e gjatë është konceptuar me një vendosmëri sistematike, apo është një nevojë që ju imponohet pak nga pak. Ndoshta ky sugjerim është një koncept fare i huaj për mendësinë tuaj dhe për atë çka është në të vërtetë Shqipëria. Për këtë ka disa arsyen. Shqipëria është nga pikëpamja shpirtërore vendi më i panjohur e më i largët nga të gjitha vendet e Evropës. Pak udhëtarë kanë kaluar atje e, edhe ata, nuk kanë sjellë*

*ndonjë gjë me rëndësi. Vendi ka jetuar në izolim, dhe duhet pohuar, nën indiferencën e Evropës Perëndimore. Ne kishim nevojë ta njihnim, ta kuptonim, të merrnim me mend ç'ish Shqipëria e jo të kënaqeshim me imazhin për qëllime interesit dhe tepër të idealizuar që na ofronte në raste të rralla rregjimi komunist sipas mënyrës enveriste. Na duhesin ndjenjat e saj, iluzionet, depërtimet e saj në rrënje me degëzime të ndryshme. Këtë mund ta quajmë shpirtin e një populli. Mund ta quajmë gjithashtu dimensionin e tij të pakapshëm. Nga vëllimi në vëllim m'u shfaq se i tillë ishte projekti juaj i madh. Mos vallë e kam gabim?*

**I.K.** - Për një kohë të gjatë nuk e kam menduar këtë gjë. Kisha mjaft shqetësime të tjera që më përpinin krejt. Ndër to kryesorë mbetej gjithnjë që të vazhdoja të shkruaja pa u zvetënuar prej komunizmit. Nganjëherë kjo ngjante aq e pamundur sa të luftoje me pleqërinë, për të mos thënë me vdekjen. Një besim i verbër brënda meje këmbëngulte se do ta mposhtja të pamundurën.

Ideja për një tablo globale më lindi më pas. Siç e kam përshkruar te "Pesha e kryqit", kjo ndodhi në vjeshtën dhe dimrin e vitit 1975, ku për të shlyer mëkatet që kisha bërë, domethënë telashet që i kisha nxjerrë shtetit zemërmirë, mëshirëmadh komunist, detyrohesha të linja Tiranën, për të jetuar një farë kohe në një barrakë, në një katund të humbur fushor. Ishte një nga periudhat më të rënda në jetën time. Ishte ndoshta hera e parë që përfundimisht m'u zhduk edhe ndonjë shpresë se komunizmi do të binte në gjalljen time.

Kështu që vetvetiu m'u krijua një optikë e re, e zymtë natyrisht, por e pamëshirshme për veprën time. Atë e mendoja tani përtej meje, të ndarë, të vëtmuar, në një epokë tjeter, ku si bonjake, do të gjendej në mëshirën e fatit. Në mbrëmjet e ftohta, kur errësira e fushës e bënte edhe më zotëruese praninë e vdekjes e të harrimit, larg shtëpisë dhe studios sime të punës, asaj që më kishte mbrojtur nga klima e komunizmit, unë ca kohe e ndjeva veten të humbur. Mirëpo pikërisht atëhere kur pata drojë se do të rrëzohesha, pikërisht në këtë humbëtirë, e ndjeva se kisha rrokur një përmasë të re të lirisë së brëndshme. E ndjeva se çdo gjë mund të ndodhë por unë s'mund të tjetersohesha më si shkrimtar. Diktatura ndoshta kishte vonuar. S'kisha më frikë për veten, por për tjeter gjë. Unë s'do të ndryshoja, por do të ndryshonte Shqipëria. Kështu që fitorja ime e brendshme s'ishte veçse një gënjim i mjerë në sfond të kësaj zezone. Një Shqipëri e prishur, e shfytyruar do të ishte varri i gjithçkaje, duke përfshirë edhe letërsinë... Kështu në mendjen time merrte spikamë ideja në mos për të ndaluar zvetnimin e Shqipërisë, ngaqë kjo ishte mbi forcat e mia, për të lënë së paku një dëshmi të fytyrës së saj të përjetshme, një model, një shtampë, apo një lloj dhjate, nga ato që depozitohen në një kasafortë banke. Kështu që kur të vinte ora e ringjalljes, Shqipëria e mpirë nga ngrirja e gjatë, të gjente diçka ku të mbështetet për të rikrijuar vetveten.

Vetvetishëm e kisha bërë këtë edhe më parë, por vetëm në vitin 1975, mendimi për të krijuar një **Shqipëri** të dytë mori një trajtë të qartë.

"Ura me tri harqe" është ndoshta vepra e parë e këtij shestimi. Ajo është plot gropë themellesh, plot gurë, kërcënime, krime, dhe kryesorja, ajo ka në qendër të saj një flijim. Pra është një libër, si të thuash, themelues. Ai është i tillë nga shumë pikëpamje. Personazhi kryesor, ai që rrëfen kronikën e ngjarjeve është një murg katolik. Pra një murg i fesë së parë, të kryehershme të shqiptarëve. Mirëpo t'i jepje fjalën një murgu katolik në Shqipërinë komuniste, ku feja ishte e ndaluar me ligj, ishte një gjë e jashtëzakonshme. Ky murg është ndoshta personazhi më i plotë pozitiv, siç thuhet, në veprën time. Ai flet nga altari i kishës për fatet e Shqipërisë, për rreziqet që e kërcenojnë, për gjëmat që e presin këtë vend. Në një vend komunist vetëm udhëheqësit komunistë kishin të drejtë të flisnin për këto gjëra. Kështu që ky libër është vërtet një themel për gjithë veprën time.

Pas saj, në mënyrë këmbëngulëse unë vazhdova të plotësoj ngrehinën. E ndjeja veten dyfish krijues: krijues i një vepre, e njëkohësisht krijues i një Shqipërie të dytë, ose më saktë, i fantazmës së Shqipërisë. Kjo Shqipëri e dytë do të ishte veç të tjeras, një sfidë për Shqipërinë e njëmëndtë, të mërzitshme e shkretimtare komuniste. Ajo do të ishte një hije, një vrasje ndërgjegjeje e vazhdueshme dhe, pa dyshim, një shpresë përringjallje.

U gjenda kështu në rolin e krijuesit në kuptimin e mirëfilltë të fjalës dhe kjo më shkaktonte herë-herë një frikë të turbullt. Ishte tmerri që të shkakton imitimi i hyjnisi. Atë që Folkneri e

kishte bërë duke krijuar kontrenë e përfytyruar, Yoknapatapha, atë që Borgesi kishte fantazuar për qytetet e panjimendët Plöm, Uqbar, Orbis e Tercius, unë po përpiqesha ta bëja me vendin tim.

Në epilogun e "Urës me tri harqe" njëjësimi i im me murgun është bërë fare haptaz. Si kronist i kohës ai ka drojë se kronika e tij, ashtu si ura e porsangritur do të kërkojë një flujim. "Dhe në këtë rast i flijuari s'ka kush të jetë tjetër veçse unë" shkruan ai duke e mbyllur librin.

**A.B.** - *Në se çka u fol më sipër është pjesërtsh, apo plotësisht e vërtetë, lind pyetja ç'mund të mendonte për këtë Hoxha, apo hierarkia në pushtet. Komunizmi nuk e ka pasur për zakon të heqë dorë lehtë nga doktrina e realizmit socialist në fushën e artit dhe krijimtarisë.*

-Atij i duhet të sigurohet që shkrimtari është zëdhënës i tij dhe që dobishmëria e tij të jetë në shërbim të doktrinave të tij: rendimenti i tij duhet të jetë i menjëhershëm. Në këto kushte, ta bësh një lexues të èndërrojë duke i përshkruar një histori me turq dhe zotërinj të Mesjetës, a nuk do të thotë të jesh pranë herezisë? Ky lloj lirizmi është diametralisht i kundërt me objektivat e Partisë. Nga ana tjetër, të pranosh që një shkrimtar në zë vë në dukje origjinalitetin e një kombi duke i dhënë atij titujt e aristokracisë, është mikluese si për shkrimtarin edhe për qeverinë, pavarësisht nga ideologjia. Mendoj se në këtë kontekst, rasti i juaj ështëunik. Gjetkë, diktaturat mund të kërkonin

*përmes shkrimtarëve të së kaluarës mbrojtës paraprirës, në se mund të shprehemi kështu. Për Gjermaninë naziste një Schiller - i parapëlqyer ndaj Gëtes, mjaft tolerant e humanist për të, - ishte një shans dhe një referim në një të kaluar tashmë tepër të largët. E njëjtë gjë ishte dhe për Nietzsche. Mussolini arriti të siguronte për vite me radhë mbështetjen e Annunzio. Përveç Dostojevski-t, mjaft pesimist, Rusia e Leninit, Stalinit e Brezhnevit nuk hodhi poshtë asnje nga shkrimtarët klasikë të shekullit të XIX: nga Pushkini tek Çehovi e duke kaluar nga Gogoli dhe tepër aristokrati Tolstoi, regjimi e ka konsideruar gjithmonë panteonin e saj si një pasuri të paprekshme e të shenjtë. Rasti juaj është më i koklavitur. Asnjë nga veprat shqiptare nuk kishte kapërcyer kufijtë e vendit përveç disa poemave të pakta të Migjenit. E ja, Ismail Kadare bën gjithnjë e me shumë emër si shkrimtar i madh në të gjithë Evropën. Si duhet të reagojnë Partia, kryetari i qeverisë, Lidhja e Shkrimtarëve e sidomos kryetari i Shtetit?*

*Me këtë kërkoj që të plotësoni historinë e marrëdhënieve tuaja me Partinë, përderisa në sytë e një të huaji, që prej viteve 70-të ju jeni i vetmi shkrimtar i vendit tuaj. Kush ju gjykonte në vendin tuaj? Çfarë lloj lirie ju linin? Ç'kërkonin nga ju në këmbim të kësaj lirie? Ç'kërkonit ju nga vetja juaj? Përfytyroj yçkla e madje diskutime për vlerën e botimit të kësaj apo asaj vepre. Më vonë e di se keni shprehur diçka lidhur me këtë çështje tek "Pranverë shqiptare". Lexuesit evropian i intereson itinerari i këtyre marrëdhënieve, aksidentet gjatë rrugës, heshtjet, protestat e dukshme të kolegëve*

*shpesh më katolikë se papa. Ju nuk keni qenë kurrë një disident, apo i persekutuar në kuptimin e vërtetë të fjalës. Të botoje veprën, tek ju; do të thosh ta botoje atë me shpenzimet e Shtetit e të pranoje të mirat materiale që të ofronte Lidhja e Shkrimitarëve. Ju nuk mund të bënit dot pa të, pasi vetëm ajo kontrollonte letrën, shtypin, rrjetin e shpërndarjes. A ju ka ndodhur të shkruani një vepër për veten tuaj duke e ditur fort mirë që nuk i përshtatej Partisë?*

**I.K.** - Marrëdhëniet e mijë me shtetin shqiptar kanë qenë gjithmonë tepër të qarta. Është tjetër punë se ka njerëz që nuk duan t'i kuptojnë ato, ose bëjnë sikur nuk i kuptojnë. Nuk ka patur asnjë lexues shqiptar, me përjashtim të budallenjeve, që të mos e dinin se një pjesë e veprës sime ishte e ndaluar ngaqë ishte gjykuar se ishte në një mënyrë ose në një tjetër kundër shtetit. Kjovepër ndërkaq ishte e rrokshme, gjithkush mund ta gjente dhe ta lexonte. Ajo përbënte kështu një makinë shqetësuese, një makinë që zgjonte dyshime, që prishte gjumin e gjithkujt. Shumë njerëz do të donin që ajo të mos eggistonte. Besnikët e regjimit për arsy që merren me mend do të ëndërronin mosegzistencën e saj. Por disa herë do ta donin këtë gjë edhe të tjerë njerëz, për të përligjur më pas frikën dhe përgjumjen e tyre. Në qoftë se nuk do të kishte asnjë zë turbullues në diktaturë, ata do ta kishin më lehtë të përligjin gjithçka. Librat e mia kishin një peshë tepër të ndjeshme në jetën shqiptare. Qëllonte që tirazhi i parë prej 30.000 kopjesh shitej brenda një ore, madje brenda

disa minutash. Në një vend prej tre milionë banorësh kjo ndjehej fort.

Përfytyroni pastaj ç'ndodhte pas ndalimit të librit. Ndalim do të thoshte kundërshtim i shtetit. Ndalimi i një libri nën diktaturë ishte një ngjarje e madhe. Prandaj askush nuk mund të thotë tani se qëndroi në gjumë nga që askush nuk i ra ziles për ta zgjuar.

Por s'ishte vetëm kjo. Sa herë që dënohej ndonjë shkrimtar me dëbim nga kryeqyteti, gjithë Shqipëria e merrte vesh. Në qoftë se ti ishe goditur, qoftë edhe në një mbledhje të fshehtë, gjithkush ishte në dijeni. Ti ecje në rrugë dhe i merrje vesh ndërkaq të gjitha ngjyrimet e qëndrimeve ndaj teje. Besnikët e regjimit, që ishin gjithash tu të shumtë, kërcëllinin dhëmbët: hëm, kur do t'ia shohin fundin këtij armiku. Neutralët të shihnin gjithë hutim. Njerëzit e tjerë, edhe pse qenë dashamirës të artit, pëshpërisnin "të ruajtë Zoti!". Kurse më rrallë dëgjoje nga errësira murmurimën: "mos e çaj kryet, s'kanë ç'të bëjnë".

Diskutimi se mundej apo nuk mundej shteti shqiptar të më dënone, ishte kthyer pothuajse në një kurresti kombëtare. Kishte njerëz që grindeshin për këtë me njëri tjetrin, të tjerë që rriheshin ose vinin baste.

Qëndrimi i Enver Hoxhës me shkrimtarët ka qenë një nga më të kujdeshshmit e më demagogët që mund të mendoheshin. Pikërisht ngaqë i kishte zili shkrimtarët, ai donte me çdo kusht të jepte përshtypjen e kundërt. Për asgjë në botë nuk donte të zgjonte qoftë edhe dyshimin më të vogël se nuk e donte letërsinë dhe shkrimtarët. Ka mundësi

që këtë obsesion e kishte sjellë me vete nga Franca. Ishte ndoshta e vetmja gjë e butë që i mbeti nga qëndrimi i tij këtu.

Është me interes nga ana psiqike të hulumtohet qëndrimi i tij për dy gjëra të skajshme siç qenë letërsia dhe shkrimtarët nga njëra anë dhe policia e fshehtë, Sigurimi, nga ana tjeter. Për letërsinë, siç thashë, ndonëse e urrente, çfaqte një përdëllim të vazhdueshëm. Për Sigurimin, ndonëse e donte si askush, i pëlqente të afishonte aty-këtu, sidomos kur gjendej midis intelektualëve, përbuzje dhe nervozizëm.

Edhe këtë, kultura shqiptare e pati, me sa duket, dhuratë nga Franca. Them "dhuratë", sepse duke venë një maskë të tillë ai, herë pas here, detyrohej t'i bënte asaj shërbim. Për të qenë të ndershëm duhet thënë se disa herë kultura shqiptare, arkeologjia, gjuhësia, studimet ilirike, dhe disa herë letërsia, përfituan nga karateri i tij i lëkundshëm, molisja e sëmurë që e kapte herë pas here, sentimentalizmi, që vinte fill pas krimtit, lotët, që nuk druante t'i derdhte para kujtdo.

Taktika e tij ishte që të mos dënonte kurrë shkrimtarët e shquar. Duke e menduar veten jo vetëm si burrin më të madh të shtetit, por edhe si intelektualin më të shquar shqiptar të të gjitha kohërave, tmerrohej nga ideja se mund t'i permendnin ndonjë emër të njobur, që e kishte goditur. Kështu shpjegohet që nuk guxoi ta dënojë asnjëherë poetin e madh të Shqipërisë, Lasgush Poradecin, i cili jetonte i mënjanuar, në botën e tij poetiko-mistike, mu midis Shqipërisë staliniste. Kështu nuk guxoi të dënojë Fan Nolin, i cili jetonte si emigrant në

SHBA, duke qenë ende peshkop i Kishës Autoqefale Shqiptare në Amerikë. Të vetmit shkrimtarë të shquar që u dënuan ishin Dhimítër Pasko dhe Petro Marko. Por kjo ndodhi fill pas vendosjes së komunizmit, më 1947 dhe, ndonëse i pari fajësohej se kishte qenë oficer në ushtrinë gjermane dhe i dyti anarkist, nuk bënë më shumë se një vit burg. Madje edhe për këtë faji iu hodh më pas jugosllavëve dhe agjentit të tyre në Shqipëri, Koçi Xoxes.

Ndërkaq, në mënyrë sistematike, dënoheshin, madje rëndë, shkrimtarë jo fort të njohur ose njerëz të afërt të shkrimtarëve. Kjo bëhej për të mbajtur gjallë terrorin.

*A.B. - Ndërkohë ju vazhdoni të përshkruani Shqipérinë përmes viteve duke përcaktuar të gjithë paletën e interpretimeve të mundshme. Është një detyrë historike, psiqike e alegorike pa harruar valëzimet e një gjuhe që shpesh preferon dukshëm parabolat që vendosen njëra mbi tjetrën si tullat. Tek "Prilli i thyer", ku ngjarjet vendosen në fillim të shekullit tonë, ju flisni për kërdinë që bën një zakon si hakmarrja, plagë e njohur edhe për vendet fqinje, si p.sh. Jugosllavia. Një traditë kaq barbare që fshatarët dhe malësorët, në kundërshtim me parimet e regjimit në fuqi, vazhdojnë ta ruajnë, a është vallë e denjë për të motivuar një komb në zhvillim e sipër? Heroi juaj në këtë roman është një shkrimtar me njohuri të holla që mund të jetonte fare mirë në Paris, Berlin apo Vjenë. Në fakt, ai ndeshet me zakonet e një epoke tjeter.*

*Për një shkrimtar tjetër, ky takim brutal i qytetërimit me një mentalitet të vjetër do të kish qenë temë e një pamfleti, madje e një kryqëzate. Kryesore për ju nuk është as të akuzosh popullin as ta justifikosh atë. Ju merrni parasysh dozën e fatalitetit në marrëdhëniet njerëzore të vendeve të Ballkanit. Nuk luftohet një fatalitet, e të arsyetosh për të, është akoma më e kotë. Me të drejtë, ju duhet të mendoni se jeta pasionale e një vendi nuk i korespondon aspak zgjedhjeve të tij politike, apo sociale. Një qëndrim i tillë është i rrallë. Mendoj se dogmatikët tuaj duhet t'ju thoshin: "Në Shqipërinë e sotme, kjo lloj praktike nuk ekziston më ose është në shuarje e sipër..." Më bën përshtypje fakti që ju nuk jeni aspak i butë kundrejt popullit shqiptar. Kjo më kish habitur edhe tek "Gjenerali i ushtrisë së vdekur": edhe atje tregoheni i vëmendshëm për të mos idealizuar një mentalitet shpesh të prapambetur e të egër.*

**I. K.** - Unë e kam shkruar "Prillin e thyer" në kohën kur Shqipëria, ashtu sikurse krejt bota komuniste kishte drejtësinë dhe kodin penal komunist nga më çnjerëzorët në botë. Përballë kësaj "drejtësie", krimet e së cilës ju i dini po aq mirë sa unë, kodi i vjetër zakonor shqiptar, ai që quhet "kanun", jo vetëm që s'duket aspak barbar, siç thatë ju, por ngjan çuditërisht demokratik.

Duhet të kesh jetuar nën diktaturën komuniste, të kesh provuar ç'do të thotë "drejtësi e frymëzuar nga lufta e klasave", të kesh dijeni për torturat, dënimet pa gjyq, shfarrosjen e familjeve të tëra për shkak të dënimit të një njeriu, për ta kuptuar

se ç'hapësirë lirie përbënte "Kanuni" i vjetër dhe me sa mall kujtohej ai prej shqiptarëve.

Nuk është e rastit që Kanuni ishte ndaluar të botohej, madje as nuk mund të përmendej veç në një kah mohues. "Prilli i thyer" është libri i parë ku për të flitet në mënyrë të paanshme.

Në qoftë se nuk do të më njihnit, juve do t'ju dukej ky qëndrimi im i butë ndaj përbindëshit si një përndezje ime romantike, tepër e njohur, ajme, në Ballkanin e sotëm, ose si një gjykim i diktuar nga rrëthanat e një jete anormale, siç ishtejeta nën diktaturë.

E pra, unë ende sot ruaj për Kodin shqiptar po atë mendim të kohës kur shkrova "Prillin e thyer".

Së pari nuk duhet njëjësuar "Kanuni" me "gjakmarrjen", që s'ishte veç një pjesë e pjesës së tij ndëshkuuese. Do të ishte njëlloj sikur një epokë ose një shtet të gjykohej kryesisht nga kodi i tij penal.

Së dyti, s'mund të gjykohet kodi zakonor kryesor i krejt gadishullit ballkanik vetëm nga kufizimet dhe pjesa e tij e verbër. Kur flasim për demokracinë e vjetër greke, ne e dimë se ajo pranonte skllavërinë, por kjo s'na pengon ta admirojmë atë.

Por edhe pjesa ë ashpër e Kodit, "gjakmarrja" nuk është ashtu siç mund të duket. Parimi bazë i saj është "barazia e gjakut", domethënë barazia e njerëzve. Gjaku s'humb kurrë. Gjaku paguhet. Çdo gjak vlen njëlloj, i të lartit e i të ulëtit, i princit dhe i robit. Po vrave, do të vritesh. Do të kërkosh aq gjak sa ke humbur. Po kapërceve

të drejtën tënde, do të ndëshkohesh.

E gjithë kjo mund të merret si një makinë, që prodhon vdekje, si një arsyе për t'u vetëshkattëruar. Por po aq mund të merret si një kufizim i vdekjes.

Rregullat tragjiko-groteske të gjakmarrjes përjashtonin dy gjëra: masakrën dhe çnderimin. Vetë vrasja kanunore ishte si një pjesë teatri, si e lojtur në skenë, në sytë e gjithë katundit. Si e tillë ajo artificializohej, shkëputej nga pasionet, pra zbrazej nga verbëria. Për të mos u zgjatur, për ta bërë të rrokshme atë që iu thashë më lart: po ju kujtoj vetëm një hollësi, që e kam përshkruar te "Prilli i thyer", atë kur vrasësi ishte i detyruar të merrte pjesë në drekën e mortit në familjen e viktimës. E merrni me mend se ç'provë ishte për të gjithë kjo gjë. Për nënën dhe motrat e të vrarit, që duhej t'i shërbenin në tryezë vrasësit. Për vrasësin vetë që buka duhej t'i mbetej në fyt. Për krejt gjindjen që përgjonte skenën. Ajo ishte një provë dhe njëkohësisht një shkollë për të mposhtur pasionet e egra, vetveten.

Para se të kthehem te krahasimi me "drejtësinë komuniste" do t'ju kujtoj se pjesa ndëshkimore e kanunit shqiptar, përveç vrasjes kishte edhe nyje (rregulla) të tjera gati të pabesueshme. Kështu në kod ju mund të gjeni radhën e ndëshkimeve që jepte shefi i familjes: heqja e të drejtës së armëmbajtjes për një javë. Për dy javë. Burgimi një javë, dy ose katër, që ishte dënim i madh. Ishte pa dyshim groteske që në shtëpitë shqiptare kishte një burg, që në gjuhën shqipe fjala "qilar" është e njëjtë me fjalën "burg", që babai mund

ta burgoste të birin. Mirëpo për familjet shqiptare, dhe jo vetëm shqiptare, por të krejt Lindjes së pafundme, ky lloj burgimi i krahasuar me burgimin shtetëror, me arrestimet në mesnatë, me torturat, hetimet, ankthin, zhdukjet pa gjurmë në kampet e punës së detyrueshme, ishte si një ëndërr.

Është e kuptueshme përsë komunistët nuk donin t'ia dëgjonin as emrin Kanunit. Është kjo arsyje që për romanin tim "Prilli i thyer" nuk u shkrua asnje rresht në shtypin shqiptar.

Krahasimi që bëra pak më lart me kodin komunist, nuk është një ide e sotme, siç janë shpesh herë, për fat të keq, mjaft kurajo të vonuara. Më 1989, kur Shqipëria ishte ende diktaturë klasike, në një shkrim për romanin "Thikat" ku denoncoheshin për herë të parë haptaz krimet e policisë së fshehtë në Shqipëri, e vura në varësi krahasimi Kanunin e moçëm me shkeljen e të drejtave të njeriut në jetën bashkëkohore, duke thënë qartë se Kodi i vjetër, sado primitiv të dukej, ishte më demokratik se praktikat ligjore bashkëkohore.

Lidhur me mendimin tuaj se unë jam i butë me popullin shqiptar, desha të them se ka një traditë vetëkritikuese në kulturën shqiptare. Shkrimtarë të mëdhenj si Konica e Migjeni kanë kritikuar rëndë cenet e kombit të tyre, që përgjithësisht janë pjesë e ceneve të krejt ballkanasve. Unë kam patur dhe kam një mendim të pandryshuar për ballkanasit. Ka një prirje për të qëmtuar tek ata vetëm mungesat. Mendoj se krahas ceneve dhe marrëzisë, që pa dyshim ata i kanë me tepëri, kanë gjithashtu virtyte, që gjenden përherë e më rrallë në shumë pjesë të botës, duke përfshirë

këtu edhe Evropën përbuzëse.

Lidhur me qëndrimin tim ndaj kombit tim, unë as impresionohem e as ndikohem nga kurrkush. Unë jam kundër atyre shkrimtarëve të vendeve ish-komuniste që, për t'u bërë interesantë përparrë jush, (nuk e kam fjalën për ju personalisht, por për rrethet intelektuale këtu), me fjalë të tjera, për të shtuar gjallërinë e pasdarkës, midisëmbëlsirës dhe kafesë, marrin nëpër gojë mbarë e mbrapshët kombet e tyre. Në qoftë se për të hequr dyshimin se je nationalist, duhet të kalosh nëpër një mjerim të tillë, unë do ta parapëlqejë me shumë gëzim cilësimin nationalist.

Kur në shtëpinë tuaj, ku qysh prej vitit 1971 më ka rënë rasti të takoj me dhjetëra shkrimtarë francezë e të huaj, ju, ose të ftuarit e tjerë keni vënë re se unë as e mburrja as e përgojoja vendin tim, me siguri keni menduar se e bëja këtë gjë nga droja se shteti komunist mund ta merrte vesh. Më vonë, kur regjimi u përmbyss dhe ju keni vënë re se qëndrimi im, pavarësisht ngas liria ime tashmë, ka qenë i njëllojtë, ndoshta keni menduar se unë jam një nationalist i fshehur.

"Kur vjen çështja për kombin e vet Kadareja është po aq i verbër sa Homeri". Ky ishte titulli i një shkrimi për romanin tim "Dosja H.", botuar në një revistë franceze nga një kritik, që nuk ia mbaj mend emrin.

Ishte shqetësues për mua ky shkrim sepse ishte i sinqertë. Ndihej që kritikut, i cili ishte tepër admirativ për veprën, i vinte vërtet keq për cenin e nacionalizmit.

Ju e keni lexuar këtë libër dhe besoj se

jeni i një mendjeje me mua se kurrfarë nacionalizmi nuk ka aty, përkundrazi, ka tallje të hidhur me nacionalizmin, si sëmundje ballkanase. Ashtu siç ka tallje të hidhur në romanin tjetër "Viti i mbrapshtë", i cili mund të ketë si nëntitull "një koleksion i marrëzisë shqiptare".

Kemi të bëjmë këtu me një keqkuptim vërtet dramatik. Mendoj se jeni në një mendje me mua se nacionalizëm nuk është kur e do fort popullin tënd, por kur nuk i do e nuk i duron dot popujt e tjera. Kritiku i mësipërm nacionalizmin e gjente në ato pjesë të romanit ku ndërsa flitej për çështjen homerike, përmendej kryesisht prej personazheve se shqiptarët janë po aq të moçmë në gadishull sa edhe grekët e vjetër, se sllavët kanë zbritur në këtë zonë në shekujt VII-IX, se ka një epos të moçmë shqiptar, se gjuha shqipe, ashtu si vetë shqiptarët është pasardhëse e ilirishtes.

Që këto pohime ta bëjnë nervoz një gazetar serb për arsyen që dihen: për serbët kjo ka lidhje me çështjen e Kosovës kryesisht me mitin qesharak se serbët janë autoktonë në Kosovë etj., kjo është e kuptueshme Por që ta bëjnë nervoz një gazetar francez, kjo është vërtet e habitshme.

Atëherë ç'duhet bërë sipas këtyre lloj gazetarëve? Ta modifikojnë shqiptarët historinë e tyre, me fjalë të tjera ta bëjnë të pëlqyeshme, komode, të parrezikshme për qetësinë e Evropës? Të mos thonë se janë rrënjos(autoktonë) në trojet e tyre meqenëse kjo gjë i nervozon serbët? E meqenëse kanë ardhur këta një mijë vjet më pas se shqiptarët iu duket permendja e këtij fakti si fyterje, madje si provokacion? E kjo mund t'i prishë

qetësinë disa ministrave që merren me fatin e Evropës, e pa dyshim Lordit Owen, që rreh të pajtojë grindarët, madje edhe Butro Butros Ghalit, atje larg në New-Jork?

Atëhere ç'të bëjnë shqiptarët? Të mos e përmenden më Ilirinë, meqenëse edhe emri i saj zgjon djajtë. Të mos e përmenden as prejardhjen e gjuhës së tyre prej ilirishtes, meqenëse kjo mund të rriti trysninë në Ballkan? Mirëpo për fatin e tyre, s'janë ata që e kanë ngritur këtë tezë "nacionaliste" por Aristoteli i Evropës, gjenui gjerman Sigfried Leibnitz, në një raport drejtuar Akademisë gjermane më 1695 dhe në një raport të dytë më 1705, i ndjekur pastaj nga dhjetëra gjuhëtarë të mëdhenj nga gjithë bota. E, në qoftë se unë do të kisha guximin e çmendur t'ju sillja këtu revistat serioze të gjuhësisë së sotme, (botime të vitit 1993 ose 1994), ku gjuha shqipe radhitet prej shkencëtarëve amerikanë ose gjermanë ndër pesë ose gjashtë ndër gjuhët kryesore të Evropës dhe ndër dhjetë ose dymbëdhjetë gjuhët kryesore të botës, ju mund të më merrni për një terrorist, për një zjarrvënës të Evropës. Dhe keni të drejtë sepse ka kohë që është bërë zakon që këtij kombi, kombit shqiptar, çdo gjë t'i jepet me kopracinë më të madhe. Është bërë zakon që ky vend të harrohet, të mos i përmendet emri, madje as në hartën meteorologjike të Evropës. Më parë kjo harresë përligjej nga vetizolimi komunist, por tani nga se përligjet?

Atëhere unë po vazhdoj me pyetjen: ç'të bëjnë shqiptarët? Të mos thonë asgjékund se së paku, dy prej qyteteve të tyre kryesorë Durrësi

dhe Shkodra kanë gati të njëjtën moshë sa Roma? Të pohojnë madje të kundërtën, se nuk kanë qytete, veç ca fshatra, madje as fshatra, por ca si gropë, ashtu siç del në shumicën e reportazheve televizive që jepen në Perëndim?

Ju e dini ç'ndodh sot në Ballkan dhe ç'krime dhe ç'tmerre po bëhen nën psikozën nacionaliste. Në këtë ciklon ndonëse shqiptarët janë treguar më të përmbajturit, shpesh qëllon që pikërisht ata fajësohen për nationalistë. Histerisë serbe iu shtua kohët e fundit ajo greke. Ju e dini se ç'admirim kam unë për kulturën greke dhe si e kam dëshmuar këtë admirim në krejt veprën time. Asnjëherë, askush në Shqipëri, as më parë, as tani, nuk më ka bërë qortimin më të vogël për këtë admirim. Atëherë po ju them një gjë" në qoftë se një shkrimtar grek i sotëm do të guxonë të shprehte një admirim të tillë ndaj shqiptarëve të jeni të sigurtë se do të linçohej. Është e mjaftueshme për të kuptuar ndryshimin e psikozave në të dy vendet.

U zgjata në këtë pikë sepse është diçka që lidhet me krejt veprën time. Qëndrimi im ndaj kombit që i përkas diktohet nga një e vërtetë e thjeshtë dhe e palujtshme: Shqipëria ka qenë dhe mbetet një vend tragjik dhe i vetmuar. Një shekull e gjysmë më parë, si hapësirë dhe si popullsi ajo ka qenë po aq sa Greqia e Serbia e ndoshta pesë-gjashtë herë më e madhe se Mali i zi. Sot, ndërsa shtetet e mësipërme janë fryrë dhe janë zmadhuar, e vetmja Shqipëria është tkurrur e është bërë më pak se gjysma e asaj që ka qenë. Fqinjët e saj, në vend që të kenë një ndjenjë faji, sepse përveç që janë zmadhuar në dëm të

saj, kanë kërkuar disa herë haptaz ndarjen e Shqipërisë midis tyre, me fjalë të tjera, prishjen e Shqipërisë dhe zhdukjen nga faqe e dheut të kombit shqiptar, vazhdojnë të kenë të njëjtin qëndrim të egër.

Ky është thelbi i çështjes. Dhe ky thelb dikton qëndrimin tim si njeri dhe si shkrimtar. Unë nuk mund të pranoj kurrë të bëhem më interesant e më i pëlqyeshëm në dëm të tij. Përkundrazi, pranoj më mirë të dëmtohem prej tij, domethënë të dëmtohem prej kombësisë sime, çka shpesh ka ndodhur.

E meqenëse kjo është një bisedë në radhë të parë, për letërsinë, desha të shtoj se në planin profesional ky është populli që ka krijuar e vazhdon të mbajë gjallë shqipen, një nga mekanizmat gjuhësore më të pasura e të përkryera të kësaj bote. Vepra ime është krijuar në këtë vegje dhe një droje ime për të mos e përmendur këtë, do të ishte më shumë se paburrëri.

*A.B. - Ju e vazhdoni anketën tuaj të gjatë e të hollësishme për Shqipërinë e së kaluarës me "Kamaren e turpit". Këtë herë ndodhemi në Evropën e një shekulli më parë, pothuajse tamam në kohën e ngjarjeve të Prillit të thyer. Perandoria osmane, e cila nuk mund të kërcënojë më Vjenën, siç bëri për katër dekada, në njëfare mënyre u pajtua me mbikqyrjen e Evropës Juglindore dhe Lindjes së Mesme, të vrojtuara nga Perandoria austriake, ruse e së largu nga dy fuqitë kolonizuese, Franca e Britania e Madhe. Thuhej se aty mbretëronte*

*një tirani e kalitur prej korruptionit. Pushtimi turk, mejithëse i rëndë, është më pak gjakatar se të tjerët. Për sa i përket Shqipërisë, më shumë së një provincë e aneksuar ajo është një krahinë që gjëzon njëfarë autonomie administrative: do të thoshim pa vështirësi, është një protektorat. Në këtë kohë ekzistojnë edhe shembuj të tjerë: Polonia e ndarë, por shpirtërisht e pacënuar, Finlanda dhe shumë shpejt vendet e Kaukazit. Me intervalle të rregullt, Turqia lejon funksionarë të lartë të ardhur nga Shqipëria t'i shërbejnë Perandorisë. Megjithatë nuk duhej që vendasit të revoltoheshin: përndryshe ndëshkoheshin rëndë. Ashtu si tek Kështjella ju i kushtonit rëndësi pasojave të një revolte shqiptare. Represioni është i përgjakshëm: për autoritetet ai shërben si mësim. Ai që revoltohet tërheq drejt vetes popullsinë që donte të shpëtonte. Ky është ligji. Më vonë kjo do të bëhet një praktikë e njohur për gjermanët: për çdo pushtues të vrarë varesin ose pushkatoheshin në sheshin publik 50 apo 100 pengje. Tragjedia është e paevitueshme. Patriotizmi paguhet shtrenjt: a mund të hiqet dorë prej tij? Mendja më shkon tek tragjedia greke. Për këtë, do të doja të dija nëse kjo ndjenjë e fatit të pandreqshëm të njeriut është tek ju e bashkëlindur si trashëgimi - njëherazi e çmuar dhe peshérëndë - e kohëve të Eskilit dhe Sofokliut: një lloj karakteristike e rajonit aq e ngulitur nga kultura greke; ose është kultura juaj d.m.th. njohja juaj e letërsisë helenistike që nuk ju lë të harroni shembuj tashmë të largët prej 25 shekujve. Tragjedia greke gjithmonë ka mbetur e pranishme në zakonet e doket tuaja ose*

*më mirë asnjëherë nuk është fshirë nga kujtesa juaj? E di se për këtë do të përgjigjeni disa vjet më vonë të paktën në dy prej librave tuaj: "Dosja H" dhe "Eskili ky humbës i madh..."*

I.K. - "Kamarja e turpit" është roman për terrorin shtetëror. Kamarja vetë, domethënë vendi ku vëndoseshin kokat e prera, ka qenë në shtetin otoman njëlloj si zyra e propagandës, si ekranë i TV. në shtetin totalitar komunist. Me anë të këtij ekranë shteti modern, më fuqishëm se çdo tjetër shtet, rrezatonte kudo frikën, kërcënimin dhe tmerrin. Thirrjet për syçeltësi, luftë klasash, për disiplinë, forcim radhësh dhe sidomos paralajmërim për këdo që mund të guxonë të prekte shtetin, kryhej nga kjo kamare e moçme, pavarësisht se ç'trajtë merrte ajo: tribunë gjyqësore, shpallje pas ndonjë plenumi, kryeartikull i gazetës së partisë, fjalim i diktatorit apo zvarrisje rrugëve e trupave të njerëzve të vrarë në kufi, për të lemeritur të gjithë ata që kishin ndërmend të arratiseshin.

Sa për atë ndjesi fataliteti që përmendni ju, ajo s'ka të bëjë aspak me ndonjë ndikim të kulturës helenistike. Psikoza e fatalitetit gjendet në rrënjet e mendësisë së moçme shqiptare. Në librin që kam shkruar për Eskilin kam hedhur mendimin se disa nyje të errëta në dramat antike greke siç është rasti i moszhdukjes së pëlburës së përgjakur me ndihmën e së cilës e shoqja e vrah Agamemnonin, mund të shpjegohen me doket e vjetra shqiptare.

Dua të theksoj këtu se këto ngjashmëri

ndeshen, për çudi, jo në jugun e Shqipërisë, që bën kufi me Greqinë, por në alpet veriore, atje ku malësorët katolikë s'kanë kurrfarë ideje se ç'është Greqia, madje janë të sigurtë se ndodhen më afër Gjermanisë e Greqisë.

Shumë vite më parë, kur duke qenë gazetar kam shkuar në Shqipërinë veriore për të shkruar një reportash për studentët që punonin në hapjen e një rruge malore, më ka mbetur ndër mend një shkëmb i thepisur në faqen e të cilit ishte shkruar me shkronja gjigande fjala frëngje "FATALITÉ".

Sapo kishte dalë në kinematë e vendit filmi "Shën Mëria e Parisit" sipas romanit të Viktor Hygoit dhe kuptohej menjëherë që shkruesi i fjalës frëngje mbi shkëmb ishte frymëzuar nga epilogu i filmit. Ndërkaq, midis të qeshurave të studentëve, merrej me mend hutimi i militantëve komunistë, për të cilët kjo fjalë ishte krejtësisht e huaj, si e ardhur nga botëra të tjera, midis fjalëve e parrullave gjëzimplotë komuniste.

Ndërkaq siç ndodh shpesh, kur ajo që fshihet është më e pranueshme se gjithçka tjetër, fataliteti ishte i pranishëm më fort se kurrë në jetën e përditishme, jo vetëm në Shqipëri, por në krejt botën komuniste. Madje mund të thuhet se ndjenja e fatalitetit është një nga armët më të suksesshme të shtetit totalitar..

Kemi folur disa herë bashkë se si komunizmi më shumë se çdo rend tjetër shoqëror rimori nga antikiteti mitet më të përgjakshëm. Në një trajtesë (ese) për legjendat kam zbuluar, ose kujtoj se kam zbuluar (në qoftë se dikush tjetër e ka zbuluar para meje), se nga novitetet më gjeniale, që kanë

mundur të bëjnë komunistët është pikërisht rinvimi i sistemit ndëshkimor. Përdora fjalën "rinovim" për diçka që meritonte më fort të quhej "rivjetërim". Me fjalë të tjera, gjetja gjeniale e komunistëve ishte një rikthim i skëterrës në jetën bashkëkohore. Këtu nuk është fjala për një metaforë, por për një skëterrë të njëmendët, ashtu siç përfytyrohej prej të vjetërve e që ndodhej nën botën tonë.

Ishte e natyrshme që pasi pushtuan tokën (shtetin) dhe qielin (botën shpirtërore), komunistët do të donin të sundonin nëntokën pra, ferrin. Në pamje të parë mund të duket se ferri janë burgjet kampet e punës etj. Dhe në një farë mënyre ashtu është. Por ndërkaq duhet pranuar se ndikimi i ferrit të dikurshëm mbi jetën njerëzore kishte qenë shumë më i madh se i çdo sistemi ndëshkimor të kohës sonë. Dhe komunistët donin të bënin pikërisht këtë gjë: të kthenin ferrin e dikurshëm.

Ashtu si arkitektët që gjejnë ca bodrumë të vjetra për t'i vënë në përdorim për punë të sotme, ashtu dhe komunistët menduan që në bodrumet e burgjeve dhe barakat e kampeve të vendosnin makinerinë e stërvjetër e të tmerrshme të ferrit. Më fjalë të tjera, sistemin tradicional të ndëshkimit ta kthenin në një organizëm të gjallë, që të vepronë jo vetëm gjatë hetimit dhe procesit gjyqësor, por gjithmonë, ditë e natë, si skëterra dikur.

Pak më parë përmenda pëlhirën e përgjakur të Agamemnonit, me anë të së cilës Klitemnestra hetonte gjendjen shpirtërore të të vdekurit. Thelbi i ferrit qëndronte pikërisht te kumtet që dërgonin të vdekurit që matanë. Ato kumte lozni një rol të jashtëzakonshëm në jetën e të gjallëve. Ato

trazonin ndërgjegjen, i linin njerëzit pa gjumë, i shtynin në veprime të papritura.

Komunistët arritën që burgjet dhe kampet, nga vende ndëshkimi tradicionale t'i kthenin në një makinë të vërtetë ferri. Në burgjet komuniste asgjë nuk ishte e mbyllur. Atje vazhdonte gjithçka: hetimi, ridëni, spiunimi. Të burgosurit e Lindjes u kthyen vërtet në të vdekur që në çdo kohë, madje atëherë kur nuk e prisje, mund të dërgonin kumte që matanë. Ti mund të rrije i qetë me miqtë në darkën e ditëlindjes, por aty pas mesnate biseda mekej papritur, sytë hutoheshin, fytyrat ngrinin. Ishte ora e hetimit. Dhe meqenëse rrallë kishte njerëz që nuk kishin ndonjë të afërm në burg, mendimi se i burgosuri (i vdekuri), ndonëse i dënuar qyshkur, rithirrej në hetim për të folur për ty, të mpinte krejt...

*A.B. - Shtetrrethimi si simbol i jetës në të gjitha epokat dhe luftimi i ashpër si një ushqim për Historinë nuk ju ndahen kurrë. Sido që të jetë, atdheu na është i shtrenjtë, e në të kundërt do të na mungonte diçka esenciale. Një vend duhet ose të përmirësohet ose të tregohet i denjë për të kaluarën e tij, ose të mbrohet ose të pësojë metamorfoza të rënda: nëse në shekullin e XX gjendja nuk paraqitet e tillë, do të thotë se ai po shkon drejt dekadencës apo dobësimit.*

*Ju i keni jetuar gjatë gjithë kohës ndryshimet në Shqipëri. Megjithatë, një evolucion i çuditshëm vihet re në veprën tuaj me botimin- tek ne në vitin 1973 -të romanit "Kronikë në gur". Për këtë,*

*mjafton tē shohësh ilustrimin e kopertinës së librit: ajo paraqet një lagje tē Amalfit në Itali që ngrihet buzë detit, e vizatuar nga Eduard Lear, një udhëtar e poet anglez i epokës romantike, i lënë pak në harresë, autor i "Libër absurditetesh", botuar më 1846 dhe shumë i vlerësuar nga Oscar Wilde. Papritur ju ndërroni dekor e me imagjinatën tuaj largoheni nga brigjet e Adriatikut. Jo pse dekori, personazhet e rrethanat e jashtme ndërrojnë por do tē thoshim se ndodheni mendërisht në një Iliri jashtë realitetit dhe vetëm imaginata udhëheq tregimin. Ju distancoheni duke folur psikologjikisht e mendërisht. Juve ju pushton një farë somnambulizmi, ndërkohë që nuk e humbisni as përpikmérinë dhe as saktësinë tuaj. Kalojnë qenie njerëzore, që mund tē merreshin përfantazma-Bestytnitë kanë bërë përvete tē dy palët: ju përktheni njëkohësisht një Mesjetë shpirtrash dhe nevojën për t'i dhënë prozës romaneske një dimension lirik, ëndrrimtar, ireal në mënyrë që realja tē shuhet pak nga pak. Është koha e fëmijërisë, e fabulave, e pushtimit italian. Pra, fantazmagoria ka tē drejta tē cilat tregimi romanesk nuk i pranon...*

**I.K.** - Lidhur me pjesën e parë tē pyetjes suaj do t'ju bëj një rrëfim që nuk e kam bërë kurrë deri më sot. Arsyen përsë nuk e kam bërë nuk e di saktësisht as vetë. Kjo hyn ndoshta në ato gjëra që, duke qenë në tē njëjtën kohë tē shenjta, tē fshehta e tē tmerrshme, njerëzit iu shmanget. Me fjalë tē tjera, parapëlqejnë tē mos i përmendin kurrë, thua se kështu parandalojnë një fatkeqësi.

Thelbi i rrëfimit është ky: që prej shumë vjetësh, ndoshta qysh prej moshës së rinisë së hershme më ka munduar një frikë e çuditshme: mundësia e prishjes, e zhbërjes së vendit tim, Shqipërisë. As vetë nuk e di se si zuri vend te unë kjo ndjesi. Fraza të dëgjuara rastësisht në fëmijërinë time, ndonjë copë këngë e vjetër, një frymë ankthi që vinte nga librat e shkrimtarëve shqiptarë të shekullit XIX e kanë shkaktuar, me sa duket, këtë gjë. Kur isha i vogël dhe në dhomën e madhe të shtëpisë sonë i vija veshin bisedës së gjyshes sime me shoqet e saj, më tërhiqte sidomos mënyra se si ato i formulonin mendimet e tyre.

Kështu qysh në fëmijëri më ka tërhequr e, natyrisht, trembur mënyra se si gjyshja ime me shoqet e saj jepnin gjykime mbi botën dhe mbi ngjarjet. Ja, u prish dhe Greqia... U prishën çamët.. Të shohim kujt i vjen radha. Ato flisnin për prishjen e shteteve e të mbretërive njëlloj si për çthurjen e një bluze, leshi i së cilës iu duhej për tjetër gjë. Ka mundësi pra që pandehmën e parë për prishjen e Shqipërisë ta kem dëgjuar prej tyre. Ajo është shtresuar me sa duket, në ndërgjegjen time në formë mitike, përrallore, gjersa shumë vite më pas, kur unë, si gjithë shqiptarët, u ndodha dëshmitar i fortunave politike nëpër të cilat kalonte vendi im, ky ankth parak (primitiv) u ringjall për t'u bërë zotërues në ndërgjegjen time. Loja e fatit me Shqipërinë, rastësitë ngjethëse që diktuan kufijtë e saj, etja e fqinjëve për ta ndarë midis tyre, veprimet e tyre ushtarake e diplomatike për të njëmendësuar këtë gjë. Copërat që i shkëputën vërtet nga trupi i saj, me një fjalë, ajo gjëndje

në zgrip e vendit që i përkisja, ma krijoj, me sa dukej, këtë ankth.

Si shkrimtar, si murg i gjuhës shqipe, gjuhë në të cilën ishte krijuar vepra ime dhe e cila do të farohej gjithashtu në rast prishjeje të kombit tim, unë duhej të isha vetvetiu një pengues i kësaj gjëme. Ky ishte misioni im i parë. Të tjerat rridhnin prej tij. Ju mund ta quani këtë patriotizëm, nacionalizëm etj., dhe unë do ta pranoj çdo cilësim. Gjithë vepra ime është krijuar nën këtë makth.

Lidhur me një fryshtë e ndërre e fantazmagorie që ju gjeni në veprën time, kjo duhet të jetë ose dhuratë e disa rrethanave me fat në jetën time, ose thjesht lidhet me profesionin, ose është një gërshtetim i të dyjave.

Rrethana me fat unë quaj ato të fëmijërisë sime, duke filluar nga shtëpia e madhe ku banonim, një pjesë e së cilës ishte e zbrazët dhe që unë, si çdo fëmijë do ta mbushja me fantazinë time, e gjer te vetë qyteti, që në mendjen time e quaja të marrë, në kuptimin më të mirë të fjalës. Ishte marrëzia e tij ndoshta që më mbrojti nga ndikimi komunist në vitet e shkollës. Mendoni për shembull që në vitet fill pas çlirimt, jo larg nesh banonte një farefisi ynë i largët, që donte të shpikte aeroplanin pa benzinë. Kisha qenë me gjyshen në shtëpinë e tij, kisha parë skicat, maketet prej druri, letrat që thuhej se i vinin nga Akademia e Austrisë, atë vetë, që rrinte i heshtur ndërsa gjindja rreth tij bisedonin. Juve mund t'ju duket kjo gjë e thjeshtë, por në një vend diktatorial komunist një marrëzi e tillë ishte mbrojtëse. Shtoini këtij shpikësi emtat e tim eti, njérën prej të cilave e kam

përshkruar në "Kronikë në gur", zyrtarët e rrëzuar perandorakë, vetë arkitekturën delirante të qytetit dhe, sekretari i partisë së shkollës, që iu fliste për dobinë e socializmit, do t'ju dukej i zbehtë e qesharak. Ishte kjo frymë somnambuleske, siç e quani ju, e cila bënte që mua të më dukej se Plaku i Vtit të Ri, im gjysh nga nëna dhe Leon Tolstoi të ishin i njëjtë njeri dhe së bashku e kishin shkruar romanin e mërzitshëm Ana Karenina!

Më pas e gjithë kjo i erdhi për shtat profesionit tim. Në fund të fundit, një nga fatet e shkrimtarit është që duke qenë i mënçur të mos e humbasë thesarin e mrekullueshëm: marrëzinë.

Komunizmi kishte frikë nga një marrëzi e tillë, që fqinjëronte me lirinë. Ndaj ai e shtypte atë njëlloj si shtypte misterin, besimin, kujtimin e vdekjes. Më kujtohet kur isha student në Moskë, befas një ditë u kujtova se nuk kisha parë askund asnjëherë një procesion varrimi. E pyeta një shoqen time: a vdesin njerëzit këtu? Biseduam gjatë për këtë dhe turbull e kuptuam për herë të parë se komunizmi nuk e duronte dot përmendjen e vdekjes. Ajo ishte sfiduese. Ajo ishte tallëse.

Përpara se letërsia sovjetike të zvetënohej në atë shkallë që u zvetënuar, ajo humbi mjegullën mbrojtëse: misterin, botën e përtejme, ëndrrën, vetë vdekjen.

Kur për herë të parë nisa të lexoj romanin "Nëna" të Gorkit u lemerita nga thatësira dhe ndriçimi i zhveshur i tij. Ditë të tëra nuk më ikte neveria. Dhe, me sa dukej, qysh në atë kohë, (duhej të isha 14 ose 15 vjeç) thellë vetes sime kisha bërë një zgjedhje: unë do të isha gjithmonë

në anën tjetër të ledhit, me mjegullat gjermanike dhe hijet e Shekspirit, kundër kësaj drite shterpë.

**A.B.** - Duke ndjekur karrierën tuaj, nga libri në libër i afrohemis epokës së Gorbaçovit e Reganit, që do të revolucionarizonin fund e krye situatën politike në Evropë. Diktatura e Hoxhës merr fund: tabutë shemben një e nga një. Tek "Viti i mbrapshtë" botuar këtu më 1987, ju nuk heziton të skiconi pamjen e Shqipërisë në prag të Luftës së Parë Botërore. Nuk është aspak një pamje e zbukuruar: përçarje, luftë ndërmjet etnive rivale, ndjenja konfuze për një liri që nuk dihet si duhet përdorur, atentate, kurthe, banda të armatosura: një puzzle i vërtetë ballkanik. Është e para herë që ju flisni për një epokë të cilën regjimi komunist u përpoq ta fshijë nga kujtesa e shtetasve. Mund të pranohen, shumë shumë, imazhet e një Mesjete tashmë mitike dhe jo materiale; por është tjetër gjë të ringjallesh një epokë akoma të afërt kur sipas të moshuarve, jetohej më mirë se nën regjin komunist e për të cilën, me ose pa të drejtë, ata ndjejnë ndoshta një lloj nostalgie. Princi gjerman Wied po ngjitej në froni e Shqipërisë, por në çastin e fundit, heq dorë. Më vonë, pas një intervali prej 15 vjetësh, vjen në fuqi mbreti Zog. Për shumë kohë, për autoritetet shqiptare këto dy figura ishin dordoleë, siç që Leon Trotsky gjatë epokës staliniane në Bashkimin Sovjetik; ato sheshit dhe pa siklet u nxorrën jashtë Historisë. Kapja e këtij momenti, është një guxim i veçantë nga ana juaj apo rishfaqja e këtyre figurave

*ishte atëhere në radhën e gjërave?*

*Gjatë viteve 70 e 80 kam pasur rast të takohem me ambasadorët e vendit tuaj në Paris. Interesoheshha për personazhin enigmatik të princ Vudit (Wied) pasi, kur isha i ri, isha filatelist e Shqipëria e pavarur kish përgatitur pulla për hipjen e tij në fron, në fakt e dështuar. I pyesja këta të ashtuquajtur diplomatë se ç'u bë princ Vidi (Wied). Asnjeri nuk desh të më përgjigjej e bile disa thoshin se nuk e kishin dëgjuar këtë emër. E njëjta e keqe më ndodhi me Geraldinën, gruan e mbretit Zog të cilën e kisha takuar rrëth viteve 50 në Gjenevë; në atë kohë ish një grua mjaft e bukur dhe e hijshme. Edhe kur pyesja për të bënин sikur habiteshin ...*

*Në thelb, në "Vitin e mbapshtë", pavarësisht nga të gjithë elementet e luftës civile, ju i ribashkoni më në fund historisë së vendit tuaj një epokë që prej kohësh ishte eliminuar. S'keni pse të fajsoheni për këtë. Vini re, s'ka këtu asgjë të turpshme: edhe demokracitë dinë ta fshijnë atë që nuk ju vjen për shtat. Kur isha në bankat e shkollës, nuk dija asgjë për Komunën, as për rebelimet në gjirin e ushtrisë më 1917. Edhe sot e kësaj dite francezët nuk kanë dijeni mbi tmerret e spastrimeve në vitet 1944-1945...*

**I.K. - Fshirja e historisë është dukuri botërore.**  
Komunistët ishin që e çuan në paroksizmin e saj, ndaj dhe nganjëherë ngjan si shpikje e tyre. Për të mos përmendur ç'mund të ketë ndodhur me Egjiptin faraonik apo Assyro-babilonasit, ku gjëja e parë që bënte çdo tiran i ri që vinte në

pushtet ishte të shembte shtatoret e tjetrit, unë do t'ju kujtoja diçka të mëvonshme dhe pikërisht fillimin e famshëm të fjalimit të Ciceronit kundër Katilinës në Senatin rromak: "Qousque tandem abutere Catilina patentia nostram?" Jam i bindur se jo vetëm ne studentët në orën e latinishtes, por përgjithësisht gjithë lexuesit në botë, që kanë disa njohuri për perandorinë romake ruajnë mendimin se në këtë ndeshje gojore Ciceron-Catilina, personazhi negativ, komplotisti, tradhtari, juda, është pa dyshim Catilina. Kurse Ciceroni e kundërtat. Propaganda zyrtare romake ka qenë aq e fortë saqë ende sot, pas dy mijë vjetësh, ajo nuk ka lejuar asnje qortim të historisë lidhur me Catilinën.

Të them të drejtën, ende sot unë nuk kam ndonjë dijeni të saktë se si mund të ketë qenë kjo punë. Kam dyshuar për herë të parë për dosjen Catilina, kur shumë vite më parë, në një kronikë romake lexova për vdekjen e tij, ose më saktë, të dashnores së tij, e cila u vra bashkë me të në luftë kundër ushtrisë së senatit. Në mendjen time lindi aty për aty një kundërshtim: ishte e mundur që një burrë të vritej heroikisht së bashku me të dashurën kundër një ushtrie ndëshkuese qeveritare, të ishte aq tinzar e i zi, siç përshkruhej prej Ciceronit?

Ndonëse fjalimi i tij më kishte rrëzuar dy herë në provimin e latinishtes, kisha simpati për Ciceronin. Aq më tepër që ai kishte patur shtëpinë e vet të pushimit në Durrës, çka për ne, shqiptarët e veçuar e të harruar nga bota, merrej si një shenjë vëmendjeje.

Dyshimi im kishte patur pa dyshim një

arsye tepër naive (pak banditë ishin vrarë bashkë me dashnoret?), megjithatë, meqenëse në këtë botë shumica e dyshimeve kështu lindnin, pa ndonjë qartësi, ai mbeti i strukturës mendjen time gjerditën kur te Brehti, më duket në romanin e tij "Bisneset e zotit Jul Qezar" ndesha pak a shumë të njëjtën pikëpyetje.

Që të kthehem te pyetja juaj. Rrëzimi i personazheve historikë prej komunistëve shqiptarë kishte një qëllim tepër të dukshëm e vulgar: duhej përgatitur trualli, (domethënë duhej pastruar trualli), në mënyrë që ditën e vdekjes së diktatorit Hoxha, ai të shpalley si "njeriu më i madh që kishte lindur kombi shqiptar gjatë historisë së tij". Kjo ndodhi vërtet më 11 prill 1985, ditën e vdekjes, kur ai u shpall si i tillë. Mirëpo nuk e gëzoi këtë cilësim veçse pak kohë, sepse qysh të nesërmen e rrëzimit të diktaturës komuniste u quajt "njeriu më i zi që kishte njohur kombi shqiptar".

Më 1944, fill pas hyrjes në Tiranë, gjëja e parë që bënë komunistët ishte të hidhnin në erë varrin e Nënës mbretëreshë, domethënë nënës së mbretit Zog. Për një lojë të fatit, diktatori komunist u varros jo larg vendit ku kishte qenë varri i dhunuar dhe krejt sikur ta zinte mallkimi i mbretëreshës plakë, as ai nuk qëndroi dot i qetë nën tokë. Pas rrëzimit të komunizmit e nxorrën nga toka për ta vendosur në njëren nga varrezat e rëndomta të kryeqytetit.

Askujt nuk i erdhi keq për këtë, ngaqë tirani shqiptar shumë herë i kishte shqetësuar të vdekurit. Kështu kryeministri Shehu nuk u la i qetë pas vdekjes, gjersa ia zhdukën kufomën pa

gjurmë. Proverbiale ka qenë sidomos shtegtimi i eshtrave të një anëtari të Byrosë Politike që quhej Nako Spiru. Kundërshtar i jugosllavëve, nën trysninë e tyre vau veten, ose e vranë më 1947, u varros në fillim me nderime ngaqë vetëvrasja u quajt aksidentale. Pak më pas, gjithmonë nën trysninë jugosllave, u quajt tradhtar. Më pas, kur ndërroi qëndrimi ndaj jugosllavëve, kuptohet që ndërroi edhe qëndrimi ndaj tij dhe fitoi prapë nderimet e humbura. Më pas i humbi prapë nderimet nga që jugosllavët për të çoroditir tiranin shqiptar botuan një letër të viktimës, aspak të favorshme për tiranin.

Të gjitha këto ndryshime ndodhnin mbi tokë në kohën që Nako Spiru tretej nën dhë. Ndërkaq të gjitha ndryshimet e erërave politike e gjenin trupin e tij atje ku ishte dhe ishin eshtrat e tij që trandeshin. Kështu disa herë e kanë nxjerrë nga varri i nderuar për ta futur në një varr më të thjeshtë, e kanë nxjerrë prapë këtej për ta rikthyer te varri i nderuar, e prej këtej, sado e pabesueshme të duket, e kanë nxjerrë përsëri...

Suç e shihni një luftë e vërtetë varresh e hijesh bëhej në kodrat rrotull kryeqytetit shqiptar.

Princi Wied ndërkaq iu shmang kësaj valleje makubre nga që iku nga Shqipëria më 1913. Mbreti Zog gjithashtu, ngaqë vdiq më 1961 në Paris, ku edhe e ka varrin. Sa për mbretëreshën Geraldinë, ajo rron edhe sot dhe, siç thonë, ende është e bukur. Është ndoshta e vëtmja mbretëreshë në botë që, pas përbysjes së mbretit, pas shpalljes së tij tradhtar, judë, diktator, vrasës, demon, ajo vetë nuk u përgojuas asnjëherë prej askujt. Është

e çuditshme vërtet marrëveshja e heshtur për të mos e prekur konteshën hungareze që u bë mbretëreshë e Shqipërisë më 1938. E kam menduar shpesh këtë gjë dhe e kam vështirë ta shpjegoj. Mbretëreshat, sidomos kur janë të huaja, tërheqin lehtësish një pjesë të urrejtjes ndaj burrit. Komunistët shqiptarë që e kishin sharjen gjënë më të lehtë në botë, ata, që me të njëjtin pasion mund të sulmonin NATO-n, Merlin Monronë ose Coca-Cola, ata që s'lanë gjë pa thënë kundër mbretit të rrëzuar dhe krejt familjes së tij, e myllën gojën për mbretëreshën Geraldinë. Nuk e përgojuan as gazetarët e shkrimtarët puthadorës, as humoristët, as sharlatanët që quhen historianë, me një fjalë, as zhgani i atyre që i shërbyen shtetit pa patur nevojë të merrnin udhëzime prej tij.

Ja, kështu ndodhin disa herë gjërat në këtë botë.

*A.B. - Një nga aspektet pasionante të psikologjisë suaj krijuese është nevoja për të kaluar nga realiteti historik në një lloj relativizmi ëndrrash. Ju jeni i detyruar t'i alternoni gjendjet shpirtërore. Ndërmarrjet e qarta duhet të ndiqen nga intrigat post romantike dhe nga atmosfera ëndërrimtare në të cilën asnje siguri nuk është e lejuar. Pa dyshim, nuk është pa arsy që ju ilustroni për të dytën herë kopertinën e një libri me fragmentin e një tabloje të piktorit gjerman më të afërt te Novalis e te Klieist, Caspar David Friedrich. "Kush e solli Doruntinën?" Ju largon nga preokupacionet e kohës sonë për t'ju çuar larg, në të kaluarën,*

*në afërsi të dy autorëve gjermanë dhe të Walter Scott, Gerard de Nerval, Edgar Poe, Lermontov, Gëtes së ri e të shkrimtarëve të viteve 1820 ose 1830 në përgjithësi. Sjell ndërmend këtu edhe E.T.A. Hoffmann e një letërsi të tërë gjermane për të cilën aparençat e ëndrrat kanë më tepër rëndësi se realiteti. Kjo më shtyn t'ju pyes mbi leximet tuaja evropiane: në veçanti mbi këtë letërsi të së çuditshmes e të rastësisë që nuk ushqehet asnjëherë me fakte historike, por preferon hijet e gjysmë hijet e ndërgjegjes. Në një itinerar si i juaji, gjatë atyre viteve, a nuk do të ish e dobishme, që papritur dhe në hapësirën brenda një libri, të distancoheshit me të e të kalonit në anën e parandjenave e të parashikimeve: një lloj letërsie që fillon në Angli rrëth 1760 dhe mbaron në Rusi rrëth 1840 me Pushkinin?*

I.K. - Një periudhë gjermanike ka qenë e ndjeshme në rininë time. Kjo ndodhi fill pas magjepsjes sime pas Shekspirit, ose më saktë pas "Makbethit". Si një kaktus në shkretëtirë, që ka aftësinë të thithë lagështirën mbrojtëse kudo që e gjen, i etur siç isha për shekspirizëm unë e kërkoja atë gjithandej. Librat gjendeshin me vështirësi në vitet 1946-1947 dhe ato që botoheshin ishin tmerrësish të mërzitshme. Por, edhe midis tyre, unë kërkoja ndonjë copëz madje thjesht ndonjë frazë, që dukej e gjallë në atë djerrinë politiko-socialiste. Kështu më kujtohet se si krejt i mahnitur dhe pa i besuar syve, në një broshurë të Stalinit, që fliste për lidhjet e partisë me masat, ishte një paragraf ku Stalini përmendte Anteun, të cilin,

kundërshtari i tij Herkuli, arriti ta mbyste vetëm pasi e shkëputi nga toka mëmë. Kuptohej, në këtë rast cili ishte morali: partia s'duhej të shkëpuet kurrë nga toka, domethënë nga populli. (Qysh nga ajo kohë në mendjen time partia përfytyrohej para së gjithash si diçka që dikush përpinqej ose ta priste ose ta mbyste). Nganjëherë kërkimi ishte edhe më i vështirë. Kështu në një broshurë të Titos me titull "Gjashtë vjetori i ushtrisë jugosllave", më kujtohet se midis tekstit të vdekur gjeta vetëm gjysmë fraze ende të gjallë: "në dimrin me borë të vitit...".

Këto copëza të gjalla midis shkretisë më dukeshin shumë më të çmuashme se sa kur i gjeja me shumicë në botimet e vjetra. Vetë skajimi i tyre midis djerrinës bashkëkohore i ngjante, me sa dukej, një lloj mrekullie. Që të kthehem tek ndikimi gjermanik duhet t'ju them se pasi e kuptova se nuk do ta gjeja dot një Shekspir gjerman, m'u duk se gjeta sidoqoftë diçka të ngashme: baladat gjermane të shekujve 18-19. Në atë kohë as i njihja e as kisha mundësi të njihja Hoffmannin, Kleistin, megjithatë në mendjen time ata ishin parandjerë ndërkaq.

Në gjimnaz na e kishin hequr frëngjishten e latinishten për ta zëvendësuar me rusishten, gjuha që të gjithëve iu dukej e mërzitshme së pari sepse mishëronte zotërimin sovjetik, së dyti sepse kishte mbytur latinishten e frëngjishten, të cilat ishin sidoqoftë më të afërtë me gjuhën shqipe, dhe së treti për shkak të alfabetit cirilik, i cili iu kujtonte shqiptarëve alfabetet serbe e greke, fqinjë me të cilët ata kishin patur kujtime të hidhura.

Dashuria për letërsinë më bëri që të kapërcej këto pengesa dhe ta mësoj rusishten. Një libër i Zhukovskit me përkthime baladash anglosaksone e gjermane kishte qenë për mua një zbulim i madh. Atje u njoha për herë të parë me atë që Pushkini e kishte quajtur "muzë e egër e Gjermanisë": baladat e Gëtes së ri, të Shilerit, të Uhlandit e gjer te "Lenoren Lied" e Byrgerit.

Kjo e fundit për mua ishte tronditëse për një arsyet tē veçantë: ishte balada e Doruntinës, që ende këndohej në Shqipëri. Por ndryshe nga ç'e prisja dhe për habinë time tē madhe ajo më zhgënjeu. Natyrisht m'u desh mjaft kohë që ta kuptoja se isha i zhgënjer. Dhe një kohë edhe më e gjatë që ta pranoja se motërzimi që këndohej në fshatrat rrotull qytetit tim ishte më i thellë e më i bukur se ai i Byrgerit. Një lloj thatësije, retorizmi, një lloj "zyrtarizmi" i baladës së tij më zbuloi për herë të parë turbull, fare turbull se arti nuk varfërohej vetëm në qiellin socialist, por edhe nën qiejt e tjerë. Ka mundësi që qysh në atë kohë, në ndërgjegjen time u shtresua një dëshirë e parë e mjegullt që një ditë ta rishkruaja këtë baladë, çka ndodhi dyzetë vjet më pas, kur shkrova romanin "Kush e solli Doruntinën".

Rendja ime pas misterit nuk u pakësua me kalimin e viteve, atëherë kur njeriu, i detyruar nga mosha dhe sidomos nga socializmi qëllon të zbraset edhe nga ky thesar. "Dama Maç" e Pushkinit më tërhiqte më shumë se krejt proza tjetër dhe gjysma e vjershavë tē tij, ashtu si "Djalli i vogël" i Sollogubit në fillim tē shekullit XX.

Shekspiri ndërkaq u kthyte në një tiran tē

vërtetë në qënien time. Ai i shtynte rivalët. Kështu, për shkak të tij, e humba për jetë Tolstoin e madh. E njoha, për fat të keq, fill pas magjepsjes makbethiane dhe aty m'u ftoh përgjithmonë. Shumë qortime u bënë në vetëdijen time krijuese, por Tolstoi me përjashtim të "Haxhi Muratit" nuk u kthye më. Në gjuhën shqipe është një shprehje: "u panë hënabrénda" ose "u panë hënajashtë", çka do të thotë u ndeshën në një çast të keq ose të mirë.

Më pas kur u ndesha me sulmin zemërak që Tolstoi në pleqërinë e tij i bëri Shekspirit, jo vetëm u habita krejt, por m'u duk se gati-gati plaku e kishte parandjerë rrezikun që i vinte prej anglezit. "Haxhi Murati" ishte vepra e fundit e Tolstoit. Ai e shkroi atë afërsisht në kohën që bëhej gati të shpallte armiqësinë me Shekspirin. Për çudi, ajo është vepra që më së shumti i afrohet Shekspirit...

Qysh pas konfliktit të Rusisë me çeçenët ky roman më është kujtar përherë e më shpesh. Sepse ai flet pikërisht për luftën e çeçenëve kundër russëve në shekullin e kaluar. Ndaj dhe ka mbetur përherë i mbuluar me pluhurin e harresës, ai që është një ndër dy-tri veprat më të bukura të Tolstojit dhe një nga perlat më të rralla të krejt letërsisë ruse. Është bojkotuar nga Rusia e carit, pastaj po aq nga Rusia bolshevikë, dhe tani gjithaq, në mos më fort, nga Rusia antikomuniste. Për habinë time të madhe kam vënë re se bojkotimi ishte shtrirë edhe këtu në Perëndim. Sa herë që kam pyetur kolegët e mi perëndimorë për të, në shumicën e rasteve, jo vetëm që s'e kishin lexuar por as

që e dinin ekzistencën e tij!

Shkrimtarët e sotëm rusë, e sidomos disidentët e djeshëm, për fat të keq, nuk e thanë gjysmë fjalë në mbrojtje të çeçenëve. Shumë intelektualë këtu në Perëndim, nga ata që nuk përtojnë të bëjnë zhurmë e sidomos të japid mësimë morali të tjerëve nuk u ndjenë fare. Përpara syve të krejt njerëzimit iu la dorë e lirë banditëve russë të kryejnë një nga krimet më të turpshëm të shekullit, masakrimin e një populli të tërë. Kështu pra heshtën moralistët e sotëm... Kurse konti plak Tolstoi, vetëm ai, si i shtyrë nga providanca, në moshën tetëdhjetë vjeçare, në prag të vdekjes, e çlroi ndërgjegjen e tij për një krim të Rusisë, sikur ta parandjente se krimi do të përsëritej.

*A.B. - Do të doja t'i fusja në të njëjtin grup dy nga veprat tuaja botuar tek ne në një interval prej një viti, më 1988 dhe 1989: "Eskili, ky humbës i madh" dhe "Dosja H.". Ato kanë mjaft pika të përbashkëta nga të cilat më e fortë është mirënjohja ndaj kontributit grek apo helenik. E para është për ju një risi: një ese që ju lejon të pohoni borxhin që i keni një pasurie mijëvjeçare. Epiri dhe Iliria, në kuptimin e gjërë të fjalës, i përkasin fushës homerike. Deri tanë, ju mburreni me trashëgiminë shqiptare, me një të kaluar që sipas dëshirës e zbukuronit me fantazi dhe ëndrra për ta madhështuar apo për ta çvendosur në mbretërinë e obësionit të përhershëm. Ju flisni për Eskilin si për një personazh të afërt që ju lejon të jeni, përballë artit tuaj, një njeri që*

*pirez drejt një identiteti intelektual përtej identitetit tuaj prej shkrimtari të shekullit XX. Mos vallë e bëni këtë në emër të universalizmit apo të një qëndrueshmërie që shkon përtej prejardhjes kombëtare, të cilën ju nuk e hidhni poshtë, por që befas ju duket me të drejtë sikur është shpirtërisht, tepër e ngushtë? Është Homeri që me praninë e tij të fshehtë, e bën "Dosjen H." një libër ironik e satirik. Zbulohet tek ju një vene dhe një ton i ri, plot shaka e buzëqeshje që nuk ishin parë më parë në librat tuaj. Bashkëfajësi të këtij lloji ndërmjet seriozitetit të çështjes dhe lajthitjeve tipike për manitë njerëzore gjajejmë, më duket, në letërsinë angleze, tek D. H. Lawrence e Somerset Maugham. Dy amerikanë vijnë në Shqipëri me mendime të gabuara; nën pretekstin për të gjetur tek tradita gojore, mbetjet e një epoke homeriane, ata pyesin banorët dhe kujtojnë se zbulojnë, andej këndeja, ngashmëri, analogji, shenja të një mbijetese të mrekullueshme. Sigurisht u tallën me ta dhe ajo që është mister duhet të mbetet mister. Arkeologët duhet t'i qëndrojnë besnikë fushës së tyre dhe të mos ekstrapolojnë. Sekreti i së kaluarës fsheh fantazma, të cilat kërkuesit nuk do të arrijnë kurrë t'i gjejnë. Populli tallet me ta ashtu siç e meritonin. Nëse ka traditë, ajo ndodhet pa e ditur, në mendje e në shpirt. Shkarazi ju ngacmoni anglo-saksonët, të shtënë pas zbulimeve, që në fakt nuk janë zbulime, dhe profesorët që, duke u bazuar në disa poçe të thyera, nuk hezitojnë të falsifikojnë historinë. Veç kësaj, a nuk janë në fushën e letërsisë, universitarët armiqtë tanë më të mëdhenj: ata analizojnë edhe presjen më*

*të vogël, ndërkojë që nuk kuptojnë asgjë nga mekanizmi i krijimtarisë?*

**I.K.** - Lidhur me "Dosjen H." dëshiroj të saktësoj se edhe të kisha dashur nuk mund të isha tallur me dy homerikët amerikanë, që vijnë në Shqipëri për të studuar çështjen homerike, për arsyen e parë dhe themelore sepse njërin prej tyre Albert Lordin e kam takuar në vjeshtë të vitit 1979 në Ankara. Ishte ai vetë që më tregoi se si në vitet '30 bashkë me kolegun e vet Milman Parry kishin bërë udhëtimin e famshëm në Shqipëri dhe Jugosllavi për të gjurmuar shkëndijimin e fundit homerik. Albert Lordi më la një përshtypje të mrekullueshme.

Ndërkaq jam në një mendje me ju se mekanizmi i mirëfilltë i krijimit, pjesa e fshehtë, e padukshme e makinës është pa dyshim e pagjetshme. Dhe ndoshta s'ka nevojë të gjendet ngaqë gjetja do të ishte një lloj katastrofe, si ajo që përshkruhet në epilogun e "dosjes homerike". Vite më parë kam shfaqur mendimin se çdo shkrimtar e merr me vete laboratorin e tij në varr dhe kjo gjë nuk duhet të na trishtojë aspak. Nuk duhet të brengosemi për këtë sepse po të ndodh<sup>te</sup> e kundërtat, domethënë në qoftë se laboratori do të ishte i trashëgueshëm, ashtu si klinika e mjekut, ose punishtja e argjendarit, ky do të ishte edhe fundi i artit. Çdo shkrimtar që vjen në këtë botë duhet ta krijojë laboratorin e tij nga e para.

Përpara se të flas për Eskilin dhe hijen e tij mbi krijimtarinë time dëshiroj t'ju them diçka për njojhen time me grekët e vjetër. Për fatin

tim të mirë, njohja ime e vërtetë me letërsinë e vjetër greke ndodhi në moshën e pjekur kur isha 27-29 vjeç, atëherë kur kisha një vizion të qartë për shumë gjëra e natyrisht për letërsinë botërore.

Them për fat të mirë, sepse një njohje e parakohshme do të ishte me të vërtetë një fatkeqësi. Në qoftë se tragjikët grekë do të përplaseshin në trurin tim ta zemë me Shekspirin, ashtu siç më ndodhi me Tolstoin kur isha 11-12 vjeç jam i sigurtë se shkumbëzimi shekspiran do t'a rrënonte madhështinë e tyre të qetë.

Ndërkaq, qysh në kohën e adoleshencës una kisha një njohje të mitologjisë dhe letërsisë greke, por në atë masë që i shkonte për shtat psiqikës sime, domethënë në një trajtë gjysmë përrallore, gjysmë familjare, thua se ato ngjarje kishin ndodhur diku te rrugina fqinje. E ndiej se fjalët e mijë nuk janë të përpikta, por do të përpinqem ta shpjegoj këtë me ca shembuj të thjeshtë. Më tepër se njohje e letërsisë greke ishte në fillim një keqardhje për rënien e Trojës. Në mendjen time, s'di sepse, kjo ishte shenjuar si një fatkeqësi brenda fisit. Më kujtohet, apo kishte vdekur gjyshi nga nëna, (ai që e kam përshkruar te "Kronikë në gur"), dhe kjo ishte vdekja e parë në rrëthin familiar: Arkëmorti i gjyshit ishte në dhomën e pritjes së shtëpisë, i rrëthuar nga gjindja që, sipas zakonit, duhet "ta ruanin" gjithë natën, kurse unë, në një nga dhomat e gjumit, mendoja se do t'i jepja pa keqardhje këpucët e reja që apo më kishte bërë dhuratë emta, veç që gjyshi të ringjallej. Këtë lloj premtimi e kisha bërë disa netë përpara për rënien, ose më mirë mosrënien e Trojës. Më

dukej se ajo mbytje e Trojës në gjumë kishte qenë një gjëmë e vërtetë, ashtu siç të duket dyfish e gjëmshme një fatkeqësi që mund të shmangej. Kisha menduar gjithfarë mënyrash se si trojanët mund ta dëbonin të keqen e prej kësaj, në vend që të lehtësosha, brengosesha edhe më fort. Më dukej se diku, në ca sfera të panjohura, ishte ende mundësia e qortimit të këtij krimi. Me sa dukej, romani "Përbindshi" ku Troja nuk binte, ishte një peng që ia ktheja adoleshencës sime.

Unë e njoha letërsinë greke atëhere kur duhej, domethënë kur isha i përgatitur për të. Në sytë e mi kisha ndërkaq tejqyrën e komunizmit. Ishte ajo që më ndihmoi të kuptoj se gjithësia jonë komuniste ishte e afërt me antikitetin e përgjakur, pra me krimet e tij. Besoj e kuptoni se ishte e natyrshme që Eskili të zinte tek unë vendin e parë.

I ngucur nga një ngjarje e njëmendët, tërheqja prej Italisë e ushtarëvë të vrarë gjatë luftës, pas njëzetë vjetësh, më 1960, e kisha shkruar, madje e kisha botuar romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", kur krejt i mahnitur gjeta te "Orestia" një skenë të ngjashme, për të mos thënë thelbin e romanit tim: mbërritjen në Greqi të arkave me hirin e ushtarëve grekë të vrarë në Trojë.

Sa herë që e lexoja Eskilin gjeja në të rikumbime të kohës. Ishte shkrimtari i parë që kishte përshkruar "mërzinë e luftës", aq e njohur në fillim të viteve 60, sidomos pas shpërthimit të famës së Heminguejt, ndikimi i të cilit kishte qenë i ndjeshëm për të gjithë ne shkrimtarët e rinj të kohës.

Por ajo që e afronte sidomos Eskilin me botën tonë ishte, siç ua kam thënë mjaft herë, atmosfera e krimit dhe e ankthit shtetëror. Shtëpia me tre porta e Atridëve u bë për mua shtëpia simbol e çdo shefi komunist. Në çdo vend të Lindjes kishte shtëpi të tilla. Shtëpia e kryeministrit shqiptar Shehu, ku natën e 17 dhjetorit 1981 ndodhi vrasja ngjethëse, për të cilën fola më parë, ishte ndoshta më e ngashmja me pallatin e Agamemnonit. Rrëzimi i krejt familjes Shehu, varrimi gjysmë i fshehtë i kryeministrit, ("Ne që e vramë, ne do ta varrosim, pa bujë e pa fjalime natyrisht" thotë Eskili me gojën e Klitemnesrës për Agamemnonin), pëshpërima popullore se kryeministrin shqiptar, njëlloj si Agamemnoni, e zuri mallkimi për krimet që kishte bërë, nxjerrja më pas nga varri dhe tejbartja në një gropë të paditur, kërkimi më pas i gropës dhe i të vërtetës prej të birit të tij, të vogël në librin "Vjeshta e ankthit", të gjitha këto ngjanin çuditërisht me kronikën eskiliane.

Një shtysë tjeter e natyrës profesionale për trajtesën për Eskilin ishte mendimi im për lindjen e tragjedisë. Sado që mund të dukej pafalshmërisht e guximshme dhe aspak modeste, prej kohësh kisha shfaqur mendimin se tragjedia nuk mund ta kishte zanafilën tek festat dioniziake, siç thuhej qysh prej një mijë vitesh në të gjitha shkollat e akademitë e botës, dhe siç ishte ripohuar, për habinë time të madhe prej Friedrich Nietzches, por te ritet e vdekjes.

Teza e festave dioniziake, jo vetëm më dukej e kundërnatyrrshme për vetë thelbin e tragjedisë, por fyese për të. Megjithatë, për një shkrimtar

shqiptar, siç isha unë, ishte e pamundur në vitet 1984-1985, të vinte në dyshim një tezë botërore, të vinte në dyshim qoftë edhe Nietzsche, aspak të dashur prej komunistëvë. Herezitë e mëdha u lejoheshin vetëm hyjnive të kësaj bote, klasikëvë të marksizëm-leninizmit, ose tiranëve të sotëm të saj, por kurrsesi të tjerëve. E përderisa klasikët, e sidomos ai që quhej kryeshkoqitës i çështjeve të kulturës së grekëve të vjetër, e që në të vërtetë s'ishte veç një hulumtues i rëndomtë i saj, Marksia, nuk kishte thënë asgjë të re për lindjen e tragjedisë, askujt nuk mund t'i lejohej të dyshonte për asgjë.

Duke e ditur këtë, për të shmangur një pengesë të tepërt për botimin e librit, në tezen që trajtoja, tezen e re, heretike të zanafillës së tragjedisë, në vend të fjalëve "unë mendoj se", shkrova kudo fjalët "kohët e fundit mendohet se".

Natyrisht që s'ishte veçse një cënim i vogël, gati-gati i lumtur, në krahasim me gjëmat që kërkoheshin shpesh prej botuesve dhe prej shtetit.

Më pas, ngjarjet që ndodhën në Shqipëri në vitet 1989-1990, në prag të përbysjes së diktaturës, kur ritet e vdekjes rifiutan befas një peshë e një zi dehëse të paparë ndonjëherë, duke u kthyer në një lloj institucioni kundër diktaturës, siç e kam përmendur në librin "Nga një dhjetor në tjetrin", u binda edhe një herë se sa kisha patur të drejtë.

**A.B. - Me librin "Koncerti" botuar në Francë më 1989 hyjmë në një periudhë prodhimtarie**



Foshnjë, me të motrën.  
Fëmijë, në oborrin e shtëpisë.  
19 vjeç, student gjatë zborit ushtarak të verës në  
Kukës.

+



22 vjeç. Student në Moskë. (1958)



Moskë. Midis shkrimitarëve sovjetikë.



Në Moskë me mikun e vet të kursit, poetin letonez Jeronim Stulpanz, personazh në romanin "Muzgu i perëndive të stepës", i vetrarë më 1989.



Pas kthimit në Shqipëri më 1961. Periudha e "Gjeneralit të ushtrisë së vdekur".



Gjatë udhëtimit në Kinë, 1967.



Kinë, gjatë revolucionit kulturor, 1967.

Kinë, te Muri i madh, 1967.



Paris, 1971. Recepzioni i parë në  
Francë për të nga "Hachette".





Në breg të detit. Durrës, 1971.



Në Suedi me LL. Siliqin dhe shkrimtarë suedeze.



Suedi, tetor 1975, dy javë përpara skandalit të vjershës "Pashallarët e kuq".

+



Me vajzën e madhe në Durrës.



Me vajzën e vogël.



Me të shoqen, Elenën.



Me Elenën në Paris, 1978.



Me shkrimtarët e Kosovës, nëntor 1980.



Me Lasgush Poradecin më 1981.



Me Heinrich Böll, më tetor 1981, në Frankfurt.

+

Në Washington, duke folur përpara një komisioni  
të Kongresit Amerikan në maj 1991.



Me refugjatët shqiptarë në Firence më 1992.





Me Alain Bosquet dhe Jashar Qemalin, më 1992, Paris.



Me Aleksandër Solzhenicinin më 1993 në Paris.



Me Rexhep Qosen, Idriz Ajetin dhe Mark Krasniqin, në banesën e tij në Paris.



Me të shoqen, Elenën.

*të mrekullueshme. Pa dyshim, do të ishte e kotë të analizonim këtu arsyet, por ndoshta do të na duhet të përmendim disa konvergjenca fatlume: regjimi i presidentit Alia, një burrë i zbehtë e i dobët në krahasim me Hoxhën, lejonte një liri më të madhe, ndërkokë që kudo në Evropë po shëmbeshin një nga një kufijtë komunistë, çka përbënte një nxitje të pashoqe. Nga ana tjeter, fama juaj rritet shumë shpejt në Perëndim ku ju kuptojnë e ku ju tashmë mund të udhëtoni, pikërisht në Francë. Ju nuk jeni më shkrimtari shqiptar që ju shohin me një kuriozitet të ndrojtur por me plot kuptimin e fjalës një shkrimtar i shkallës evropiane. Dihet se në kohën kur disidentët rusë cfiliteshin së grinduri kot së koti, sidomos Solzenicini, i cili zhgënjen admiruesit e tij dhe Siniavski që ndrydhet në vete, dihet se ju nuk keni asgjë të përbashkët me një polemist që ka kënaqësinë perverse të polemikës. Në këto kushte, të reja për ju, ju botoni librin "Koncerti". Më parë, ju keni përshkruar dramën e prishjes së Shqipërisë me Rusinë e Hrushovit. Tani, ju del si detyrë të përshkruani, me të gjitha mjetet e tregimit epik, prishjen me Kinën. Dhe ju e bëni këtë me një tension e një lloj etheje të veçantë. Është në të njëjtën kohë një roman donkishotesk përfaktin se trajton një temë të madhe dhe një iluzion të kotë. Mund të besojmë pa dyshim, tek një Rusi komuniste e pastër dhe e fortë: ajo nuk ndodhet shumë larg gjeografikisht. Por çdo të bëhej me një popull të vogël që do të fillonte të besonte, i detyruar e me pahir, tek një vend mik qindra herë më i madh dhe me të cilin nuk kishte pasur*

asgjë të përbashkët në të kaluarën? Në Perëndim, duke folur për Shqipërinë e asaj kohe thuhej me një ironi të hidhur: "Kina popullohet nga një miliard shqiptarë". Po me këtë ton thuhej edhe se "Shqipëria popullohet nga një miliard kinezë". Por dy konstatimet imponohen. I pari, prej më shumë se gjysëm mijëvjeçari Shqipëria kish nevojë për të sajuar një mbrojtës. Konstatimi i dytë është plotësues. Ajo çdo herë ka njojur prirjen e refuzimit e të ndërprerjes së marrëdhënieve. Përtej situatave romaneske e forcës së personazheve, ja pra si e krijoni, siç e kuptojmë ne, pamjen e një Shqipërie njëherazi reale dhe mitike. Popujt jetojnë gjatë vetëm në sajë të paraqitjes simbolike të gjenisë së tyre. Disa, përveç historisë dhe pështjellimeve të saj nuk kanë asgjë për t'u lakuar. Në vendin tuaj, identiteti është një thesar i rrallë. Mund të them me bindje se jeni i vetmi, sepse asnje se ka bërë para jush, që i keni dhënë Shqipërisë një identitet të dyfishtë, ashtu siç ekziston tashmë emblematike në emblemat e hershme: një pamje të identifikueshme e një imaginare - duhej më mirë të thosha: një pamje që i ka rrënjet në imaginaren. Ky lloj ambiguiteti i jashtëzakonshëm nuk gjëndet as në Bullgari, as në Hungari, as në Rumani.

**I.K. - Romani "Koncerti"** ose më mirë "Koncert në fund të dimrit", siç quhet në origjinal, është, pa dyshim, romani im më i guximshëm e më i lirë. Libra të tillë si "Pallati i ëndrrave" ose "Qorrfermani" ishin të lira sigurisht, megjithatë e kishin një farë mbrojtjeje, sado e brishtë të

ishte ajo: dekorin otoman. Kurse te "Koncerti" flitej për botën komuniste, për Shqipërinë e përditshme, për grindjen tragji-komike midis xhuxhit të mbrapshtë komunist, Shqipërisë, dhe gjigandit qesharak komunist, Kinës. Në të përshkruheshin të dy shefat dyluftues Mao Ce Duni dhe Enver Hoxha, përshkruheshin plenumet e Komitetit Qëndror ku zbuloheshin komplotet, fushata e spastrimeve, hetimet e pafundme dhe, kulmi i të gjithave, përshkruhej me hollësi vrasja me dinakëri prej Maos e pasardhësit të tij Lin Biaos, pikërisht në kohën kur tirani shqiptar, po aq dinakërisht, përgatitej të vriste pasardhësin e tij Shehu.

Liria e "Koncertit" ishte pa dyshim dhjetë fish më e çmuar se çdo liri tjetër. Kur më 1982 më thirrën në Komitetin Qëndror për të më njoftuar se "romani im ndalohej me urdhër të Komitetit Qëndror", i nervozuar siç isha, nuk e kapa rrezikun që më kërcënohej.

Kur shkova në shtëpi dhe e rilexova një pjesë të dorëshkrimit e kuptova se ç'tmerr kisha gatuar. Gjithë Shqipëria dridhej nga "zbulimi i rrënëjëve të komplottit të Shehet", shtypi dhe radiot e huaja e vinin në dyshim vetëvrasjen e tij, duke hedhur pandehmiën se ishte vrarë prej tiranit Hoxha. Kurse në romanin tim unë përshkruaja pikërisht një vrasje të pabesë në krye të piramidës komuniste, që ngjante aq shumë, që ishte pothuajse e njëjtë me atë që porsa kishte ndodhur.

Megjithatë, trishtimi për ndalimin e botimit, (ishte romani im i vetëm që ndalohej përpara botimit), ishte kaq i madh saqë m'a errësoi ankthin që duhej të ndieja prej tij.

Ky roman kishte qenë shpresa ime e fundit. Siç e kam shpjeguar te "Pesha e kryqit" praktikisht e kisha të ndaluar botimin e romaneve. Kuptohej fare qartë se diktatori donte që vepra ime kryesore të mbetej "Dimri i vetmisë së madhe", ku ai ishte personazh. Kjo të kujtonte historitë tipike ballkanase kur porositësi i një arme të bukur e vriste armëpunuesin, në mënyrë që ky të mos bënte armë tjetër të ngjashme.

Shpresova ta kaloj "Koncertin" duke e paraqitur si vazhdim të "Dimrit". Madje praninë e këtij të fundit e theksova edhe në titull. (Koncert në fund të dimrit). Duke e ditur se ky do të ishte shansi im i fundit, e punova me shumë përkushtim, gati me mallëngjim këtë vepër. Veç kësaj, në trupin e tij futa mjaft subjekte të tjerë në formë synopsesh ngaqë dyshoja se do të mund t'i shkruaja ndonjë herë. Kështu që në atë roman janë burgosur disa të tjerë që nuk e di a do të kem rastin t'i çliroj...

Dhe ja të gjitha shpresat ranë... Në tetor të vitit 1983, midis një periudhe të zezë të jetës sime, në dhomën time të punës, bashkë me time shoqe, me fletët e dorëshkrimit të "Koncertit" mbështillnim shishet e konjakut, e vëtmja mënyrë për t'i nxjerrë ato jashtë shtetit.

Ky ishte epilogu i fatit të dorëshkrimit që do t'i shkonte më fort një shkrimtari që adhuronte pijen!

Këtë libër e kam quajtur përherë kryesor në krijimtarinë time. Sapo filloi grindja e parë me Kinën diçka u përshëndrit brenda meje. Dhe atëhere e kuptova se prej vitesh e kisha pritur

këtë ftohje. Dhe e kuptova gjithashtu se prej kohësh kisha pritur të shkruaja për të. Ishin dy idhujt e mi që takoheshin në këtë subjekt: Shekspiri dhe Servantesi. Asnjëherë fjala "tragji-komike" nuk kishte gjetur një mishërim kaq të plotë. "Koncerti" ishte një libër që unë duhej ta shkruaja pa tjetër. Do të besoja, ashtu siç thotë Homeri, se miqësia e pastaj grindja shqiptaro-kineze ishte sajuar enkaz prej hyjnive për të nxitur hartimin e një vepre letrare.

Kam qenë në Kinë më 1967 gjatë revolucionit kulturor. Ishte kohë krize shpirtërore për mua. Pas botimit të romanit të dështuar "Dasma" kisha vendosur ta braktisja letërsinë. Te "Koncerti" është përshkruar vdekja e një romani brenda qenies së një personazhi shkrimtar. Pa dyshim është një vdekje që e kam ndjerë vetë. Pa më shkuar mendja në atë kohë se pikërisht aty ku unë kujtova se diçka kishte vdekur, pikërisht në atë zbrazëti dhe në atë varr kishte lindur romani im i ardhshëm "Koncerti".

Lidhur me portretin e një Shqipërie, që është gjithaq e njëmendtë sa edhe mitike unë, me sa duket, kam pasur disa arsyе për këtë. Them, me sa duket, sepse asnjëherë shkrimtari nuk mund ta dijë përpiktas përsë e ka bërë ose nuk e ka bërë diçka.

Një nga arsyet, ajo më e rrokshmja, por jo më e thella, lidhej, me sa dukej, me regjimin politik të vendit. Shqipëria e njëmendtë, e shfrytyruar prej shkretisë, prej mërzisë, prej ankthit dhe prej lajle-luleve komuniste, ishte e padurueshme. Mund të çmendeshe prej saj. Si e tillë, ajo ishte njëkohësisht

e pavërtetë. Petkat, maskat dhe ringa-xhingat qesharake të saj ishin aq të përkohshme sa edhe petkat e karnavaleve.

Gjëja e parë që unë doja të bëja si shkrimtar ishte që prapa kësaj kartonërie e butaforie, të kërkoja Shqipërinë e përjetshme e të qëndrueshme. Për këtë më duhej ta ritrajtoja fytyrën e saj, njëlljo si skulptori që modulon baltën a mermerin. Kështu, përpara se të prekja ndërgjegjen e saj të turbulluar, më duhej të bëja ndryshime në trupin, pra në hapësirën lëndore të saj. Të zgjeroja disi fushëtirën e saj si edhe pjesën e ndërmjetme midis maleve e ultësirës. Të bëja ndryshime të tjera, për shembull klimaterike. Kështu e ula 5-6 gradë temperaturën e saj, ngaqë më dukej se kështu e dëboja vapën aziatike. Solla mjegull e shi nga rrafshulta evropiane, ngaqë më dukej se nën to e kisha më lehtë të sillja bashkë me hirnosjen edhe fytyrën e Evropës. Bëra, pa dyshim, edhe ndryshime të tjera, gjer te ato urbanistike, madje gjer te emrat e rrugëve, të cilat i zëvendësova me emrat e vjetër, etj.

Kështu, e ndryshuar, e shtrajtuar, mjegullore, Shqipëria më dukej më e afërt dhe, kryesorja, më e padëmshme nga regjimi komunist. Shpresoja që kështu ta zëvendësojat dalëngadalë pamjen e saj, t'i mësoja njerëzit me një pamje të dytë, me shpresën se një ditë ata do të përmendeshin si nga një ëndërr e keqe e do të thoshin: pse po jetojmë ende në këtë butafori? Pa ta flakim përtë këruar nën të atdheun e vërtetë.

Me fjalë të tjera, unë rrekesha që nën pankartet dhe ngrehat e përkohshme të socializmit të krijoja një tjetër Shqipëri, në mënyrë që kur të vinte

çasti i madh, kur të binte ora e përbysjes, shqiptarët të mos hutoheshin prej pluhurit të rrënimit, por shumë shpejt, nën këmbët e tyre të gjenin truallin e fortë të Shqipërisë sublime.

Kjo nuk është një përsiatje e lindur tani vonë, këtu në Paris. Në janar të vitit 1985, kur tirani ynë ishte ende gjallë, në trajtesën për Eskilin, krejt shestimi im është shprehur fare qartë, natyrisht duke iu veshur tragedianit grek.

Juve mund t'ju duket kjo një ambicie e madhe nga ana ime, ndoshta megalomani. Që ka diçka donkishoteske, kjo është jashtë çdo dyshimi. Por donkishotizmi bën pjesë në mjeshterinë e shkrimitarit. Ndërkaq, pa e tepruar aspak, mund t'ju them se vepra ime letrare ishte sq shumë e njojur saqë ishte bërë zotëruese në Shqipëri. Ndikimi i saj te lexuesi shqiptar ishte më i madh se i krejt letërsisë tjetër marrë së bashku. Kështu që ëndërrime të tillë më lejoheshin.

*A.B. - Para se të vazhdojmë bisedën tonë në lidhje me veprën tuaj, do të doja të bëja një pauzë. Do të vazhdojmë të flasim për ngjarje e shfrime mjaft të afërt në kohë. Shpesh ato ndërthuren apo ndërhyjnë tek njëri tjetri. Jeta juaj gjithashtu pëson tronditje dhe ju që në fillim të dhjetëvjeçarit të sotëm në regjimin e Alisë, u detyruat të merrnit vendime me pasoja të shumta, Ju e kaluat diktaturën e Hoxhës me mjaft durim. Të paktën ju kishit një kundërshtar me përmasa të pakundërshtueshme. Alia, është me plot kuptimin e fjalës, një lloj nën-Kerenski i tranzicionit. Ju shkëpusni çdo lidhje*

*me të dhe vendin tuaj dhe kërkon azil politik në Francë. Kur ishim tek unë, në shtëpinë time në Paris, prej konfidencave tuaja të shprehura me gjysëm zëri parandjeva atë çka do t'ju ndodhte.*

*Ekzili në Francë ju shkakton mijëra shqetësimë por ju çliron nga një shqetësim i madh: siguria juaj. Ju nuk jeni as tradhtar, as disident, as një polemist i thjeshtë. Ekzistonin vetëm dy rrugë: ose qeveria e dobët shqiptare do t'ju flakte ose shpejt do të bëheshit një shembull i mirë për t'u ndjekur. Ju patët fatin e madh të ktheheni në shembull. A nuk është e dëshirueshme që në këto kushte, t'ju spjegoja dhe t'ju lejoja, juve, si evropian që jeni, të flisni për diçka tjetër jashtë letërsisë? Juve ose do të heshtnit për ndjenjat tuaja ose në të kundërt do ti hapeshit medias.*

*Rreziku nuk ishte i vogël: tek ne, shtypi flet shumë, është pak serioz dhe mjaft injorant. Për disa ju u bëtë shqiptari që fliste dhe që nuk e njihte gjuhën mashtruese të formulave të gatshme të propagandës.*

*Nuk është i lehtë roli që luani e nënvizoni te "Pranverë shqiptare" e "Ftesë në studio", si për të provuar se nuk ruani asnjë sekret dhe mentaliteti juaj në thellësinë e tij mund të gjykohet nga të gjithë. Kjo hapje e mendjes është për t'u lavdëruar. A përkon ajo tërësisht me mënyrën tuaj të të jetuarit? Dhjetë intervistat e para mund të jenë dehëse, ç'ndjeni ju në të njëqindtën? Marrëdhëniet tonë mjaft miqësore më lejojnë t'ju flas kështu, me një çiltërsi absolute. Në fillim u mësova të analizoj kompleksitetin tuaj të brendshëm, e më pas ta dua atë. Ai i përgjigjet mjaft mirë*

*figurës së një shkrimtari të kompletuar që i njeh shtërngesat e vëtmisë dhe herë pas here dorëzohet përpara dehjeve të vogla të komplicitit me shekullin. Në sytë e perëndimit të hutuar ju ishit një rast i çuditshëm dhe padyshim unikal. Dyshonin tek Shqipëria, pa e kuptuar aspak atë, e pra për dembeli intelektuale, dyshonin edhe tek ju. Pastaj erdhën me radhë vlerësimi e admirimi për librat tuaj, çka mendjet tona karteziane nuk arritën ta pajtojnë me njeriun. Ky njeri, ashtu siç jeni, jeton në imagjinaren, në vizionet, në afresket ku realja i hap një luftë mjaft fisnike ireales. Pra, ju nuk jeni njeri që mund t'ju afrohesh lehtë. Ne kërkonim mënyra përdorimi, receta, çelësa për të njohur personalitetin tuaj. Dhe këto na i ofrojnë pa asnjë kufizim, dy librat që citova më lart. Ashtu siç ia përsërisni shpesh të afërmëve tuaj, ju nuk mbani asnjë sekret: përkundrazi, kemi të bëjmë në një farë mënyre, me një kompleksitet të bashkëlindur. Një krijues nuk mbyllët i téri në një sistem krijimtarie të palëvizshëm. Ai ndërron edhe fryshtëzimin edhe prirjen edhe domosdoshmërinë vitale, në se mund të themi kështu. Ju nuk keni medoemos njohuri të thella për Francën, zakonet e mënyrën e saj të të menduarit. Megjithatë intuita juaj, e dini apo s'e dini ju, është e sigurt. Në momentin që ju vendoseni në Francë, këta dy libra, në formën e një rrëfimi njëherazi të rezervuar e objektiv, mbrritën tamam në kohë për të kompletuar imazhin e pakapshëm që ne kishim për ju.*

**I.K. - Duhet apo nuk duhet të japë shkrimtari**

shpjegime për veprën ose veten e vet? Është një mëdyshje që e kanë jetuar, besoj, të gjithë. Mendoj se përgjithësisht shkrimtari s'ka nevojë të jepë shpjegime. Së pari, se çdo shpjegim është një ulje për të. Së dyti, se sa herë më e thellë të jetë vepra e tij, aq më e pamundur është paraqitja e saj. Së terti, sepse në botën tonë, ftesa që i bëhet shkrimtarit për të dhënë shpjegime është baraz me **tërheqjen e tij** në një truall të pabesë, ku ai s'mund të shpresojë gjë tjetër, veç të goditet, veç në mënyrë të pabesë.

Shkrimtari është qenia më e brishtë, lehtësisht e cënueshme, por ai është njëkohësisht qenia më e pashkatërrueshme nga asgjë, madje as nga populli dhe epoka e vet, pra nga ata që e kanë pjellë.

Kur shkrimtari jep shpjegime ka gjithmonë një arsyе për këtë. Kur unë shkrova dy libra për të shpjeguar disa gjëra, e dija se kjo ishte një flijim, por dija gjithashtu se kjo duhej bërë. Kishte një arsyе madhore për këtë, arsyе që lidhej në radhë të parë me vendin tim. Kështu shpjegohet që dy librat e mi "Pranverë shqiptare" dhe "Pesha e kryqit" u botuan këtu në Paris prej shtëpisë botuese "Fayard" jo vetëm frëngjisht por edhe shqip.

Në pyetjen e mëparshme ju fola për orën e provës, të përbysjes së komunizmit që, të them të drejtën, unë kujtoja se do të binte pas vdekjes sime. Por ajo ra më parë.

Ne të gjithë e dimë ç'ka ndodhi pas rrëzimit të komunizmit. Ne e dimë se ç'pluhur u ngrit, ç'çoroditje u krijua, ç'llum i zi doli nga thellësitë e kësaj bote. Kjo rrokopujë e zbehu shumë shpejt

gëzimin e lirisë të porsafituar, dehjen e saj, ylberet e shpresave, që lindën e u fikën aty për aty.

Si të verbëra, masa të mëdha njerëzore nisën të vërtiten të shtyrë nga cikloni i urrejtjes, i shkatërrimit. Nuk ka gjë më të shëmtuar se kurajua e vonuar e frikacakëve, e skllevërve. Të ndërgjegjshëm se e kishin ulur kryet më fort se ç'duhej, të turpëruar për bindjen e tyre të gjatë, të tërbuar nga prania e të tjerëve, atyre që nuk ishin thyer, gjëja e parë që bënë ishte t'u suleshin pikërisht këtyre të fundit. Kështu në Shqipëri servilat e djeshëm, puthadorët e neveritshëm, denonciatorët, spiunët, vjedhësit e rëndomtë, dështakët, smirëzinjtë etj., të bashkuar nga një ishtikt shkatërrimi u përpinqën të prishin të gjitha vlerat, të kthenin kryengulthi parimet, qokat (pikat e referimit) gjithçka të shenjtë të kombit, duke mos kursyer as vetë gjuhën shqipe, që u rekën ta shpërbënин e ta ndanin prapë në dialekta. Kishin shpresë se kështu, në pluhurnajën e përgjithshme do të fshihej turpi i tyre.

Kur e panë se kjo punë po ecte shkuan edhe më tej. Duke mos u kënaqur me rrënimin e vlerave shpirtërore iu sulën ndërtesave, shkollave, madje drurëve. Pas kësaj nuk pritej veçse tmerri i fundit: t'i suleshin atdheut. Dhe ashtu ndodhi vërtet: pjesa më e llumtë e këtij zhgani u rrek t'i ngulte thikën në shpinë Shqipërisë. Çdo ditë e më e qartë bëhej thirrja e tyre: ç'na duhet ky vend i mallkuar, t'ia vëmë kazmën, ta rroposim. Me një pérulje të neveritshme përpëra mikrofonëve të gazetarëvë të huaj, ata villnin e villnin vrer kundër atdheut e kombit të tyre, iu bënин lajka

vendeve ku shpresonin të pranoheshin, ngulçonin nga padurimi. Të lodhur prej atdheut, duke e marrë atë si një kurth, një barrë të rëndë, që i pengonte të ishin të lumtur, ata shpejtonin të çliroheshin prej gremçit të tij. Ishin krejt si ata që i vënë zjarrin shtëpisë së tyre, me shpresë se bota do t'u japë një shtëpi të re, domethënë një tjetër atdhe.

E kam ndjekur me brengë dhe pezm këtë rënie. Asnjëherë s'kam besuar se cenet e kombit tim do të kishin po aq peshë sa edhe virtytet e tij. Në çastet e dëshpërimit kam shkuar gjer atje sa të dyshoj në se një pjesë e popullsisë shqiptare e meritonte këtë liri të ardhur kaq shpejt.

Frika e dikurshme, ankthi që më ishte dukur përherë i jashtëarsyeshëm: prishja e Shqipërisë po bëhej e njëmendtë. E kisha dyshuar këtë prishje prej forcave të jashtme, (s'ishin të pakta traktatet, doktrinat, promemorjet për ndarjen e Shqipërisë, me data, me vula, me emra -njëri prej të cilëve, për fat të keq, emri i shkrimit tarit nobelist Ivo Andriç), e kisha dyshuar prej sunduesve komunistë, (në çaste tërbimi ata nuk e fshihnin kërcënimin e tyre: askush të mos shpresojë ta gjelqojë Shqipërinë pa ne, në rast rreziku ne do ta hedhim atë në erë); por gjithsesi nuk e kisha pritur prej vetë shqiptarëve, madje prej tyre që hiqeshin si antikomunistë.

Në kushte të tillë, kur forcat më të shëndosha të kombit ishin si të mpira prej trysnisë së vulgut, qëndrimi im mënjanë këtij rrebeshi do të ishte i pafalshëm. Ashtu siç kisha bërë diçka të ngutshme me ikjen time më 1990, për ta troshitur diktaturën,

ashtu duhej të beja diçka po aq të ngutshme në kah të kundërt tani, kundër troshitjes së Shqipërisë.

Duhej qetësuar kjo shqotë e mbrapshtë. Duhej frenuar marrëzia dhe urrejtja. Duheshin sqaruar keqkuptimet dhe kryesorja, duhesin dhënë kumte shprese. Ishte kjo arsy që qysh në ditët e para të tronditjes së diktaturës, dy muaj pas ikjes sime në Francë, unë fillova serinë e intervistave, të cilat vazhduan një kohë të gjatë. Intervistat si dhe dy librat kishin të bënин në radhë të parë me problemet e përgjithshme të vendit, por natyrisht edhe me veprën time.

Lidhur me veprën, unë isha i ndërgjegjshëm ç'kisha krijuar. Stuhia atje në Shqipërinë e vogël nuk kishte ç'i bënte asaj vepre. Shumë-shumë, pas tre-katër vjetësh çdo gjë do të sqarohej, marrëzia do të kalonte dhe çdo gjë do të vihej në vendin e vet. Mirëpo unë nuk doja pikërisht që kjo çoroditje të vazhdonte tre-katër vjet. Për mua ato s'ishin asgjë, por për Shqipërinë kjo çoroditje, kjo humbje kohe do të ishte fatale. Sepse në çaste të tillë të rënda kjo vepër nuk ishte thjesht letërsi. Ajo ishte në radhë të parë faktor drejtpeshimi, një shestim, një shtampë, humbja, qoftë dhe e përkohshme e së cilës, do të trondiste krejt kulturën bashkëkohore shqiptare. Dhe tronditja e kulturës në raste të tillë do të ishte me pasoja tragjike.

Intervistat dhe dy librat e mi besoj se e luajtën rolin që shpresoja. Turma vulgare shkumbëzoi nga tërbimi, si çdo turmë kur ia thyen vrullin, por nuk fitoi dot. Unë nuk i bëra asaj lëshim. Njëri pas tjetrit ranë pararojat e kësaj turme: idhujt e rremë, që ajo i lëshoi në sulm: pseudodisi-

dentët, një pjesë e të cilëve s'kish qenë veç spiunë të policisë së fshehtë, shkrimtarë të dështuar, që s'prisin veç raste të tillë si shans të tyre të fundit, pleq të rrjedhur, që thoshin edhe nga një mashtrim të fundit përpara se të shkonin në varr, gjithfarë mashtruesish e rrugaçësh, që s'mungonin kurrë në kësi rastesh. (Njëri prej tyre, K.T.-i verbuar nga cmira, më 1971, fill pas botimit të "Gjeneralit" në Francë, në një shkrim të gjatë, deklaronte se Perëndimi më çmonte mua nga që isha agjent i tij, kryesisht i Francës).

Një farë pabesie e përgjithshme që u shfaq aty-këtu në Perëndim kundër shkrimtarëve të ish Lindjes u duk se do ndihmonte këtë valë të sëmurë. Ndodhën gjëra vërtet të turpshme. Mjafton t'ju kujtoj një shembull: në gazeten "Le Monde" më 1991 unë u sulmova prej një farë Nils Andersoni. Dhe a e dini se ç'ishte ky farë suedezi? Përkthyesi, botuesi dhe shpërndarësi i veprës së diktatorit shqiptar Enver Hoxha në Perëndim. Me fjalë të tjera, një agjent i komunistëve shqiptarë. Është e hidhur ta thuash, por kundër shkrimtarëve qëllon që i jepet fjalë gjithkujt.

E pafalshme është sidomos kur ca gjysmë shkrimtarë gjysmë gazetarë perëndimorë, të fryrë si gjela shkojnë në vendet e porsadala nga komunizmi, për t'i dhënë mend gjithkujt. Nuk i dëgjon askush në vendet e tyre, vuajnë nga gjithfarë kompleksesh, e pikërisht për t'i shëruar këto komplekse, këta çapaçulë kujtojnë se mund të sillen me kulturat e popujve të tjerë si me zulutë. Vihen në rolin e arbitrit, si kolonialistët dikur, rrëzojnë vlera, ngrenë vlera të paqena, kujtojnë

se mund të bëhen demiurgë, mashtrojnë pa pikë turpi, përfitojnë nga një kamera që kanë në duar, nga mosnjohja e këtyre vendeve, nga varfëria e tyre, nga kriza shpirtërore. Dhe si përherë preja e parapëlqyer e rrugaçëve janë shkrimtarët e shquar.

**A.B. - A duhet t'ju pyes për mërgimin tuaj?**  
*Letërsia botërore ka njohur mërgime të cilësive e të natyrave të ndryshme. Descartes u largua nga Franca pasi, nën mbretërinë e Luigjit të XIII, ajo i dukej e vogël, meskine e represive. Voltaire dhe Diderot gjetën si në Prusi edhe në Rusi, pallate më mikpritës dhe monarkë më të rafinuar se ata të Versajës. Victor Hugo nuk donte të jetonte në të njëjtin vend me Napoleonin e III: ai e dinte se disa kilometra larg brigjeve franceze në Jersey e me pas në Guernesey mërgimi do t'i shërbente famës së tij dhe do t'i shtonte një prestigj të pashoq figurës së tij politike e morale. Pa mohuar turpin që ata duruan, ne e pamë më vonë se sa i vlejti mërgimi Siniavskit e Soljenitsinit. Akoma më i keq, por pa dhimbje fizike, ishte mërgimi me dëshirë i Fitzgeraldit, Poundit e Eliotit. Ata parandjenin se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk donin të dinin për ta dhe nuk do të bënin asgjë për t'i kupltuar. Më flisni pra për mërgimin tuaj, që nuk ka shok në botë, meqë tashmë ju ktheheni rregullisht në Shqipëri ndërkokë që shkruani e jetoni në Francë. Kjo situatë, me të cilën ne sigurisht krenohemi, a do të mund të vazhdojë gjatë?*

**I.K.** - Në librin që kam shkruar për Eskilin, në faqet e fundit të tij kam folur për mërgimin e tragjedianit dhe të shkrimtarëve në përgjithësi. Ishte dimri i vitit 1985 dhe siç ua thashë më parë unë nuk e besoja se komunizmi do të binte në gjalljen time. Isha përpjekur dy herë të ikja nga vendi im, më 1962 në Pragë dhe më 1983 në Paris dhe të dy herët kisha hequr dorë në çastet e fundit. Kisha vendosur të vdisja në Shqipëri. I vetmi ngushëllim ishin dy librat: "Hija" dhe "Vajza e Agamemnonit", dorëshkrimet e të cilave shpresoja t'i nxirrja jashtë për t'ia besuar botuesit dhe mikut tim Claude Durand, çka edhe ndodhi me njërin prej tyre, siç ua shpejgova më parë. Së paku, në rast vdekjeje, diktatura nuk do të mund të abuzonte me emrin tim më shumë se një javë. Claude Durand, i cili kishte çelësin e kasafortës ku ishte vënë dorëshkrimi, do ta tërhiqte atë dhe para se ta përkthente me ngut do të bënte një deklaratë përmbytje e tij.

E dija mirë çishte tortura e një vendimi për të ikur. Terrori mbi familjen, mbi të afërmit, mbi krejt inteligjencien. Rreziku i keqkuptimit me popullin tënd, i cili ikjen tënde mund ta merrte si braktisje. Vetë dëshpërimi yt, prej të cilit s'kishe si të ikje.

Kisha parë dështimin e ikjes së shkrimtarit sovjetik Anatoli Kuzniecov, të cilin e kisha njojur në institutin "Gorki" në Moskë. Them dështim sepse ajo ikje jo vetëm që as nuk e gërvishi regjin sovjetik, por u kthyen kundër shkrimtarit. Siç e dini, Kuzniecovi nuk dëshmoi asgjë serioze në Perëndim dhe vdiq, me sa duket nga dëshpërimi.

Një shkrimtar shqiptar jo pak i njohur dhe me mjaft talent Bilal Xhaferri, iku më 1967 në SHBA. Pak a shumë i njëjti fat si i Kuzniecovit. Asnjë vepër kundër diktaturës shqiptare, asnjë dëshmi serioze kundër saj, së fundi vdekja nga sëmundja, e shkaktuar, me sa dukej, prej dëshpëritimit.

Gjithmonë po bëhej më e qartë se sa më i egër të ishte regjimi, aq më e vështirë ishte ikja. Regjimet e egra u ngjanin vrimave të zeza që s'lëshonin asgjë. Veç kësaj, ikja mund të ishte e dobishme vetëm kur bëhej në kohën e duhur.

Kur për herë të tretë vendosa të ikja, në maj të vitit 1990, isha i bindur se ishte koha. Shqipëria lëkundej midis diktaturës dhe liberalizmit. Peshorja mbetej e palëvizshme. Duhej një shtysë për ta rënduar njérën anë të saj. Një shtysë e fortë, e ngutshme, tronditëse. Shkurt, më duhej një mikrofon për të bërë një deklaratë që të dëgjohej nga gjithë Shqipëria dhe nga gjithë botë. Këtë mikrofon s'mund ta gjeja veç në Paris.

Nuk e di në se ikja ime mund të quhej mërgim. Isha i bindur se ishte e përkohshme. Në çdo frazë të deklaratës sime të parë, të letrës që i dërgova shtetit shqiptar, të deklaratave të tjera, dilte fare qartë një gjë: përkohshmëria e ikjes, shpresa se shteti shqiptar do të sprapsej përpara demokracisë, pa katastrofë dhe gjak. I kisha mbetur besnik idesë dhe iluzionit tim të hershëm se, përpara kërkimit të sensacionit, duhej kërkuar një zgjidhje shpëtimi.

Ju e dini ç'ndodhi pastaj. Unë u shpalla tradhtar. Gjithë Shqipëria u traumatizua. Librat e mi u ndaluan. Ndërkëq për të më ndaluar mua

duhesin mbyllur bibliotekat, duhesin ndërruar programet shkollore, duhesin bërë mijëra mbledhje sqaruese. Pikërisht në këto mbledhje makina totalitare pësoi një ngecje. Dicëka nuk po ekte si dikur. Njerëzit ose heshtnin ose shfaqnin dyshimin se si mund të shpalaj tradhtar një shkrimtar kombëtar. Në konferencën kombëtare të shkrimtarëve të rinj që po zhvillohej ato ditë në Korçë, shkrimtarët e rinj refuzuan të më dënojnë publikisht. Ishte mosbindja e parë publike ndaj diktaturës. Për herë të parë u ndje se ç'forcë mund të ketë arti. Dhe këtu ndodhi ajo që më parë as që mund të mendohej. Për herë të parë shteti komunist bëri një tërheqje. Pas dy javësh, ndalimi librat e mi u lejuan prapë. Kjo ishte një gjë gjithsesi e papërfytyrueshme: unë vazhdoja të quhesha tradhtar, ndërsa librat lejoheshin. Pra lejohej leximi i një kundërshtari. Në botën komuniste kjo ishte shenjë e një thyerjeje të madhe. Vetëm të verbërit mund të mos e kapnin. Dhe njerëzit e kapën kumtin: kjo diktaturë nuk ishte aq e tërëfuqishme sa ç'dukej. Ajo mund të prekej... Në dhjetor filloi lëvizja e studentëvë. Pa u mbyllur viti u krijua opozita. Në shkurt u përmbysh shtatorja e diktatorit. Një vit më pas, më 22 mars, në një ditë me dëborë, ndodhesha në një mbledhje shkrimtarësh në Munich, kur drejtuesi i seancës, përparrë se ta hapte mbledhjen tha: Dhe tani kam një lajm të mirë për zotin Kadare dhe për të gjithë: opozita i fitoi zgjedhjet e lira në Shqipëri. Në maj, ashtu siç kisha premtuar, u ktheva në Shqipëri.

Mërgimi im nuk vazhdoi veçse një vit e

gjysmë. Ai ishte vërtet i përkohshëm.

**A.B.** - *Ju largoheni nga dekorë ballkanik. Vepër juaj, me një libër të rëndësishëm, serioz, të pazakontë dhe aspak të lehtë, "Pallati i ëndrrave", rrok atë çka në letërsinë bashkëkohore, është thelbësore, më shumë se kurrë padyshim që prej apetiteve të mëdha të Rilindjes së shqetësuar për afirmimin e njeriut, atëhere kur, nga Vjena në Lisbonë e nga Stokolmi në Catanë zvogëlohej mjaft imazhi tiranik i Zotit: e kam fjalën për përparësinë e parabolës me shumë kuptime e shumë enigma. Ju e ndjeni këtë me bindje: në të kundërt me shekullin e XIX tmerrësisht i kapshëm e didaktik - tek Balzaku, Dikensi, Tolstoi - shekulli i XX është më kërkues e nuk përkulet para asnjë të vërtet që mund të përligjet nga vlera jashtë letrare. Kështu ndodhë me Servantesin, me Faustin e dytë, me Gogolin dhe para treçerek shekulli me paraprijësin tuaj të pakundërshtueshëm, Kafkën. "Pallati i ëndrrave" është historia paralele e dy diktaturave ose, po të doni, e dy tiranive shpirtërore që mund të janë po aq të brendshme sa dhe të jashtme për individët, njëherazi zotërit dhe viktimat e tyre. Një regjim politik i organizuar me kujdes-në mënyrë që të mos i lejojë askujt sado pak kohë të lirë i terrorizon shtetasit me një hierarki të pamëshirshme. Në këtë Babel milingonash njerëzore, duhet që secili të ketë vendin e tij me shpresë që do të meritojë një ditë një promocion shoqëror po aq ndrydhës sa gjendja aktuale. Ne jemi kudo që do të dëshironi: vendi i kampeve të punës, vendi i gullageve ose një Utopi ku lumturia ekziston vetëm në regjistra. Ky vend nuk përcaktohet*

*as në hartë e as në kohë. Do të gabonim në se do ta identifikonim me Shqipërinë apo me ndonjë pjesë tjetër të universit. Përveç ligjeve të veçanta për të gjitha burokracitë e padurueshme, ai ka veçantinë e tij: shtetasi është i detyryar të sjellë ëndrrat e tij. Ato pastaj seleksionohen, klasifikohen, skedohen. Disa janë të parëndësishme apo jo shumë të qarta për të merituar ndonjë analizë, të tjera përputhen me kategori të përcaktuara për të cilat ekzistojnë tashmë parrulla e mënyra përdorimi. Heroi i romanit është një farë M.K. që në vend që të jetë faktor, e di që nuk ka qenë i tillë në fillim por që mund të bëhet pas çdo hapi, pas çdo fjalë. Ai është caktuar të punojë në Pallat, ku analizohen ëndrrat e bashkështetasve të tij. Sipas kompleksitetit të tyre ëndrrat kanë privilegjin të interpretohen nga kati në kat e më të vështirat meritojnë vëmendjen e funksionarëve të lartë. Ëndrrat më interesante- apo ato më shqetësueset -qëndrojnë në kulmin e Pallatit.*

*Megjithatë nuk është kaq e thjeshtë. Sa më shumë që ato duken të denja për një analizë gjithnjë e më komplete, aq më shumë ke të bësh me ëndrra të rrezikshme për faktin se ato janë - ose mund të janë -paralajmëruese. Një profeci e çuditshme kërkon që regjimi të bjerë për shkak të një ëndrrre të tillë. Kush do ta ëndërrojë e kush do të ketë guxim ta zbulojë e ta tregojë? Heroi duhet të dridhet nga frika pasi një ditë ai do të jetë instrument i kësaj katastrofe të së ardhmes. Të pranohet ëndrra e tij do të thotë të pranohet një vdekje e mundshme e tij. S'ka gjë më thelbësore se denoncimi i kësaj hierarkie burokratike që*

*mbretëron në një lloj terrori të fshehtë ku nuk shihet as mizoria më e vogël. Shpirtërat, ata vetë, e dinë se ndiqen.*

*Diçka e çuditshme dhe krejtësisht e re në letërsinë botërore është fakti që ju denonconi jo vetëm këtë lloj organizimi masash deri në mendimet e saj - duke mos e mishëruar kurrë këtë diktaturë në një rajon që mund të diktohet - por ju denonconi shfrytëzimin e ëndrrave, pra të supertacioneve. Tek ne, pas gjermanëve që i përkisnin brezit të ekspresionistëve, në veçanti Alfred Kubin, duke filluar nga 1912 - me kryeveprën e pakundërshtueshme "Ana tjetër" - janë surrealistët ata që përbysën hierarkinë e vlerave duke mburrur shfrytëzimin sistematik të ëndrrave. Realitetit borgjez, që prej 1924-ës dhe manifestit të parë të surrealizmit - kur kartezianizmi ishte në fitore të plotë siç mishërohet pas traktatit të Versajës, tek Georges Clemenceau dhe Raymon Poincaré-surrealistet i kundërvënë pafajsinë dhe pastërtinë e ëndrrës. Socializmi i tyre ishte një socializëm i përfaqësuar nga ëndrra, gjumi e papërgjegjësia e jetës së përditshme. Në realitetin e vështirë, i cili e kthen çdo qytetar në një skllav potencial, ju nga ana juaj nuk i kundërviheni ëndrrës, ajo gjithashtu sipas jush është fajtore nga që devijon njeriun. Ju duket se thoni njëkohësisht: "as reale, as ireale"; indirekt, për ju, kjo është pothuaj një parrullë. Meqë ëndrra përban në vëtvete diçka ideale, ju duket sikur dënoni çdo mundësi iluzioni. Ç'është ajo në fakt për ju?*

**I.K. - Kur kam dëgjuar për herë të parë**

titullin e një libri "Historia e fshehtë e mongolëve", më ka tërhequr kaq fort saqë nuk e kërkova librin nga frika se mos zhgënjejesh. Edhe sot nuk e kam të qartë nëse gjendet vërtet ky libër. Por në se nuk jam i sigurtë për këtë, për një gjë tjetër jam krejtësisht i sigurtë: leximi i librit s'mund të ishte veçse zhgënjes në krahasim me atë çka ka nxitur në trurin tim titulli i tij.

Ç'mund të dëshmohej në historinë e fshehtë të mongolëve? Dhe kryesorja, si mund të shkruhej, e aq më tepër si mund të egzistonte një libër i tillë? Thuhej se ishte veç në një kopje, se shume herë e kishin kërkuar në stepat mongole, se gjurmët e tij kishin humbur në kushedi ç'manastire budistësh.

Mendimi se ekzistonte ndërkaq një histori e fshehtë e njerëzimit, më ka munduar një kohë të gjatë. Një histori e fshehtë e brendshme, e parrokshme, pa të cilën historia që njohim ne, ajo e rrokshmja, e jashtmja, s'është veç një zhguall që mbështjell zbrazëtinë.

Një përfitim i tillë s'ka patur të bëjë me ndonjë metaforë, me ide mistike e as me përfytyrimin frojdist të varësisë së vetëdijes sonë prej nënëvetëdijes etj.,etj. Jo, unë e mendoja historinë e fshehtë të njerëzimit si diçka që egzistonte në vetvete pavarësisht se as syri, as mendja jonë nuk e kapte dot. Ishte e ngjashme pak a shumë me thellësitë ku shtresat e karbonit nën tokë shtypin njëratjetrën, me qendrën e diellit ose vrimat e zeza.

Më pas kam menduar se letërsia, me sa duket, ka lidhje me historinë e fshehtë të njerëzimit. Siç ua thashë më parë gjithmonë më ka cytur fantazinë ajo që e kam quajtur kalendar i dytë i

shkrimtarit. Ky kalendar, që s'përputhet fare me kalendarin tjetër, atë që e jetojmë të gjithë bashkërisht, është, me sa duket, një nga mekanizmat e historisë së fshehtë. Falë këtij kalendar letërsia mund të jetë mospërfillëse për ngjarje ose objekte që janë vendimtare për botën si p.sh. shpikja e elektricitetit, vetë dielli, fluturimet kozmike, zbulimi i kuanteve ose zbulimi i Amerikës prej Kristofor Kolombit. Në rastin e këtij të fundit, më ka habitur p.sh. fakti që ndonëse ai duhet të ketë tronditur globin tokësor më shumë se gjithka në atë kohë, (mendoni që globi u dyfishua papritur), e ndonëse pas asaj ngjarjeje erdhën në botë dy nga gjenitë më të mëdhenj të letërsisë, Shekspiri me Servantesin, (të dy në moshën rreth 30 vjeçare) asnje gjurmë e tij, madje asnje radhë nuk gjendet në veprën e tyre. Ndërkaq udhëtimi i një të marri me emrin Don Kishot, udhëtimi i pavlefshëm, qesharak i një të lajthituri absurd nga një fshat i Spanjës në një tjetër fshat të Spanjës, jo vetëm tërhoqi vëmendjen e letërsisë, por e nguci atë të jepte një nga kryveprat më madhështore të të gjithë kohrave.

Kam menduar se datat dhe hierarqitë e tjera me të cilat vepron letërsia përkijnë ndoshta me ato të historisë së fshehtë. Në asnje histori, në asnje enciklopedi sado të gjërë nuk gjendet e as nuk mund të gjendet p.sh. koha e zbulimit ose e shpikjes së ferrit, e aq më pak koha e zbulimit, (ose e shpikjes) së vrasjes së ndërgjegjes, e kështu me radhë. Mirëpo këto data janë aq themelore për letërsinë sa ç'janë të parëndësishme shpikja e makinës me avull, aeroplani ose vetë dielli i

madh. Prej diellit kemi lindur e prej tij do të shuhemi të gjithë, megjithatë, po të hamendësonim ndalimin e përmendjes së diellit në letërsi, (besoj se m'i falni pandehma të tillë nga që unë vij nga një botë ku ndalesat, ishin një gjë e natyrshme), ju do të jeni në një mendje me mua se letërsia botërore nuk do të humbte ndonjë gjë të madhe. Por mendoni për një çast ndalimin e diçkaje tjetër, ta zemë të një gjëje të keqë, të padukshme, të errët: vrasjes, dhe do të shihni se ç'katastrofë do të ndodhë. Gjysma, në mos tre të katërtat e letërsisë së madhe botërore do të binte: do të rrëzoheshin së pari krejt tragjikët grekë, do të binte pjesa më e fortë e Homerit, e Ungjijve, Dantes, pjesa më hyjnore e Shekspirit, pothuajse krejt Dostojevski, e kështu me radhë gjer te Kafka, Borgesi, Markezi, që do të varfëroheshin dukshëm.

Shkrimtari, në një mënyrë ose në një tjetër është i lidhur me historinë e fshehtë të botës. Për të brumi i botës, ai brumë si prejëndrre, siç thotë një personazh i "Stuhisë" së Shekspirit, është i natyrshëm. Nëqoftëse mendja dhe syri i shkrimtarit nuk e përftojnë dot botën si të tillë, të gjithsejtë, në qoftë se ata i acaron çdo këmbim i pejsazhit, çdo kalim nga bota e rrokshme tek ajo e parrokshme, nga ëndrrat te njëmendësia, nga mbretëria e vdekjes te ajo e jetës dhe anasjelltas, është mirë që ai të heqi dorë nga kjo punë.

Për të shkruar "Pallatin e ëndrrave" përveç përparësisë së mësipërme, që besoj se kanë shumica e shkrimtarëve, unë kisha një tjetër përparësi: botën komuniste. E shpallur kundër fesë, misticizmit, magjisë, parandjenjave, e zoterizmit, onirizmit

etj.etj., për çudi, kjo ishte bota që më së shumti se çdo tjetër punonte pikërisht me shenjat mistike.

Në asnjë rend tjetër diktatorial nuk ka patur një rrezatim valësh të ndërsjellta midis tiranit dhe popullit, se sa në vendet komuniste. Molisës, acarues, që të fuste datën, që të sillte gjumë, që të dehte, të zhdehte, të humneronte krejt, kjo s'ka rëndësi. Rrezatimi i përfshinte të gjitha këto ndaj dhe ishte zotërues.

Ju e dini Kalkantin, falltarin e famshëm, i cili me anë të shenjave kapte kumtet e hyjnive dhe i mësonte grekët ç'duhej të bënин gjatë fushatës së Trojës. Është një nga personazhet më të çuditshëm në letërsinë antike. Është aq i shumëfytyrtë dhe i papritur në paralajmërimet e tij, që s'kuptohej mirë nëse i shërbën njerëzve, hyjnive, grekëve apo kundërshtarëvë të tyre, saqë Shekspiri e quajti më të logjikshme ta merrte për renegat trojan, domethënë të linte një fije dyshimi se mund të ishte agjenti i tyre i futur te grekët për çoroditje, apo intoks, siç thuhet tani.

Nuk e teproj aspak po t'ju them se asnjëherë në botë Kalkantët nuk kanë qenë kaq të shumtë se në gjithësinë komuniste. Ishin me dhjetëra mijëra, ndoshta me miliona, që përpinqeshin ditë e natë të kapnin kumtet që "vinin nga lart", nga Byroja Politike e Partisë ose vetë tirani.

Në një trajtesë për legjendat jam përpjekur të shpjegoj se ç'llahtarë fshihej pas frazave të tillë, në dukje të rëndomta si "qortim" (korregjimi) i stilit, ose "trajtim subjektivist i historisë në letërsi" etj. Mund të fillonte një fushatë spastrimesh gjatë së cilës dhjetëra mijëra njerëz mund të

burgoseshin, të torturoheshin, të pushkatoheshin, shoqëruar nga ankthi i një populli të téré. Siç e shihni, fjalët "qortim stili" s'kanë të bëjnë fare me tmerrin që fshihet pas tyre. Ato s'janë veçse shfaqje paralajmëruese të diçkaje tjetër.

Më kujtohet një thënie e Çu En Lait: "Doni të kuptoni politikën e jashtme kinez? Shkonë në theatrin kinez".

Kam qenë vetë në shfaqje të tilla më 1967 në Pekin, ku me anë të shenjave dhe simboleve jepeshin udhëzimet dhe "përcaktohej vija politike". Aty në sallë, nga lëvizja e balerinave, e gjarprit mitik, apo nga gërshetimi i ngjyrave, mund të kuptoje nëse Komiteti Qëndror do të spastrohej javën e ardhshme apo të rrëzohej krejt prej Maos.

Në Shqipëri një valë terrori e pasembullt që vazhdoi tre vjet e që shkatërrroi dhjetra mijëra fate njerëzish nisi pikërisht nga një sallë koncerti, ose më mirë nga fustani i gjatë i një spikereje në një sallë koncerti. Një letër e ardhur nga një fshat i largët e paralajmëroi diktatorin shqiptar për rrezikun e madh që kërcënonte shtetin. Shkruesi i letrës e kishte pikasur të keqen pikërisht te fustani i gjatë i spikeres...

Siç e shihni, jeni krejtësisht në botën që kam përshkruar te "Pallati i ëndrrave". Shtoni kësaj edhe thirrjen që i kishte bërë tirani shqiptar gjithë shtetasve që, me anë të letrave, qoftë edhe anonime, të paralajmëronin për rreziqet e mundshme, dhe do ta kapni krejtësisht klimën e këtij libri.

Perveç mbikqyrjes prej shtetit të gjumit njerëzor, pra të pjesës më të pambikqyrshme të njeriut, në këtë roman kam dashur të prek zona

më të ndërlikuara, duke shtruar p.sh., pyetjen se cila botë kontrollon tjetrën dhe sidomos një çështje pothuajse tabu, sidomos për ne shkrimtarët e Lindjes, fajësinë e popullit.

*A.B. - Një nga librat tuaj më të fundit, me rëndësi të pamohueshme e ambicje të mrekullueshme - flas deri për ditën kur unë po shprehem, pasi e di që ju po bëheni gati të botoni të tjerë -titullohet "Piramida". Ai është fare i ri. Edhe aty, ju jeni larg Shqipërisë tuaj të lindjes dhe përdorni me zell një formë alegorie që mund të kuptohet në shumë mënyra të ndryshme. Ju kërkoni vazhdimisht të çorientoni lexuesin e mesëm duke kombinuar tema me principe të papajtueshme. Kemi atje së pari një roman historik, që në një farë mase mund t'i ngjaje Salambos së Floberit, me kusht që të mbahen parasysh se sa të kota e sipërfaqësore janë rindërtimet historike. Ju vini në skenë një faraon të shquar, të cilit i huani ndjenja që padyshim nuk janë të tijat. Ju e modernizoni atë. Është një i ri që kërkòn e pyet mbi zakonet e lashta të vendit të tij e sidomos të kastës së tij. Çdo faraon ndërton piramidën e tij: pas vdekjes atje do të mbyllët kufoma e tij e ai do të kalojë përjetësinë sipas riteve të forta e të pathyeshme. Faraoni juaj është një i ri i sertë dhe i shqetësuar. Ai shkon në kërkim të burimeve të vjetra. Përse ka lindur në të kaluarën nevoja e ndërtimit të një piramide? Ai zbulon një përgjigje të dhimbshme: kjo traditë është forcuar në periudha të turbullta. Një mënyrë për ta bërë*

*turmën tē harrojë jetën fatkeqe e tē punojë pér diçka tē padobishme. Faraoni nuk arrin ta bindë rrethin e tij: ndërtimi i një piramide është i domosdoshëm pér Perandorinë dhe pér lavdinë e dinastive tē njëpasnjëshme. Ai ka karakter tē vështirë. Më nē fund, mjaft i nxehur, ai pranon vështirësitë e kësaj detyre: do ta ndërtojë pra piramidën, por ajo do tē jetë më gjigandja dhe më e kushtueshmja. Kërkohet prej tij që ajo tē jetë, nē një farë mase, e përjetshme; ajo do tē jetë, e tillë me tejmasën e saj. Përgatitjet janë tē gjata, pasi duhet t'i jepen projektit tē gjitha siguritë e realizimit. Për tē ndërtuar një piramidë përbindështë kërkohen procese tekniqe para tē cilave zbrapsen shumë inxhinierë dhe arkitektë. Më pas, punimet ngjallin admirim. Megjithatë aty këtu ndodhin aksidente, ku ta dish, ndoshta sabotime. Populli vuan; mund tē imagjinojmë vuajtjet e ndërtuesve tē kullës Babel apo më afér nesh ata tē katedrales së Chartres apo Bourges. Kërkohet medoemos tē ushtrohet një mbikqyrje, njëherazi mbi ndërtuesit dhe mbi popullin. Rrëshqitet drejt diktaturës, me një ose dy policë, detashmente spiunësh, por ndoshta edhe komplotues tē cilët, përtej Piramidës, synojnë Shtetin. Mbarë Egjipti ndodhet në rrezik. Disa aksidente nuk mund tē spjegojen; një pjesë muri, një skelë, një suvatim, mund tē bien pa asnë arsyë dhe madje pa iu përgjigjur ligjeve tradicionale tē gravitetit. Parabola ngrihet në nivelin e ireales. Jemi pikërisht në epokën e një përcaktimi tē ri tē materies, çka është një risi që i detyrohet kësaj ngjarjeje pa precedence: Hiroshimës. Materia dhe objekti kanë*

*tashmë të drejtën e qytetarisë në kujtesën tonë ku nëse flitet në vlerë absolute, ato vlejnë po aq sa edhe qënia njerëzore. Në emër të këtij parimi, piramida, pavarësisht nga vullneti i faraonit apo i popullit të tij, mund të jetojë një jetë të pavarur prej tyre. Cilatdo qofshin komplotet që thurren rreth saj, në fund të fundit, në emër të gurit e të së vërtetës së tij ajo do të jetë ashtu siç ajo pret të jetë. Njeriu nuk luan asnje rol në fatin e gurit, edhe pse ka marrë iniciativën t'i japë atij një destinacion. Piramida do të çlirohet prej tij, dhe po të dojë, do të transformohet, p.sh. në kristal. Planeti është më i vjetër se njeriu dhe do të jetojë pas tij. Njeriu mund, të paktën, t'i huajë mendime që nuk varen nga ai vetë. Kjo dialektikë mund të ndryshojë: ajo nuk është e qartë përtej shkëlgimit të tmerrshëm dhe fabulës. A keni menduar për vepra të tjera me karakter mitik në të kaluarën? A do të donit të shkëputeshit për pak kohë nga realiteti letrar i kuptimit? A kishit nevojë për ndriçim, në kuptimin rimbaldeian, ose, për një dimension faustian, në kuptimin goetian? Sa kohë ju është dashur të mendoheshit për një temë kaq të rëndë dhe kaq kërkuese? A nuk u habitët ju vetë për suksesin që kjo vepër pati në Francë, në këtë vend që në mënyrë të veçantë nuk e kupton këtë lloj fantazmagorie superiore? Më duket se bashkë me "Pallatin e èndrrave", "Piramida" është një nga veprat tuaja që do të ngjallë më shumë komente njëherazi letrare, sociale dhe filozofike dhe në të njëjtën kohë do t'i shpëtojë keqkuptimeve sepse radhitet në kategorinë e librave të pavarur nga koha e vendi i formimit. Parabola që bashkon*

*të arsyeshmen më të paarsyeshmen, është e vërtetë, haset mjaft rrallë në shekullin tonë. Kam cituar tashmë pak më parë një libër të këtij lloji, por që ndoshta nuk është tamam i barabartë me tuajin: "Ana tjetër" e Alfred Kubinit. Është gjithashtu libri "Nën vullkan" i Malcolm Loëry, vepër e pakapshme dhe për mendimin tim, mjaft somnambule. Dhe kemi sidomos "Kështjellën" dhe "Procesin" e Kafkës në fund të zbuluar tani vonë, "Mjeshtri dhe Margarita" e Mikhail Boulgakov. Franca mungon në këtë thirrje që i bëhet ireales, të paktën gjatë shekullit XX. Nëse do të kërkonim akoma më parë, do të gjenim "Udhëtim në fund të natës" e Louis Ferdinand Celine, por aty psikologja e revoltuar dhe antiborgjeze është mbizotëruese dhe në gjuhë argotike e cila nuk do të mund të synonte universalen. Përkundrazi "Dashuri e çmendur" e Andre Bretranit që bashkon èndrrën e ekstrapolimin përtej të kuptueshmes, i ngjan një demostrimi e një manifestimi të datuar mjaft mirë sot. Piramida për mua është një libër i pakorigjueshëm e i pakundërshtueshëm.*

**I.K. -** Jam vërtet larg nga Shqipëria duke u marrë me një piramidë? Mendoj se në asnjë vend tjetër (e aq më pak po të jetojë në Egjipt) nuk do ta shkruaja librin për piramidën egjiptiane.

Të shkruarit e tij vazhdoi diçka më shumë sesa vetë ndërtimi prej Keopsit. Kjo nuk është një metaforë. Një vjershë të titulluar "Piramida e Keopsit" e shkrova dhe e botova më 1967. Më 1986-1988 shkrova me një farë nguti një trajtë të parë të romanit. U përpoqa të botoj një kapitull

të tij në revistën "Nëntori", por ai u refuzua, si i dyshimtë. Më 1991 gazeta e parë e opozitës antikomuniste në Shqipëri "Rilindja Demokratike", qysh në numrin e saj të parë e botoi dorëshkrimin, të cilin ua kisha lënë miqve, me vazhdim. Më 1992 romani u botua i plotë në frëngjisht në Paris. Dy muaj pas botimit zbulova se kishte një cen në ndërtim. M'u duk se barksonte diku nga mesi. Arrita ta meremetoj dhe më 1993 doli botimi përfundimtar në shqip dhe në frëngjisht prej shtëpisë "Fayard".

Kjo është kronika e jashtme e ndërtimit. E brendshmja, si çdo histori e brendshme është me e ndërlikuar.

Vjersha e vitit 1967, e cila fillonte me vargun "Me gurë të mëdhenj harrimi desh të shtypte Keopsin", ishte një vjershë për gënjin e lavdisë, për atë që si Keopsi nga maja e piramidës nuk e arriti dot të sodiste lavdinë e vet, por "qytete tona moderne me antena dhe mjegull" dhe, më e hidhura e të gjithave, mumjen e tij të mjerë, që ne, njerëzit e shekullit XX mund ta shihnin në muze duke paguar fare pak para.

Sic e shihni, një ironi për sunduesit, ironi që mund të dukej disi e pafalshme, por që përligjëj në atë kohë prej frysës kundërshtetërore, e lejueshme për kohën, e përshkonte vjershën.

Ndërkaq, duke shkruar këtë vjershë, kisha patur përherë ndjesinë se ajo nuk ishte veç një stërkalë nga ajo çka kisha në kokë. Piramida, ashtu si urat ku ishin bërë flijime, si kulla e Babelit, si kali i Trojës, si Muri i Kinës, hynte në ngrehat e mëdha të njerëzimit, që më tërhiqnin

prej kohësh. Ato më shkaktonin atë trazim që të ngucin spikamat e parrokshme të një ngrehine ose ideje, përmasat e së cilës i shpëtojnë mendjes tënde.

Qysh më 1965, në Romanin "Përbindshi" e kisha vënë kalin e Trojës në varësi me piramidën, por e ndieja se kjo e fundit ishte diçka e madhe, madje më e ndërlikuar se kali i famshëm, të cilin gjithashtu e kisha sjellë "të kundronte qytetet tonë moderne"...

E ndieja se piramida ishte e shumëfytirshme dhe me kuptime të fshehta të ndryra brenda saj, më thellë se sarkofagu i faraonit. Një nga kuptimet e saj e kishte zbuluar në fund të shekullit XIV mongoli Timur Leng, kur kishte ngritur pranë Ispahanit piramidën e parë me koka njerëzish. Pra piramida hante koka njerëzish. Ky kuptim ishte çuar në kufijtë e skajshëm prej kërpudhës atomike të Hiroshimës, ku piramida ishte shfaqur në formë tymi të zi dhe që për disa çaste, kishte shfarrosur më shumë jetë njerëzore se gurana e Keopsit gjatë njëzetë viteve.

Ishte pa dyshim një shtrigë që mund të përhihej me pamje të re në çdo kohë. Që ajo ishte e pranishme në botën tonë komuniste unë e ndieja, por ende s'e rrokja dot qartë: Në një reportazh për një nga hidrocentralet tona të veriuat në vitin 1977, duke përshkruar digën, unë shkruaja se ajo ishte më e fortë sesa piramida, meqenëse gurët e piramidës, të hedhura në vend të saj do të shpartalloheshin prej furisë së ujërave brenda disa orësh.

Sic e shihni, krahasimi i pyramidave me

digat e ndërtimit e vepra të tjera të bujshme të socializmit ishte ndërkaq i pranueshëm në Shqipëri. Zhgënji i prej këtyre ndërtimeve të mëdha do të qortonte ndërkaq mjaft gjëra në mendjet tonë, gjersa të vinim në përfundim se këto ndërtime të bujshme ishin aq sfilitëse saqë vështirë se mund të quhen në dobishme. Në romanin "Koncerti" më 1981, krenaria e këtyre "veprave të mëdha", kombinati metalurgjik i çelikut është quajtur haptaz një gërmadhë, madje një gjë mytëse përvendin.

Sic e shihni, shkallë-shkallë unë, po i afrohesha zbulimit të kumtit të brendshëm, të fshehtë, të piramidës, ai që mund të quhej "piramida sipas pikëpamjes komuniste".

Si një shkrepëtimë kjo ndodhi në vitin 1986, kur në Tiranë filloi projektimi e më pas ndërtimi i muzeut-mauzole të diktatorit të vdekur. Qysh në ditët e para që u quajt prej të gjithëve "piramidë". Ashtu si Byroja Politike do të fillonte të quhej Olimp e diktatori vetë, Zeus.

Rrallë kishte ndodhur që një simbol apo një metaforë të rrezatonte kështu, njëkohësisht të njëjtin kuptim, në trutë e dhjetëra mijëra njerëzve. Kjo dëshmone se ideja që bota antike, të cilën unë e kisha sjellë aq shpesh në veprën time, ishte e afërt me gjithësinë komuniste, nuk ishte një pjellë intelektualiste, as figurë poetike, por njëmendësi, realitet).

Piramida u ndriçua në një pamje të plotë në mendjen time. Shtrigës i ra veli i fundit. Ajo kishte qenë përherë midis nesh. Ato qindra mijëra bunkerë të shpërndarë nëpër gjithë vendin nuk ishin veçse pjellat e saj. Dhe ato komplotë të

paqena, ajo shtypje që të merrte frymën, ai ankth e ajo shterpësi e jetës.

Duke shkruar librin e ndieja se piramida mund të kishte pamje të tjera, ajo ishte shfaqur në formë kristali ndërkaq në Paris e, mund të shfaqej në trajta të tjera në këtë planet të shqetësuar. Por unë dhashë motërzimin tonë komunist. U nisa pra, nga sipërfaqja e kohës sonë për të zbritur në thellësi, e jo të ngjitem nga thellësia drejt se sotmes. Kisha bërë pak a shumë këtë zbritje më 1965, kur kali i Trojës, më shumë se idenë e tradhtisë së brendshme, aq e parapëlqyer prej komunistëvë, kisha theksuar një tjetër ide, atë të ankthit e të terrorit shtetëror. Kalin e drurtë e kisha përshkruar si një trysni e përhershme, që rrinte me vite në horizont të jetës sonë, për t'i shtypur shpirrat tonë.

I ishashmangur kështu gabimit të Floberit kur shkroi "Salambonë". Më vjen keq të përmend fjalën "gabim" për një shkrimtar që e adhuroj. Aq më tepër që unë mund të mos kem të drejtë. Megjithatë jam i bindur se sikur një çast dyshimi, një çast gjenial mëdyshjeje, do ta pengonte Floberin ta shestonte ashtu siç e shestoi "Salambonë" do të ishte më mirë për të dhe për letërsinë. Ajo që unë mora guximin ta quaj thjesht e ndoshta në mënyrë disi naive "gabim" është ajo mënyrë njëjësimi (identifikimi), që përpinqet të bëjë shkrimtari me personazhet e një kohe të shkuar, me optikën, psikikën e deri me gjuhën e kësaj kohe. Kjo mënyrë, e përdorur nga qindra shkrimtarë, jep përshtypjen e një farë autenciteti e besueshmërie, por në fund të fundit kujt i duhet kjo besueshmëri?

Letërsia pikërisht atje dobësohet, kur i vihen pasqyra krahasuese. Jam i bindur se mënyra e kundërt me atë të Floberit, ajo që do ta quaja "zbritje të Dantes", pra përshkrimi i ferrit sipas optikës së "sipërme" të kohës që jeton shkrimtari, mbetet e vetmja manyrë mëdhore në art.

Dikush mund të pyeste: e meqenëse as koha në të cilën jetoi Floberi e as Franca vetë nuk kishin ndonjë vartësi, ndonjë komunikim të fshehtë me kohën e Salambosë e me Kartagjenën, me fjalë të tjera, as rrëthimi i Kartagjenës prej mercenarëve të vet, (me sa di unë Franca nuk është kërcënuar ndonjëherë prej legionit të saj të huaj!), e as krejt fryma që sundon në vepër, nuk lidhet me ndonjë trazim të Francës, atëherë ç'të bënte Floberi? Të mos e shkruante këtë vepër?

Zoti më ruajtë nga një mendim i tillë. Për mua krijimi letrar është i shenjtë dhe përpara tij, kur është fjala për gjallimin e tij, ndalem si përpara një shenje të shenjtë. Qoftë një tempull, qoftë një varr, s'ka shumë rëndësi.

**A.B. - Ju besoj e kuptoni se prej shumë kohësh kam pasur dëshirë t'ju pyes mbi raportet tuaja me poezinë, ose për të qenë më i saktë, mbi aktin e të shkruarit të një poeme. Është një fushë që nuk përmendet fare nga kritika e perëndimit kur flitet për veprën tuaj. Më 1989, tek botuesi juaj, shkrova një parathënie për përbledhjen e poemave tuaja të zgjedhura, në një version francez mjaft të saktë, meqë sidomos në fillim, si në të gjitha vendet socialiste të asaj kohe, ju përdornit**

*rimën: një vështirësi rrallë herë e kapërcyeshme pasi tek ne, rima tashmë kish humbur përgjatë shekujve për t'u kthyer në një shenjë prapambetjeje. Poemat tuaja, ashtu siç i njoh unë - ndoshta nuk i njoh mjaft mirë - janë një vazhdimësi ose një formë mjaft e përmbledhur e romaneve tuaja. Ato nuk janë anësore, por njëherazi plotësuese e të shkurtra: shtjellojnë një atmosferë, rimarrin një skenë, një ndjenjë solidariteti apo revolte. Shprehin në mënyrë më të mprehtë një nostalgji e muzikë. Në këtë rast, ju nuk doni të shprehni një anektodë por një tingëllim që ju bren përbrenda. Beethoveni nuk shkruante vetëm simfoni: edhe sonatat gjithashtu shprehnin trishtimin apo gëzimin e tij. Ç'rol luan poema në jetën tuaj? A keni shkruar poema që kur keni ardhur në Paris. A keni të tilla rezervë. Është një tundim i përhershëm apo me hope?*

**I.K.** - Vërtet ju e vonuat këtë pyetje e ndoshta një mosngutje për të folur për poezinë, fshehtësisht është rrezatuar tek ju, si një mosdashja ime.

Ka diçka të vërtetë në këtë mosngutje-mosdashje, që do të përpinqem ta shpjegoj.

Së pari po i përgjigjem pjesës më të lehtë të pyetjes suaj. Është fare e vërtetë se disa nga veprat e mijë janë shfaqur në krye në trurin tim në trajtë vjershësh. Kështu p.sh. "Piramida", "Dimri i vëtmisë së madhe", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" e, ndoshta "Viti i mbrapshtë" e "Prilli i thyer". Kësaj prejardhjeje, si të thuash "fisnike" nuk i kam dhënë ndonjë rëndësi në veten time. E as

kam gjetur në to ndonjë shenjë apo ndonjë paralajmërim për fatin e veprës. E kam marrë përherë si një rastësi. Madje ka patur ndonjë rast kur ka ndodhur e kundërta, domethënë romani është kthyer, ose më mirë është fosilizuar në një vjershë. Kjo ka ndodhur p.sh. me "Përbindshin" kur pas ndalimit të tij më 1965, shkrova vjershën "Laokoonti", që nuk ishte veçse një lloj qiriri i ndezur si për përshpirtje mbi varrin e romanit. (Një akullore, siç do të thoshte Pushkini, për përshpirtje të dimrit).

Në qoftë se ju vini re tek unë një nervozizëm kur flas për poezinë, duhet ta kuptoni se kjo shkaktohet, me sa duket, nga një mbingopje, që ne atje, në botën komuniste, kemi pësuar prej saj. Vite me radhë vendet e Lindjes janë krenuar për mbajtjen gjallë të poezisë, për vendin e madh që ajo zinte në botime, për tirazhet tepër të larta të saj e, sidomos për numrin e madh të poetëve. Që ka patur diçka të mirë në këtë vëmendje, kjo është jashtë diskutimit. Ashtu siç është e keqe këtu, në botën tuaj perëndimore, mosvëmendja ndaj poezisë. Mirëpo në qoftë se e pranojmë të mirën, duhet të pranojmë po aq të keqen, që ka sjelle e gjithë kjo bujë. Në këto vende poezia ka shërbyer shpesh për të mbuluar gropat dhe djerrinat e letërsisë. Titujt e shumtë të librave, tirazhet, festivalet, çmimet, recitimet publike etj., bënin pjesë më shumë se proza në festën e zhurmshme të diktaturës.

Ju e dini se me poezinë mund të bëhen spekullimet më të mëdha. Në poezi mungesa e talentit mund të fshihet më lehtë sesa në prozë

ose në dramë. Çdo tyryfyl mund të mbrojë sajesën e tij poetike, domethënë kotninë e vet me "individualitetin poetik". E ju e dini se në botën tonë komuniste të patalentuarit ishin thesar për shtetin, aq sa ishin bezdi të talentuarit.

Kështu shpjegohet që në vendet më të egra komuniste u tregua edhe një dashuri histerike ndaj poezisë, duke iu bërë thirrje popullit të shkruajë sa më shumë vjersha. Kjo ishte një mënyrë për ta mbetur letërsinë prej vetë popullit. Kështu shpjegohet gjithashtu që diktatori i Kinës, Maoja, ndërsa persekutonte barbarisht mijëra shkrimtarë, shkruante e botonte vetë vjersha! E kështu shpjegohet zbulimi i vjershave të rinisë së Stalinit dhe i vjershave qesharake të Marksit.

Ua thashë këto për të shpjeguar kujtimin tim të keq prej poezisë, pra për t'ju paralajmëruar se unë mund të jem krejt subjektiv e të mos kem të drejtë.

Lidhur me teknikën poetike, domethënë përdorimin e rimës, që ju e quani si shenjë prapambetjeje, unë s'jam në një mendje me ju. Ju mund të keni të drejtë kur e keni fjalën për vëndet e ish Lindjes, ku çdo gjë e vjetruar ishte vetvetiu e parapëlqyeshme, pra kur flasim për letërsinë, periudhat 60-70 vjeçare s'janë veçse ca çaste të shkurtra në krahasim me jetën e saj. E parë pra nga një pikë më e lartë unë mendoj se çlirim i poezisë nga "Këmisha e saj e forcës", teknika në të vërtetë nuk ka qenë çlirim por rënie në një robëri të re, ndoshta më të keqe. Kjo është robëria e lirisë pa cak, kurthi më i keq për letërsinë. Teknika poetike, ritmi, ato që duken një gjë e

kotë, një barrë, një pengesë, ato janë pikërisht një nga mjetet që e mbajnë në trysni të vazhdueshme poezinë. Nietzsche shkruan diku se tragjedia greke filloj rënien pikërisht kur ajo u nda nga njëra prej pengesave të saj: muzikës. Po kështu, në një shkrim tjetër, më duket për Wagnerin, ai thotë me të drejtë se teksti dhe muzika në opera janë si shpirti me trupin, pra në një mundim të vazhdueshëm por të domosdoshëm për njëri-tjetrin.

Liria në letërsi ndryshon kryekëput nga liria në jetë. Akti i parë madhor i letërsisë botërore ishte heqja dorë nga liria kaotike e miteve dhe zëvendësimi i saj me shtrëngesa të njëpasnjëshme.

Ne jemi të gjithë të mbërthyer në shkëmbinj, të cilëve u detyrojmë jo verbërinë, por të kundërtën, lirinë tonë. Çlirimi prej tyre do të ishte squallje, shuarja jonë e trishtueshme.

*A.B. - Do të doja të insistojë pak tek poezia. Ajo na afroi shumë në atë kohë, mjast të gjatë, kur nuk mund të takoheshim pa praninë e ambasadorit shqiptar. Biseda e atëherëshme për letërsinë përmblidhej në një shkëmbim mendimesh mbi poezinë, meqë kjo fushë e veçantë mund t'i shpëtonte sarkazmave dhe interpretimeve të rangut social.*

*Jeni ju herë poet e herë romancier apo njëherazi poet e romancier? Sipas jush ku mund të thoni më shumë, në prozë apo në poezi? Duke qenë nga një vend ku populli e adhuron poezinë, siç ndodh në të gjithë Evropën e Lindjes duke përfshirë edhe Rusinë, ju ia keni më pak frikën*

*një përplasjeje ndërmjet saj dhe popullit. E them këtë, me pak dhimbje, pasi Perëndimi është shkëputur pak nga pak nga nevoja e lirizmit, ose më mirë e poemës. Francezi i mesëm -rracë e urryer- nuk e njeh poemën në se ajo nuk është shkruar 50 ose 100 vjet më parë. Që prej vdekjes së Aragonit, asnjë francez i pyetur në rrugë nuk do të ishte në gjendje t'ju thoshte emrin e një poeti që jeton. Brenda vetes a ndjeni se keni akoma për çfarë të shkruani poema?*

*Po flas gjatë, me dashje, këtë mëngjes. Pyetja ime besoj se ju sikletos më pak se unë. Mendoj se sot, shekulli ka shfaqur natyrën e tij të thellë që e dallon atë nga shekujt e mëparshëm: ai është sot objekt dyshimi i përhershëm në të gjitha fushat. Duke qenë se ideologjitet kanë vdekur dhe realja është zëvendësuar nga mijëra ndjenja kontradiktore, poema, na vë në kontakt me të panjohurën më mirë se proza tregimtare. Në shekullin e XIX, mund të ishe shkrimtar i madh pa shkruar poema. Ndoshta ky ishte kufiri për Balzakun, Dikensin, Dostoievskin e Gogolin. Atyre u mungonte një dimension që nuk i mungonte as Goethes, as Hugoit, as Pushkinit. Ndoshta një ditë do të bëjmë të njëjtën vërejtje për Proustin apo Kafkën: a mund të ndjekësh në letërsi absoluten, pa e prekur poemën? Është pa dyshim kjo arsyе madhore që i shtyn njerëz kaq të ngritur si Fernando Pessoa, Paul Valery e Rainer Maria Rilke të refuzojnë të shkruajnë romane. Pyetja kryesore : kush jam? nuk mund ti përshtatet një intrigue personazhesh. Mendoj se në këtë pikë mjaft të rëndësishme e thelbësore ne ndryshojmë shumë.*

**I.K.** - Mendoj se përpara se të jetë poezi, prozë ose dramë vepra letrare është diçka e patrjtë, e ngjashme me fetusin në barkun e nënës që, për një farë kohe, është ende pa seks. Ndoshta ne vetë nuk jemi të vetëdijshëm për këtë. Ne kuptojmë në mënyrë naive ose në mënyrë skematike (mënyrë e diktuar dhunshëm nga shkolla, librat, enciklopeditë), se ajo që kemi shkruar ka qenë përherë një poemë apo një roman, kurse në të vërtetë ka gjasë që ajo mund të ketë qenë një përzierje, një diçka hermafrodite, një lloj përbindshi me krye poeme dhe bisht romani, a me flatra drame të parritura etj. etj., dhe gjatë procesit të daljes në dritë (gjatë atij tmerri e atij triumfi që quhet krijim), shumë herë ka ndërruar trajtë mu nën sytë tanë. Veç këtu duhet shtuar: mu nën sytë tonë të verbër, që nuk pikasin asgjë.

Rrjedhimisht më duket i pamundur diskutimi për përparësitë e një trajte ndaj tjetrës. Më duket madje se përfthimi "përparësi" ose "mangësi" këtu e humbet kuptimin e vet. Mund të ndodhi, ashtu siç thonë fetarët që, mospasja të jetë fitim e pasja humbje. Nuk e di nëse Balzakut do t'i duhej poezia. Po të dëgjoja se u zbuluan disa vjersha të Balzakut, të them të drejtën s'do kisha ndonjë ngut t'i lexoja. Madje do të kisha frikë nga zhgënjimi. Kurse një copëz prozë e Homerit, një prozë e thatë, e përpiktë, kundërpoetike, do të dukej një mrekulli... Ndërkaq, te Rembo-ja i gjejmë të dyja, madje dhe tek ai që do të pritej më pak, te Edgar Poe. Mendoj se dyshimi për atë mangësi që flisni ju e shtyu Dostoevskin të vendoste mu në mes të

"Vëllezërve Karamazov", këtij romani që ngjan si kurorë mbretërore, një diamant të rrallë: "Legjendën e Inkuizitorit të madh". Besoj se jeni në një mendje me mua se do të ishte dhunim po ta quaje prozë e, ndoshta po aq, po ta quaje thjesht poemë. Është më pak dhe njëkohësisht më shumë se të dyja.

Ndoshta për të njëjtën arsyе Gogoli e quajti "Shpirrat e vdekur" poemë. Por, le ta themi me keqardhje e midis nesh, në këtë roman madhështor, Inferno sipas stepave ruse, pjesët e vetme të dobëta janë pikërisht fluturimet poetike që autorri, për të përligjur, me sa duket, emërtimin poemë, i ka shtuar aty-këtu.

Përsa i përket aftësisë për të të çuar drejt së panjohurës, mendoj se qerrja e prozës është po aq e aftë sa pegasi i poezisë. "Kumti perandorak" i Kafkës nuk ka më pak mister ose synim drejt misterit sesa "Korbi" i Poes, për të dhënë vetëm një shembull.

A e duan poezinë si dikur lexuesit? A e duan letërsinë në përgjithësi? A nuk po ftohen prej saj?

Shtjellën ose më mirë luftën (si racë e egër që jemi apo përmendim këtë fjalë gjërat bëhen më të qarta), pra luftën midis gjinive letrare, midis rrymave shkollave etj., arrij ta përfytyroj disa here fare thjeshtë: Ka ndodhur në krye një luftë e tmerrshme totale midis veshit dhe syrit, domethënë midis letërsisë gojore, që futej në trurin e njeriut nëpërmjet veshit dhe letërsisë së shkruar, që merrej nëpërmjet syrit. Në këtë luftë, siç duket, veshi u mund tragjikisht dhe syri e

shtriu zotërimin gjithkund. Në fund të shekullit XIX, shpikja e radios mund të quhej një farë kryengritje e veshit për të rifituar pushtetin e humbur. Mirëpo kjo nuk vazhdoi gjatë. Një forcë e re u shfaq në horizont: televizioni. Gërvhetimi i të dyjave: syrit e veshit, ai është kundër të dyve veç e veç e, sidomos kundër syrit, domethënë leximit...

Megjithatë unë nuk besoj se njeriu do të ftohet një ditë nga librat. Është e vërtetë se lexuesi lindor, lexuesi më i pasionuar e më i thellë u prish, u çorodit, dhe këtë unë e quaj një humbje të përmasës planetare, pasojat e të cilës do të ndihen në botë, megjithatë nuk ka arsyе për dëshpërim. Ka ndodhur një çvendosje që nuk pritej: grykësia materialiste u çvendos nga Perëndimi në Lindje, kurse shpirtësia bëri udhën e kundërt: nga Lindja në Perëndim. rrjedhimisht, do apo nuk do Perëndimi, ai do të bëhet strehim i shpirtësisë botërore. Ndryshe bota do të zvetënohet me shpejtësi.

Unë kam shpresë se pavarësisht nga dhuna televizive, ose më mirë nga dhuna e parasë, që e ka shtrirë në dorë tani për tani një pjesë të TV, kjo nuk do të vazhdojë gjatë. Shpresën time e bazoj në ca shenja të sigurta. Kam patur rastin ta njoh lexuesin francez. Librat e mi në përgjithësi janë të vështirë. Ato s'janë të pajisura me ato truke publikndjellëse që sigurojnë lexuesin e gjerë, përkundrazi kanë patur të gjitha shenjat e kundërtat. Megjithatë ishte ky lexues që u lidh me to krejt natyrshëm.

Gjatë seancave të kushtimit të librave, kur lexueset gra kanë zgjedhur për shembull një roman

të ashpër si "Piramida", shpesh i kam paralajmëruar gjysmë me mahi: "Zonjë, në këtë roman s'ka asgjë për dashurinë, madje asgjë për gratë". Por kjo nuk ka bërë asnë prej tyre të ndërrojë zgjedhje... Tek shikoja gishtat e tyre të brishtë që më dukej se do të thyheshin duke prekur atë libër ku s'flitej veç për tmerre e për gurë të rëndë, besimi te truri njerëzor më përtëritej.

A mund të nxirret një e vërtetë nga një shembull? Nganjëherë po. Veç kësaj kur shembulli vazhdon me dhjetëra vite, shpresa jonë rritet po ashtu.

**A.B. - Për të kompletuar panoramën e fantazive tuaja, ndjenjave tuaja, mundësive tuaja do të doja të njihja heronjtë e panteonit tuaj letrar që prej Antikitetit deri në ditët tona. E, meqë jemi këtu, cilët janë klasikët e mëdhenj që nuk ju impresonojnë e nuk sjellin asgjë për ju? A ka ndërmjet shkrimtarëve të shekullit tonë, autore që do të donit t'i rilexonit?**

**I.K. - Tani pas kaq kohe e kam të vështirë ta kuptoj edhe vetë si u krijua në ndërgjegjen time panteoni i letrave botërore. Siç e përmenda pak më parë, fillimet e tij kanë mbetur përherë të zhytura në mjegull, atje ku nuk kuptohet mirë çka është letërsia e çka është thjeshtjeta njerëzore. Kështu që dëshira për ringjalljen e gjyshit tim, mosrënia e Trojës dhe ëndrra që Don Kishoti të fitonte vërtet ndonjë betejë u përzien qysh herët në ndërgjegjen time me librat përkatës ku flitej**

për këto ngjarje. Ndërkaq pakënaqësia ime për to (domethënë për përfundimin e tyre) ndrynte brenda, ndoshta, një pjesë të asaj që quhet dashuri e vetvetishme e shkrimtarit për të sjellë risi në letërsi. Megjithatë kufiri midis të dyjave ka qenë përherë aq i turbullt saqë ende sot nuk jam i sigurtë për të.

Më vonë pandehma të tjera e mbushën jetën time plot kureshtje e mundim të këndshëm. Sikur Homeri të mos ishte i verbër? Sikur të gjendeshin një pjesë e tragjedive greke? Sikur plumbi që turej drejt Pushkinit të çvendosej disa centimetra më djathtas? Sikur në Jaltë më 1944 Çurçilli me Stalinin, kur këmbenin ato pusullat e tyre cinike të mendoheshin qoftë edhe një minutë më shumë për fatin e vendit tim, Shqipërisë?

Për një kohë të gjatë të gjitha këto e të tjera si këto shtjelloheshin brenda meje të përziera me gjithçka tjetër që dija për letërsinë, pa guxuar të ndaheshin. Një pjesë kështu edhe kanë mbetur. (Ende sot ruaj dëshirën të shkruaj trilogjinë e humbur të "Prometheut", në të cilën pjesa e mbetur prej Eskilit të të përfshihej ashtu siç përfshihet kisha e hershme brenda ngrehinës moderne).

Nderimi im për Homerin, Eskilin, Danten, Servantesin, Shekspirin, u krijua kështy natyrshëm, një pjesë nga fëminia ime, një pjesë nga shkolla, e një pjesë nga mendja ime.

Ndërkaq një mekanizëm disi i çuditshëm i ndante brenda meje leximet e kota, të këndshme e kalimtare, nga ato të rëndat, që shtresoheshin përjetë në ndërgjegjen time. Asnjëherë s'më ka tërhequr Homeri ose Dantja aq sa "Ura e

psherëtimave", ose "Ishulli i Thesarit", që i përpjija brenda disa ditësh, por ndërkaq katër-pesë vargjet ku përshkruhej rënia e shigjetave të argjenta që çonin murtajën mbi ushtrinë rrethuese greke ose vrimën danteske që conte në thellësinë e globit i kisha përherë me vete. Ashtu si kënga e këndezit të parë, i cili për shkak të Shekspirit e ndante natën time fëminore në dy pjesë, në atë të ankthshmen kur shpesh kisha frikë, nga tjetra paqësorja si prej parajse.

Më pas, kur nisën të më tërhiqnin ndërtimet e mëdha faustiane, si urat, piramat, e kuptova se ato ishin të pandara nga krimet e mëdha. Kështu që shkrimtarë që dukeshin të largët si Goethe dhe Dostojevski, hynë në botën time së bashku. E po ashtu Balzaku dhe Gogoli që më dukej se lidheshin me dypejsazhmërinë e jetës sime, atë të shtëpisë atërore në lagjen e gurtë Palorto, atje ku fare mirë mund të përfytyrohej ecja e ngutur e Gobsekut, me kopshtin e përgjumur çehoviano-gogolian të gjyshit tim.

Shkrimtarë të tjera si Pushkini më pëlqenin më fort si shokë të mundshëm. Kështu, për shkak të historisë së dashurisë me Anna Kernën, çdo vajzë me emrin Anna, qoftë në Shqipëri, qoftë në Rusi(ku ato ishin më të shpeshta) më tërhiqte më shumë se të tjerat.

Unaza e shkrimtarëve të mëdhenj jo vetëm më ruajti nga ndikimi i kulturës komuniste, por me anë të atij filtri mbrojtës që e përmenda më parë, nga lajthitet e mundshme të modave letrare. Kështu, ndonëse e pëlqeja Heminguejin, i cili siç e thashë pak më parë në fillim të viteve 60

po tiranizonte me ndikimin e tij krejt Lindjen komuniste, arrita të ndiej se ai nuk e kishte peshën dhe hijen e të mëdhenjve. Ishte njohja me Kafkën ndoshta që më ndihmoi më së shumti për të plotësuar panteonin letrar të kohës moderne, atje ku ishte pérherë më vështirë dhe ku gabimet mund të ishin fatale.

Kafka hyri në jetën time me tërë natyrshmërinë e vet ogurzezë. Isha ndoshta i pari shqiptar që jetonte brenda Shqipërisë që e kishte lexuar, kështu që bisedat e mijë për të shumë shpejt përfunduan në dosjet e policisë së fshehtë. Disa shkrimtarë e letrarë që kanë qenë në burgjet komuniste, më kanë treguar tanë vonë se si i kanë pyetur me hollësi për këto biseda.

Pjetjes tuaj për ata shkrimtarë klasikë ndaj të cilëve kam qenë i ftohtë do t'i përgjigjem: fatkeqësisht po.

Për arsyet që s'kanë qenë fort të qarta asnjëherë, kam humbur mjaft të tillë. Them "kam humbur" sepse nuk di ç'folje tjetër të përdor. Dhe po e përsëris se në shumicën e rasteve, sinqerisht nuk e di as vetë se përse ata nuk ngjitën tek unë. Kështu ka ndodhur p.sh. me Dikensin e Turgenievin, me një pjesë të Tolstoit, me Fildingun, Henri Xhejmsin, Konradin etj.

Nganjëherë mendoj se kjo është një gjë e pashmangshme dhe se njeriu nuk ka vend përgjithë pasurinë e botës, ashtu siç e ka të kufizuar mundësinë e dashurisë. Jam i ndërgjegjshëm se do të vdes pa arritur t'i dua një pjesë të këtyre shkrimtarëve e ndoshta pa arritur t'i lexoj. Kjo më jep natyrisht atë brengë të qetë e të durueshme

kur mendoj se si ikim nga kjo botë pa ditur e pa parë shumë gjëra të saj: tempuj, qytete, manastire në Tibet, apo drerë që qajnë në veri.

*A.B. - Më flisni pak për Shqipërinë sot. Ajo shpëtoi njëfarësoj nga diktatura komuniste. Por çdo të bëhet në të ardhmen? Episodi i eksodit pothuaj histerik të banorëve të saj nuk na siguron aspak. Duke e pasur të ngulitur në mendje imazhin e një parajse alla amerikane, ose alla franceze, me të gjitha objektet e konsumit e televizionin me një nivel mjaft të ulët, turma, duke vënë në rrezik jetën, vërvshoi drejt brigjeve të Barit e të Brindizit, për t'u ndeshur me masat mbrojtëse të një demokracie banale, të flashkët e të lodhur. A i përshtatet vendit tuaj regjimi pak a shumë liberal me të gjitha garancitë parlamentare sipas mënyrës perëndimore? Liri për çfarë? Në se Shqipëria ndjek shembullin polak, çek apo hungarez a nuk rrezikon ajo banalitetin më të tmerrshëm? E di fort mirë se në rastin e një ndryshimi të plotë nuk mund të parashikohet asgjë. A keni ndonjë parashikim apo thjesht ndonjë dëshirë të sferës praktike. Për mendimin tim, kam frikë se aspektet më të këqia të merkantilizmit, pa asnje projekt ose shpresë përveç asaj të ruajtjes së një lloj niveli jetese, do të fitojnë mbi të gjitha arsyet e tjera. A jemi ne të dënuar, në Evropë, të jetojmë dita dittës, me turp në një liri që nuk dimë ta vemi në shërbim të asgjëje përveçse për një mirëqënie të një cilësie mjaft të dobët?*

**I.K. - Shqipëria është një vend i vështirë.**

Kur ajo ishte diktatoriale dhe staliniste, isha i ndërgjegjshëm se kam qenë një shkrimtar normal në një vend të çmendur. Kjo nuk ishte e lehtë për t'u përballuar çdo ditë, çdo orë. Tani që Shqipëria e ka flakur komunizmin e ndiej se të jesh shkrimtar i një populli të vështirë, gjithashtu është e rëndë. Vendi juaj kërkon nga ju gjëra të pamundura. Ju i keni dhënë libra, e befas ai kërkon që t'i ndërtoni rrugët, t'i gjeni qumësht, ose t'i udhëhiqni ushtrinë në luftë. Vendi pra qëllon që ju vret me dashurinë e tij, me pyetjet e tij, me nervozizmin e tij.

Shqipëria është sot një vend më i djathtë se ish vendet e tjera komuniste. Është një vend i shqetësuar, të cilit liria i ka rënë në kokë si pi ja e fortë dhe në vend që ta ngazëllejë ia ka prishur drejtpeshimin.

Shqipëria vazhdon të mbetet një vend i vecuar, jo fort i dashur nga Evropa. Madje kam përshtypjen (dashtë Zoti të jetë e gabuar), se një mendim i fshehtë qarkullon në rrethe të ndryshme evropiane: vende të tillë më mirë të kishim mbetur atje ku ishin! Këshilla e mbrapshtë që i është dhënë Shqipërisë për të hyrë në Lidhjen islame, (nëqoftëse i është dhënë një këshillë e tillë) nuk është vecse shprehje e këtij mendimi. Madje do të thoshnja një veprim i drejtpëdrejtë për ta shtyrë Shqipërinë përsëri drejt Azisë.

I përmenda këto për t'ju kujtuar se problemet e këtij vendi janë të lidhura me qëndrimin e kontinentit ndaj krejt gadishullit ballkanik. Braktisja e Ballkanit prej Evropës do të ishte një tragjedi me epilog të paparashikuar.

**A.B. - Jeni kthyer në një lloj ndërgjegjeje ndërkombe të. Nuk refuzoni të prononcoheni mbi problemet aktuale. Mendoni se keni detyrime ndaj njerëzimit apo më thjesht ndaj Evropës së sotme, që nuk i ngjan më asaj të pak viteve më parë? Nuk mund t'i minimizojmë dy mrekullitë që kanë ndodhur së fundi. E para, zhdukja e çdo rreziku të jashtëm. Kërcënimi i një sovietizimi, me luftë bërthamore ose pa konflikt të armatosur, teorikisht është larguar të paktën për dy apo tre breza. Unë e dija i pari që rreziku sovjetik ishte më shumë një shpifje e Pentagonit dhe e shtabeve madhore për të kërkuar kredi abuzive. Dordoleci komunist rregullonte një përqindje impresionuese të personelit politik. Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik dhe ribashkimi i Gjermanisë përbëjnë gjithashtu një ngjarje të një rëndësie të veçantë. Mrekullia e dytë është shpejtësia me të cilën u afroan mentalitetet evropiane, pa asnje përplasje. Kur unë i flas sot një shkrimitari por mund të jetë piktor, ministër, inxhinier, mjek- që jeton në Varshavë, Kiev, Sofje, Tirane apo Pragë, përdor të njëjtin fjalor që ka të njëjtat vlera, të njëjtat arsyetime, të njëjtat mënyra të të menduarit. Mendërisht dhe shpirtërisht, Evropa është bashkuar ose është duke u bashkuar. A e ndjeni ju këtë fenomen i cili duhet të na gëzojë? A mund të mjaftohemi me kaq? Tregu i përbashkët i mendjes ekziston tashmë pa qenë një treg dhe pa pasur nevojë për më të voglin traktat. Më në fund, për herë të parë në historinë e saj, Evropa mund të mendojë për të ardhmen e saj, le të themi mirë për përcaktimin**

*e Evropës në botë. Ku doni ju të shkojë kjo Evropë? Ç'rreziqe kalbëzimi e kërcënoinjë? Ç'rreziqe të tej amerikanizimit duhen evituar? A është e mundur të jetohet pa më të voglin ideal politik, si konsumator pak a shumë xheloz të njëri tjetrit?*

I.K. - Zakonisht unë i shmangem pyetjeve për Evropën për një arsyе të thjeshtë: bëhen kaq shumë mbledhje, takime, simpoziume për Evropën, është krijuar një armatë e tërë oratorësh e specialistësh për të, një terminologji e tërë, formula, opçione, citime e citime të citimeve saqë njeriut që futet në këtë shjellë i duket vetja i paditur. Për këtë arsyë ndoshta do të desha t'ju flas për Evropën në mënyrë parake(primitive) domethënë në mënyrë barbare ose mitike, ashtu siç përftohet ajo ende sot nga shumica e ballkanave.

Në poezinë orale ballkanase Evropa përmendet shpesh. Përfytyrimi i saj i njëqind vjetëve më parë nga ai i sotmi ka ndryshuar shumë pak. Evropa përfytyrohet si grua. Rrallë herë si zonjë e rëndë, së shumti si grua tridhjetëvjeçare. Një grua tërheqëse e dëshirueshme, e cila meriton ose të dashurohet ëmbëlsisht ose të përdhunohet. Meqenëse dashurimi nuk është i lehtë, mbetet zakonisht përdhunimi.

Sado mitik të duket ky përftim, ai është më i përpikti nga të gjithë ende sot. Ajo që ndodh në kufijtë e Evropës, në pikat kalimtare, doganat, zyrat e emigracionit, aeroportet, greminat e Zvicrës apo kënetat midis Gjermanisë e Polonisë, nuk është veçse dashurim e përdhunim njëkohësisht. Evropa natyrisht ka të drejtë të mbrohet nga

përdhunimi. Me të gjitha mjetet gjer te Shengeni. Por ajo s'duhet ta kthejë mbrapsht dashurinë e të tjerëve.

Unë jam nga një vend që e ka humbur Evropën dy herë. Herën e parë në shekullin XV kur ra nën pushtimin otoman, bashkë me krejt Ballkanin. Herën e dytë më 1944, kur ra nën diktaturën komuniste.

Një humbje e tretë e Evropës do të ishte për Shqipërinë e fundbotshme.

*A.B. - Mendoj se mund të vazhdoja t'ju bëja njëmijë e një pyetje mbi atë çka mund apo duhet të ishte Evropa në të ardhmen. Jam i sigurt se në këtë pikë ju do të kishit mendime nga më të ndryshmet. A mund të jepet një konceptim racional, apo do të ishte më e ndershme, si për vete edhe të tjerët, të pranohet konvergjenca e shumë ideve plotësuese ose kontradiktore? Imagjinoj për trullosjen që pësojmë kur shohim Evropën si një entitet të realizuar për gjysëm apo në tre të katërtat, që kërkon rrugën e saj. Apo ndoshta mos është më keq: kush mund të pretendojë në ditët e sotme, që një rrugë është e dëshirueshme përvëç rregullimeve të vogla si ekonomia, shëndetësia, kufizimi i përdorimit të drogës? A mundet që një kontinent si i yni të kënaqet me gjysëm-masa? A mund të kërkohej një rrezik i jashtëm qoftë edhe i rremë? Unë ndihem në thellësi një evropian i bindur dhe do të thosha i pashmangshëm. Po ju? Thellë në vetvete a e ndjeni për detyrë të merrni pjesë në këtë përcaktim gjithnjë të vonuar të Evropës?*

*A vuani kur shihni se pasuria e trashëguar po dëmtohet: një e kaluar që zhytet në harresë ose, ç'është më e keqja, në një lajkatim nationalist foshnjarak.*

**I.K.** - Në qoftë se ju e ndjeni veten një evropian i pashmangshëm, unë do ta cilësoja veten time dëshpërimisht, për të mos thënë katastrofisht evropian.

Ngarkesa e madhe në këto dy ndajfolje vjen nga ai ngjyrim tragjik, fatal dhe me një përndezje gati të sëmurë, me të cilin përftohet Evropa prej ballkanasve, siç e përmenda më lart.

Evropa (e këtu unë fut edhe SHBA si bijë natyrale të saj) është lagja e vetme e botës ku unë do të jetoja, e sidomos të vdisja (domethënë të mbetesha për jetë). Ndonëse në gati gjysmën e veprës sime ngjarjet e personazhet veprojnë jashtë Evropës, kjo pjesë e rruzullit tokësor, domethënë pjesa jashtë evropiane, i shpëton dashurisë, tërheqjes apo mallit tim. Madje nganjëherë mendoj se kam qenë i ftohtë me të, ndaj dhe i kam përshkruar me këmbëngulje, gjë që ndodh shpesh me shkrimitarët. Zonat e ftohta të padashura, madje të frikshme, për të mos thënë skëterore kanë qenë joshja e përhershme për racën tonë demoniake.

I çmoj gjithë popujt dhe kulturat e botës, megjithatë mendoj se nën qiejt apo në qilarët e Evropës tanë për tanë është stivuar rezerva kryesore e pasurisë shpirtërore të njerëzimit. Ndryshe nga rezervat e naftës, të grurit apo të tigrave, rezerva e thesarit shpirtëror të krijuar prej njerëzimit

është e tillë që i mjafton globit tokësor, madje i kapërcen nevojat e tij edhe për shekujt e ardhshëm. Çështja është se rrugët e mbërritjes së kësaj pasurie drejt trurit të njerëzve janë ngushtuar. Prej një dhjamosjeje, prej një mirëqënieje meskine po shkaktohet mu në sytë tanë një arteriosklerozë me përmasa të frikshme. Mediokriteti është ngritur në një luftë totale kundër artit të madh. Njëra pas tjetrës kështjellat e këtij të fundit bijen. Shikoni ç'po ndodh me rrjetet televizive. Lufta e tmerrshme, ajo që u zhvillua për të fituar kohën midis orës shtatë dhe dhjetë të mbrëmjes, mbaroi me fitoren e mediokrititetit. Arti i madh është shtyrë pas mesnate dhe së shpejti do të shtyhet edhe më tej në programet për të pagjumët, ose të sëmurët psikikë.

Mendoj se rënia e komunizmit, në vend që të sillte një ngritje të dozës së shpirtësisë, domethënë të idealizmit, ka sjellë në botë të kundërtën. Një shkretëtirë e pikëllueshme shpirtërore u krijuar në ish vendet e Lindjes. Ne shkrimtarët e ish vendeve komuniste humbëm brenda një kohe të shkurtër me miliona lexues. Në javët e para të tërmetit, u duk se ata miliona lexues do t'i fitonit ju, shkrimtarët e Perëndimit, sidomos ata që ishin të ndaluar tek ne. Mirëpo ky nuk ishte veçse një gënjam(iluzion). E keqja në kësi rastesh vjen për të gjithë dhe këmbana ra vërtet për të gjithë, për ne dhe për ju. Ju humbët gjithashtu miliona lexues. Madje ju humbët një botë ku krahas trishtimit kishte shumë ëndrra dhe shpresa. Dhe ajo botë, ajo pamundësi, ai trishtim përtej kufirit kishte një ndikim të turbullt, misterioz edhe mbi ju.

Kështu që ne bashkarisht pësuam një humbje. Megjithatë Evropa mbetet tani për tani ende streha kryesore e shpirtësisë. Të vjetrit e përfytyronin mitrën e gruas si diçka që lëviste e shqetësuar nëpër trup, në kërkim të mbarsjes. Pak a shumë kështu mund të përfytyrohet shpirtësia e njerëzimit. Ajo është në çvendosje, në kërkim të vazhdueshëm për të pjellë.

Lidhur me kërkimin e një rreziku të jashtëm që do të zëvendësonte komunizmin e do t'i shërbente Evropës si nxitje për gjallërim, tendosje apo zgjim nga përgjumja, kjo po ndodh mu në sytë tanë. Dy janë ndërkaq joshjet: nacionalizmi dhe islamizmi. I pari paraqitet tepër i koklavitur, i paqartë dhe lehtësisht i ngatërrueshëm me laryshinë kulturore, kurse i dyti duket si më i lakuar.

Mendimi im është që Evropa duhet t'i shmanget këtij tundimi. Thellimi i armiqësisë me islamizmin do të krijonte probleme të paparashikueshme, të rënda e shekulllore. Rruzulli ynë po bëhet përherë dhe më i vogël për armiqësi të tillë të mëdha. Ndërkaq Perëndimi vetë po i bën dhurata të njëpasnjëshme fondamentalizmit islamik. Në këtë çast që ne po dialogojmë tre janë dhuratat: cilitja e Bosnjës, masakrimi i Çeçenisë dhe e treta, tërbimi erotiko-pornografik. Të trija këto janë një minierë floriri për fondamentalizmin. Dhe ai po i shfrytëzon me mjaft mençuri.

Evropa katolike e protestane nuk mund të hiqet mënjanë për të dy krimet e para, meqenëse ato po kryhen prej ortodoksëve sllavë. Për një optikë të jashtme fondamentaliste ato janë kime të krishtërimit kundër islamit. Kështu në sytë e

më shumë se një miliard njerëzve krishtërimi perëndimor merr mbi vete një njollë tepër të rëndë.

**A.B. - Ju keni zgjedhur Francën për të jetuar e punuar. Familja juaj gjen aty një ekuilibër mjaft të pranueshëm. Ç'mendoni sot për këtë vend? Ju kërkoj të jeni objektiv e për pasojë i rreptë. Kur më bëjnë këtë pyetje më vjen keq që Franca është në paqe që nga përfundimi i luftës me Algjerinë. Gjendja e luftës ishte fati ynë bile prirja jonë, në këtë shekull, që prej 1914-tës. Sapo u nënshkrua Traktati i Versajës ne dërguam trupat tona kundër Rusisë së mbërthyer nga Lufta Civile. Bashkë me anglezët, ne ishim xhandarët e Evropës. Pushimi, pas fitores së Ushtrisë së Kuqe ishte mjaft i shkurtër: u ngrit në këmbë Afrika e Veriut dhe shumë francezë u vranë në Betejën e Rifit. Në 1936-ën na u desh të riarmatosemi. Disfata e 1940-es nuk i pengoi trupat tona, nën flamuj të ndryshëm të luftojnë jo vetëm brenda vendit, përherë e më pak në mënyrë klandestine, por edhe në Azi e në Afrikë, në konflikte vëllavrasëse siç ishte rasti i Sirisë. Kontigjentet tona gjendeshin në anën e anglezëve, në anën e gjermanëve, në anën e amerikanëve, në anën e ruseve. Pas konfliktit të Rezistencës, ishte ai i Çlirimt dhe, ne e harrojmë shumë shpejt, spastrimin. Ndërkohë ne luftonim për të ruajtur Indokinën, pasi e humbëm ne pamë në Algjeri një luftë të ndyrë e të pashpresë. Që prej asaj kohe, a jemi të denjë për të kaluarën tonë, për idetë tona, për vlerat tona? Nën mbretërinë e Louis Philipit, të zhgënjuar nga regjimet e**

*njëpasnjëshëm, Regjimi i Vjetër, Revolucioni, Restaurimi, një revolucion i ri, francezët nuk dinin nga të drejtoheshin. François Guizot, që njihet mjaft mirë prirjen e tyre, u thirri: "pasurohuni!". Kam bindjen se që nga Georges Pompidou të njëjtën gjë na thonë të gjithë drejtuesit qofshin ata në presidencë apo në poste të tjera. Prodhimtaria është kthyer për ne një ambicje kryesore e cila - duhet pranuar -nganjëherë na neveritet gjatë kohës së një greve apo të një lëkundjeje në Bursë. Ne jetojmë gjithashtu nën shantazh kombëtar: nën pretekstin se e kaluara jonë ishte e lavdishme -sidoqoftë në ndërgjegjen tonë të fryrë - ne mendojmë akoma se planeti tregon për ne një interes të vërtetë. A mos e ekzagjeroj? Do të doja shumë që ky vend -që unë kam zgjedhur por në të cilin nuk kam lindur -të shërbejë akoma si shembull: të themi shembull intelektual, i cili në kohën tonë, është pothuaj herezi. Megjithatë, unë i njoha i pari bukuritë e këtij kombi, fleksibilitetin e tij, individualizmin, elegancën e tij të rastësishme. A mos vallë ai fle mbi dafina imagjinare? A mos po bëhet ai, me mënyrën e tij gracioze, tepër i parëndësishëm?*

**I.K.** - Lidhur me dhënen e një kumti, një sqarimi se çka po ndodh në vendin tim, këtë unë e kam bërë, siç e dini dhe ju vetë, me miqtë e mi, por asnjëherë më shtetin francez. Kjo ka ndodhur jo për arsyen droje, por sepse më është dukur se këtu ka patur mospërfillje për vendin tim, çka më brengoste vazhdimisht.

Kishte një kundërthënie të theksuar midis

dashamirësisë francezë ndaj meje dhe veprës sime dhe shpërfillje që tregohej ndaj popullit që i përkisja, sidomos në rrethet zyrtare. Megjithatë pas botimit në revistën "Express" të një artikulli për burgjet dhe kampet e përqëndrimit në Shqipëri dhe që e shkruam bashkë me Claude Durand-in (natyrish me pseudonim) doja të bëja diçka më me peshë.

Në verë të vitit 1989, kur me rastin e festimeve të 200 vjetorit të Revolucionit Francez, bashkë me një grup shkrimitarësh e intelektualësh të shquar: Markez, Stayron, Geremek, Elie, Weisel, Sojinka, etj., isha i ftuar i presidentit, kisha vendosur të bëja çmos për të dhënë një "SOS" për Shqipërinë. Ndonëse i ftuar prej Mitterrandit, m'u duk jo modeste të kërkoja takim me të, në kushtet kur ai ishte mikpritës i 26 kryetarëve të shteteve miq. Ndërkaq, meqenëse të ftuarit e presidentit i hanin drekat dhe darkat në një sallë me kryetarët e shteteve, tundimi për të kaluar kumtin ishte tepër i fortë. Presidenti amerikan Zhorzh Bush, ishte në tryezë disa hapa larg në kohën e pirjes së konjakut e kafesë dhe ishte fare lehtë ta takoja e të bisedoja me të. SHBA jepte çdo ditë një emision në gjuhën shqipe, që dëgjohej jashtëzakonisht shumë në Shqipëri. Mirëpo presidenti amerikan ishte shpallur armiku numër një i Shqipërisë dhe një bisedë me të quhej tek ne tradhëtia më e lartë. S'duhet harruar se muri i Berllinit ende s'kishte rënë. Kështu që kumtin ia kalova Bushit me anë të Zhak Attalisë. Ai ishte i thjeshtë dhe i qartë: pavarësisht nga armiqësia e tërbuar e komunistëvë shqiptarë ndaj SHBA, populli shqiptar kishte shpresë se pikërisht SHBA bashkë me perëndimin do ta

ndihmonin të çliruhej nga diktatura komuniste.

E ndoqa me sy Zhak Attalinë kur iu afroa Bushit, kur bisedoi me të, pastaj me një nga ndihmësat e tij. Ai erdhi pas pak për të më thënë se "ajo punë u bë".

Pas disa ditësh presidenti francez më thirri vetë për të ngrënë mëngjesin në Elisëe. Mirëpo prania e dy njerëzve të tjerë e bëri të pamundur një bisedë të hapur, siç e doja unë.

Në shtator të atij vitit, kur erdha prapë në Paris, me rastin e botimit të "Koncertit" kisha përshtypjen se kumti i dhënë presidentit amerikan në kushtet festive mund të ishte harruar. Vendosa që ato që ia thashë, t'ia shkruaja në një letër. Më kujtohet, e shkruam letrën bashkë me Claude Durand një të diel të zyrtë me shi në Derby Hotel, avenue Duquesne. Në letër i kërkohet ndihmë shtetit amerikan dhe krejt Perëndimit për të mos e harruar Shqipërinë. Claude Durand ishte i shqetësuar për mënyrën e dërgimit. Me postë ishte e rrezikshme. Me rrugë të tjera gjithashtu. Pas ca ditësh, i gëzuar më tha se Elie Wiesel, që ndodhej në Paris, i kishte premtuar t'ia conte letrën në dorë Bushit. Dhe ashtu u bë. Kur Wiesel mori në telefon nga Uashingtoni për të më thënë se e kishte kryer porosinë, kam fjetur i lumtur.

Letra mendoj se bëri efekt. U ndie menjëherë si "Zëri i Amerikës" dëndësoi interesimin dhe propagandën për Shqipërinë, çka luajti një rol themelor në përbysjen e komunizmit.

Në romanin "Hija" jam përpjekur të përshkruaj trandjen që më jepte mua çdo udhëtim në Francë. Ky ishte një udhëtim jo në trajtë horizontale,

siç janë gjithë udhëtimet, por vertikale. Ishte një dalje në sipërfaqe të rruzullit tokësor, i pasuar pastaj nga një rrënim dantesk. Jo vetëm gjymtyrët i kisha të ngrira, por edhe gojën e lidhur. Gjithçka që flisja, çdo frazë e intervistave të mijë hulumtohej imtësisht. Kam dhënë qindra intervista këtu në Perëndim, por po t'i shqyrtoni tani do të gjeni se asnjëherë s'kam bërë propagandë lavdëruese për regjimin shqiptar. S'kam thënë kurrë se atje jeton një popull i lumtur, se ka liri, se s'ka burgje e të burgosur politikë. Pjetjeve tëpër delikate si p.sh. "a ka liri shprehjeje e krijimi në Shqipëri" bërë në një gazetë franceze, i jam përgjigjur se tek ne koncepti i lirisë është i ndryshëm nga i juaji. Pjetjes edhe më delikate të TV gjerman, në një emision të drejtëpërdrejtë, se a mund të shkruajë një shkrimitar shqiptar kundër rëgjimit, i jam përgjigjur: "Jo, sepse kjo ndalohet me ligj".

Ç'mund të thoshja më tepër?

**A.B.** - *Shpesh harrojmë ta pyesim një shkrimitar mbi metodën e tij të punës. Për sa kohë i përgatisni romanet tuaj? Sa zgjat rregullimi i tyre? A është e gjatë periudha e dokumentimit? A i shkruani njëherësh apo me etapa? Ai i shkruani më parë në kopje? Në se po, a ju ndodh që të sakrifikoni një kapitull, një pjesë të librit, apo një libër të tërë? A i riktheheni teksteve të vjetra që i kishit braktisur më parë. A ka tekste që nuk ju hiqen nga mendja aq sa i ndryshoni pareshtur?*

**I.K.** - Siç e thashë më parë, rrënjët e një

krijimi letrar është gati e pamundur të gjenden. Sa herë që kam kujtar se i kam gjetur, kam gabuar. Po ashtu koha e pjekjes së një vepre në brendësinë tuaj është krejt e pazbulueshme.

Dëshira për t'i rishikuar shkrimet e mijë, për t'iu rikthyer e disa herë për të dhënë motërzime të ndryshme më ka shqetësuar dikur ngaqë më dukej si një mungesë e imja. Më pas, duke përsiatur për zhdrivillimin (procesin) letrar botëror, zbulova se kjo dëshirë nuk është veçse një rikujtim i asaj kohe të largët, (kohë e largët, e turbullt e plot mister), kur letërsia bënte hapin më të madh të saj të zhvillimit: kalimin nga trajta gojore në atë të shkruar. Kam folur gjatë në disa trajtesa (esé) të mijë për këtë. Do të përsëris vetëm thelbin e çështjes: në këtë kalim letërsia ndërsa fitonte një hapësire të re, diçka humbte pa dyshim. Duke e ngrirë me anë të shtypshkrimit krijimin në letër, krijuesit kishin një shkëputje me të. Vepra e tyre nuk jetonte më bashkë me ta, nuk riprodrohej çdo herë nga e para, me gjurmët e shenjat e reja, që i shtonte jeta e krijuesit, fati, gjendja shpirtërore, pragu i vdekjes.

Mendoj se dëshira për rishikimin e veprës pas botimit nuk është veçse një rizgjim, një rikthim, një qortim i këtij malli të shkuar.

Shkrimtari është krijues e njëkohësisht shkatërrues. Kjo nuk është një metaforë por diçka krejtësisht e njëmëndtë. Puna shkatërruese e shkrimtarit, ajo që mund të quhet kundërkrijim, ose krijimtari mohuese, ose më thjesht një zgavrinë është po aq e rëndësishme sa ajo që krijon.

Do të përpinqem ta shpjegoj thjesht këtë

gjë. Në trurin tuaj rrijnë si në një depo mjaft vepra, ose gjysma veprash, ose spikama veprash. Shumica e tyre për arsyet të ndryshme, nuk duhet, ose nuk ka kohë të shkruhen. Dhuntia kryesore e shkrimtarit është të kuqtojë se ç'duhet të flijojë nga kjo grigjë. Ai duhet pra të shkatërrojë një pjesë të tyre. Ju mund të thoni: E pse duhet t'i shkatërrojë? Mund t'i lejë aty ku janë, në tru, në qilar.

Është e lehtë ta thuash këtë, por një vepër e ndryrë brenda jush, që ju nuk e lini të dalë, ju shqetëson, ju rëndon. Atëherë ju jeni i detyruar të merreni me të. Domethënë ta hiqni qafe... Mirëpo për të shkatërruar një roman duhet një farë kohe. Në qoftë se për të shkruar duhet, ta zemë, gjashtë muaj, për ta zhbërë do të duhen së paku tri javë. (Në mënyrë që të çlironi krejtësisht prej tij).

Ndërkaq veprat e ndryra brenda jush janë shumë më të shumta se ato që do të kenë fatin të çliron. Kështu që asgjësimi i tyre kërkon përafërsisht po aq kohë sa krijimi i të tjerave.

Në këtë mënyrë, në vetminë e tij, shkrimtari kryen një punë që nuk ia çmon e nuk ia sheh askush. Ai kundërkrijon.

Por kjo nuk mbetet me kaq. Për hir të veprës së tij shkrimtarit mund t'i duhet nganjëherë të shkatërrojë gjëra tepër të shtrenjta për të. Një histori dashurije për shembull. Në qoftë se ajo është e tillë që kërkon ta gllabërojë shkrimtarin, domethënë ta zotërojë fuqishëm, me fjalë të tjera të thithë fuqinë e trurit të tij drejt saj, duke i lënë tepër pak krijimtarisë, ka mundësi që shkrimtari, në se arti për të është tepër i shtrenjtë, të zgjedhi

artin përpara dashurisë. Nuk ndodh gjithmonë kështu, madje shpesh qëllon e kundërta. Dhe atëherë është krijimtaria që dëmtohet. Sepse në kundërshtim me ato çka mendohet, dashuria është shemra më e rrezikshme e krijimit. Dhe krijimi letrar nuk e duron dot shemrinë.

Në rastet kur kjo ndodh, domethënë kur shkrimtari zgjedh artin, atëherë i ngjan vërtet murgut që i bën ballë mëkatit.

*A.B. - Pjesën kryesore të veprës tuaj e njohim në sajë të punës së një përkthyesi të vetëm e unik çka është e rrallë e padyshim ideale për një shkrimtar. Si lindi dhe vazhdon bashkëpunimi juaj?*

**I.K.** - Përkthimi është pa dyshim një nga mundimet e mëdha të njerëzimit. Nganjëherë, në çaste lodhjeje ose ndriçimi, krejt raca njerëzore duket si një bëlbanë e madhe në fytyrën e së cilës duken gjurmët e kësaj krisme: mosdeshifrimi të kumteve.

Për të folur më sheshazi, ky mundim shtohet për popujt e vegjël. E për vendet e vegjël diktoriale ai merr një ngjyrim fatal. Të përkthehet në këto vende është diçka e frikshme dhe e mrekullueshme njëkohësisht. Diçka që ngjason me kapërcimin e kufirit, nëpër terr, ku lehjet e qenve të rojeve mund të të arrijnë dhe telat me gjëmba mund të të gjakosin.

Kjo është arsyaja që përkthyesi im Jusuf Vrioni, më është dukur përherë i natyrshëm, aq

sa me elegancën, nostalginë pér Francën, dhe pa dyshim talentin e tij të jashtëzakonshëm sa edhe me trembëdhjetë vitet e kaluara në burgjet komuniste.

Kështu u njoha me të pér herë të parë në fillim të viteve 60'. Shkova në dhomën e vogël ku banonte pérkohësisht me të fejuarën, pér të më treguar kreun e parë të romanit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", që e kishte pérkthyer me dëshirën e vet, me një shpresë të drojtur se ndoshta mund t'ia botonin.

Unë nuk dija frëngjisht, lexoja pérveç rusishes anglishten, kështu që disa faqe ai i kishte bërë enkas pér mua edhe në këtë gjuhë.

Tek shihja tekstin e panjohur frëngjisht, mendimi i parë që më erdhi ishte dyshimi se a mund të kishte ruajtur vallë frëngishten e dikurshme në birrucat e errëta, kanalet plot baltë dhe telat me gjëmba që rrëthonin kampet? Koha tregoi se ai jo vetëm e kishte ruajtur, por pikërisht atje në baltë dhe tmerr, midis makinës së vuajtjes frëngishtja e tij është sublimuar e përkryer si rrallëkund.

Diku në fletoret e mijë kam katër vargje të shkruara pér të:

*Në burgun e ftohtë pérzier  
Me dëborën që bie prej lartësish  
Kujtimet e Champs Elysese  
Zbresin bashkë me gjuhën frëngjisht.*

Ju ishit i pari që e përshëndetët përkthyesin fantazmë, emri i të cilit nuk gjendej në mbulesën e librit. Ajo përshëndetje e bëri atë të lumtur, si një kumt i parë që i vinte nga bota e lirë. Ishte gjithashtu në stilin e jetës së tij të gjeratëher-

shme prej të burgosuri: një përshëndetje nga larg, një trokitje në mur, një shpresëz...

A.B. - *Folëm këtu për jetën tuaj e, më gjatë akoma, për veprën tuaj. Në fund të kësaj bisede a do të thoshit se për sa ju përket juve ekziston një lidhje e domosdoshme midis të dyjave?*

I.K. - Mendoj se krijimtaria e vërtetë varet shumë pak, ose nuk varet fare ngajeta e krijuesit. Jeta e njëmendët e shkrimtarit s'është veçse një shtojcë, një zhguall, një hollësi e krijimit. Një harmoni sipërane bën që jo vepra e krijuesit të burojë prej jetës së tij, por përkundrazi, jeta, në një mënyrë ose një tjetër, t'i përshtatet veprës së krijuesit.

Hulumtimet, për rolin që lozin në veprën letrare rrethanat e jetës tokësore të shkrimtarit, tingëllojnë përmendur mua naivë. Ato mund të ndikojnë disi, por ndikimi i tyre nuk është veçse në nivelet e ulëta, të rrëshqme të veprës. Kurse në thelbin e saj, domethënë në lartësitë, ato e kanë të pamundur të mbërrijnë.

Letërsia që lind nga ngucjet tokësore, nga pasionet, ndodhitë e çuditshme, qoftë dhe nga vuajtjet, është vështirë që të jetë e madhe. Të gjitha këto që përmenda mund të venë në lëvizje makinën e krijimit, por me kusht që krijimi ndërkaq të ketë qenë i skajuar diku, në vetmi, duke pritur orën e tij.

Paris - Tiranë 1994-1995